Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (182) TETTOR 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

BIG
një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

VJESHTË

Rriten prodhimet, por tregu vazhdon të jetë problem

Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 6

VENDLINDJE

Radoveshi, fshati me kulakë

Nga **BESNIK RAMA** — Faqe 10

KUJTESË

Haki Kola: "Pas drurëve të çdo pylli, të shohim njerëzit"

Nga **GJON FIERZA** — Faqe 21

IN MEMORIAM

Bashkim Rama, ky korife i diplomacisë shqiptare

Nga **ARSIM SINANI** — Faqe 23

29 nëntor, nis qarkullimi i makinave në Rrugën e Arbrit nga Tirana në Klos përmes bypass-it

- **Rruga do të hapet fillimisht deri në Klos. Vazhdon puna në segmentin Ura e Vashës - Qafa e Buallit. Nuk do të lejohet të qarkullojnë makinat e mëdha dhe ato të tonazhit të rëndë.**
- **Më 29 nëntor 2021 rruga nga Tirana në Peshkopi do të shkurtohet shumë. Mbi 70 kilometra rrugë, plot kthesa e trafik, nuk do të jetë më "barrë" për udhëtarët e Dibrës dhe Matit, duke u bërë realitet një ëndërr e vjetër e dibranëve për një rrugë të shkurtër drejt kryeqytetit. Klosi do të jetë larg Tiranës vetëm 35 km, ndërsa Peshkopia as më shumë e as me pak se 100 km nga qendra e Tiranës.**
- **Punimet po vazhdojnë normalisht edhe në tunelin e Murrizit. Në tunelin kryesor, që do të shërbejë për kalimin e mjeteve, aktualisht janë rreth 900 metra tunel pa u hapur akoma, ndërsa në tunelin e emergjencës kanë mbetur pa u hapur rreth 800 metra.**
- **Deputetja e Dibrës Dhurata Çupi Tyli ngre dyshime që rruga mund të jetë me pagesë. Ministrja e Financave: Nuk ka asnjë parashikim buxhetor aktualisht.**



Rruga e Arbërit në Xibër, Klos.

Foto: Facebook/Gjoka Konstruksion

DISA **KËSHILLA PËR TË QARKULLUAR TË SIGURT** NË **BYPASS-IN** DHE **TUNELET E RRUGËS SË ARBRIT**

Lexoni në faqe 2-3

DEBAT

Skavica? "Po" apo "Jo"

Nga **BESNIK ALKU** — Lexoni në faqen 5

Sa humbet Dibra nga ndërtimi i Skavicës?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** — Lexoni në faqen 4

Moratoriumi nuk e ndal masakrën e motorsharrave në pyjet shqiptare

Procedimet e pakta penale dhe mungesa e akteve nënligjore nuk e ka ndaluar shpyllëzimin në qarkun e Dibrës, ku ekspertët paralajmërojnë se masakra ndaj pyjeve nuk do të ndalojë pa diversifikimin e burimeve energjetike.

Nga **HYSEN LIKDISHA** — Lexoni në faqen 7

NË BRENDËSI:

■ Udhëtim në peizazhet e **Gjarecës** ■ Kompania Bio-Trofta në Arras, pas humbjes prej 300 mijë USD në rezervatin e peshkut, humb edhe gjyqin ■ **Familja Hoxha** e Grazhdanit ■ **Peshkopi**, përkujtohet 100 vjetori i betejës së Lanë-Lurës ■ **Beteja e Lanë-Lurës** dhe tërheqja përfundimtare e serbëve nga territoret shqiptare ■ Jam atje, me mend e me shpirt... ■ Zhvillohet edicioni i 27 i **Odës Dibrane**, grupi folklorik "Përparim Tomçini" fiton vendin e parë ■ **Mbillen në Lurë** 2712 pisha të zeza ■ Historia e ngritjes së **Muzeut të Kastriotëve** në Sinë ■ "**Kalabardha - Kështjellë e Arbërisë**" - arkiv i gjallë i historisë, kulturës dhe identitetit etnik të popullsisë së Kalabardhës ■ **Naimi** poet ■ Udhëtim dinjitoz ndër vite me **Hakiun** ■ **Haki Kola** i mungon Shqipërisë dhe Kosovës, maleve dhe bjeshkëve të vendit tonë ■ **Fatmir Neli**, poeti i jetës ■ Një kujtim për dom **Nikollë Mazrekun** nga Sefedin Juniku

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 10 (182). Tetor 2021
Gazeta doli nga shtypi, 3 nëntor 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit nëntor 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Bajram XHAFA
Hysen LIKDISHA
Besnik ALKU
Gjon FIERZA
Besnik RAMA
Selman MËZIU
Janaq MALE
Sakip CAMI
Halil RAMA
Mevlud BUCI
Neki OSMANI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

29 nëntor, nis qarkullimi i makinave në

Rruga do të hapet fillimisht deri në Klos. Nuk do të lejohet të qarkullojnë makinat e tonazhit të rëndë. Vazhdon puna në segmentin Ura e Vashës - Qafa e Buallit dhe në Tunelin e Murrizit

Nga **BUJAR KAROSHI**



Rruga e Arbërit në Xibër, Klos.

Foto: Facebook/ Gjoka Konstruksion

Kryeministri Rama, disa orë pas fjalës së tij në Kuvend, publikoi në FB një foto të Urës së Vashës, me shënimin që “29 nëntor - Hapet për qarkullim Rruga e Arbrit”. Kryeministri, duke i mëshuar faktit se Rruga e Arbrit do të jetë e kalueshme përmes bajpasit, krijoi perceptimin që gjithë pjesa tjetër e rrugës do të jetë e hapur, por një burim nga kompania tha se segmenti “Ura e Vashës - Qafë e Buallit” nuk është akoma gati.



Më 29 nëntor 2021 rruga nga Tirana në Peshkopi do të shkurtohet shumë. Mbi 70 kilometra rrugë, plot kthesa e trafik, nuk do të jetë më “barrë” për udhëtarët e Dibrës dhe Matit, duke u bërë realitet një ëndërr e vjetër e dibranëve për një rrugë të shkurtër drejt kryeqytetit. Klosi do të jetë larg Tiranës vetëm 35 km, ndërsa Peshkopia as më shumë e as me pak se 100 km nga qendra e Tiranës.

Lajmi për hapjen e rrugës pritej dita-ditës që nga prilli i këtij viti, por mesa duket shkak u bë një debat në sallën e parlamentit mes kryeministrit dhe kryetarit të opozitës.

***

“Më 29 nëntor do të hapet Rruga e Arbrit që të kalojnë njerëzit”, - tha kryeministri Edi Rama gjatë një debati në parlament me 28 tetor 2021.

Ky lajm u prit me duartrokitje në sallë dhe erdhi pas një replike me kryetarin e opozitës Lulzim Basha.

Më 28 tetor 2021, nga foltorja e Kuvendit të Shqipërisë, lideri i opozitës e akuzoi qeverinë për abuzime me partneritetin publik privat, në kurriz të qytetarëve dhe në favor të bizneseve të lidhura me qeverinë. Ai mori shembull investimet në Rrugën e Arbrit, për të mbështetur akuzat e tij.

“Nga 120 milionë që ka qenë Rruga e Arbrit, ka shkuar në 360 milionë dhe ti ke kurajon të vish e të na krenohesh këtu, në vend që të japësh llogari se pse paguan 240 milionë euro më shumë, tre herë më shumë projektin për Rrugën e Arbrit”.

Duke iu referuar shembjes së tunelit të Murrizit, Basha tha se ajo “nuk është fare befasi gjeologjike, është babëzi tipike, është hajdutëri me çizme”.

Duke iu përgjigjur liderit të opozitës, kryeministri Rama tha se “jo vetëm nuk i heq asnjë presje atyre që kam thënë për Partneritetin Publik Privat dhe nuk kompleksohem fare nga ato që thoni ju... Faktet flasin dhe në 29 nëntor do hapet Rruga e Arbrit që të kalojnë njerëzit, me të vetmin problem që në Qafën e Murrizit, për shkak të përbërjes gjeologjike të tunelit, që ka krijuar vonesa të mirëdokumentuara, gjithë pjesa tjetër është gati”.

Në replikat me liderin e opozitës kryeministri ritheksoi edhe njëherë qëndrimin e qeverisë ndaj partneritetit publik-privat, i njohur për publikun me akronimin PPP. Duke iu referuar shembjes së tunelit të Murrizit në pranverë të vitit 2019, ai theksoi se kjo nuk ka asnjë kosto për buxhetin e shtetit.

“Nëse ajo që ndodhi me tunelin e Murrizit, ajo që ndodhi me shfaqjen e një përbërje gjeologjike të papritur, dhe ajo do ishte me buxhetin e shtetit, atëherë do duhet të nxirrnim nga buxheti i shtetit një mal me lekë të tjera... Me Partneritetin Publik - Privat ne nuk kemi punë fare. I themi kompanisë “të doli tuneli me atë përbërje gjeologjike, është tek ti jo tek ne, nuk shtojmë ne para për atë punë. E rëndësishme është që me paratë, që përndryshe do duheshin vite për t’u bërë të gjitha bashkë, për t’u bërë Rruga e Arbrit, ne thjesht do të paguajmë në vite kthimin e investimit për një rrugë që është gati atje”, tha kryeministri Rama në foltoren e Kuvendit.

***

Lajmi për nisjen e qarkullimit në Rrugën e Arbrit ishte i papritur. Ndërkohë që besohej se nisja e qarkullimit në këtë aks duhej të ishte bërë më herët, me ardhjen e muajve të dimrit, qarkullimi në këtë aks, përmes bajpasit- 9 km, është i vështirë.

Më 29 nëntor 2021 rruga nga Tirana në Peshkopi do të shkurtohet shumë. Mbi 70 kilometra rrugë, plot kthesa e trafik, nuk do të jetë më “barrë” për udhëtarët e Dibrës dhe Matit, duke u bërë realitet një ëndërr e vjetër e dibranëve për një rrugë të shkurtër drejt kryeqytetit. Klosi do të jetë larg Tiranës vetëm 35 km, ndërsa Peshkopia as më shumë e as me pak se 100 km nga qendra e Tiranës.

Kryeministri Rama, disa orë pas fjalës së tij në Kuvend, publikoi në FB një foto të Urës së Vashës, me shënimin që “29 nëntor - Hapet për qarkullim Rruga e Arbrit”. Kryeministri, duke i mëshuar faktit se Rruga e Arbrit do të jetë e kalueshme përmes bajpasit, krijoi perceptimin që gjithë pjesa tjetër e rrugës do të jetë e hapur, por një burim nga kompania tha se segmenti “Ura e Vashës - Qafë e Buallit” nuk është akoma gati.

Bajpasi bashkon dy anët e tunelit të Murrizit, në Bastar dhe Xibër, duke kaluar në qafën e Murrizit në lartësitë 800-1230 m mbi nivelin e detit. Rruga është 5 metra e gjerë, dhe në krahasim me aksin tjetër të rrugës, duket shumë e ngushtë.

Një burim pranë kompanisë “Gjoka Konstruksion” tha se kalimi përmes bajpasit nuk do të jetë i hapur për të gjithë llojet e mjeteve, por vetëm për makinat e vogla 4+1. Nuk është e qartë nëse në këtë aks do të kalojnë mikrobusët e linjave, por është e sigurt se kamionët, makinat e mëdha të transportit dhe autobusët nuk do të lejohen të qarkullojnë.

“Kamionët, autobusët dhe mjetet e tjera të tonazhit të rëndë nuk do të lejohen të qarkullojnë në këtë aks, deri në vënien në funksionim të tunelit të Murrizit”, tha një burim pranë kompanisë.

Bajpasi është një zgjerim i rrugës së vjetër, që lidhte fshatrat e Xibrit dhe Bastarit. Ajo u zgjerua me nisjen e punimeve në tunel dhe ishte ideja e kryeministrit Rama për ta asfaltuar këtë segment, i cili në të ardhmen do të shërbejë si një rrugë në funksion të turizmit në zonë.

Përmes bajpasit ka nisur qarkullimi që në prill të këtij viti. Gjatë fushatës për zgjedh-

aktualitet

Punimet po vazhdojnë normalisht edhe në tunelin e Murrizit. Në tunelin kryesor, që do të shërbejë për kalimin e mjeteve, aktualisht janë rreth 900 metra tunel pa u hapur akoma, ndërsa në tunelin e emergjencës kanë mbetur pa u hapur rreth 800 metra.

Rrugën e Arbrit nga Tirana në Klos përmes bypass-it

A do të jetë kalimi në Rrugën e Arbrit me pagesë?

- **Deputetja e Dibrës Dhurata Çupi Tyli ngre dyshime që rruga mund të jetë me pagesë.**
- **Ministrja e Financave: Nuk ka asnjë parashikim buxhetor aktualisht.**

Kur "Gjoka Konstruksion" nuk kishte nënshkruar kontratën për nisjen e punimeve në Rrugën e Arbrit, në vitin 2017, media shkroi se duke u bazuar në një relacion të Ministrisë së Financave të asaj kohe, Rruga e Arbrit do të ishte me pagesë, me një shumë 4 euro për çdo kalim. Sipas medias, të ardhurat do të ndaheshin përgjysmë mes kompanisë dhe qeverisë.

Prej kohës që kanë nisur punimet në pranverë 2018 e deri më tani, lajmet se rruga mund të jetë me pagesë kanë qenë më shumë për debat politik.

Kryeministri Edi Rama i ka mohuar vazhdimisht lajmet se rruga e Arbrit do të jetë me pagesë, të paktën gjatë periudhës 13-vjeçare së koncesionit.

"Kjo rrugë nuk do të ketë asnjë tarifë për sa kohë do të jem unë, pastaj me të tjerët shihni e bëni e do më kujtoni" ka shkruar ai në Facebook në shtator 2019, në një përcjellje që i bëri ecurisë së punimeve.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe në prill të këtij viti, gjatë një vizite në kantier. Në një intervistë televizive në njërin nga tunelet afër Klosit, ai ritheksoi se "rruga do të jetë pa pagesë për njerëzit dhe mirëmbajtja do të kryhet nga kompania. Pra ne do të japim financim edhe për mirëmbajtje dhe njerëzit do ta kenë pa pagesë".

Këto ditë, deputetja e Dibrës Dhurata Çupi Tyli, gjatë diskutimeve për projektbuxhetin e vitit 2022 në Komisionin e Ligjeve e pyeti Ministren e Financave Delina Ibrahimaj nëse Rruga e Arbrit do të jetë me pagesë.

"Kryeministri deklaroi se "Rruga e Arbrit" inaugurohet brenda vitit 2021, por ka të dhëna se do të vendoset një tarifë 4 euro për 1 kalim për dibranët dhe qytetarët që do të kalojnë në "Rrugën e Arbrit". Qytetari do të paguajë 4 euro të vijë në Tiranë dhe 4 euro të shkojë në Dibër, ndërkohë që flasim për qarkun më të varfër të Shqipërisë. Është parashikuar në buxhetin 2022 kjo taksë që u vendoset dibranëve?" - pyeti deputetja e Dibrës ministren e Financave.

Në përgjigjen e saj, Ministrja Ibrahimaj tha se "për këtë kërkesë nuk ka asnjë parashikim buxhetor aktualisht. Ky është një koncesion PPP, kemi parashikuar pagesën e këtij koncesioni në bazë të dokumentacionit që kemi aktualisht në dispozicion dhe kontratës koncesionare".



Puna po vazhdon edhe në segmentin Ura e Vashës - Qafa e Buallit, përgjatë luginë së Planit të Bardhë. Punimet në këtë segment janë përqendruar në dalje të Urës së Vashës, me krijimin e tarracave sipër rrugës, për më shumë siguri në lëvizje.

Në foto: Pamje nga punimet në rrugë pranë Planit të Bardhë

jet parlamentare në prill 2021 rruga ishte e kalueshme për makinat e vogla, pavarësisht se shumë segmente të saj ishin të paasfaltuara. Ndërsa kalimi i makinave u kthye në një problem për kompaninë, pasi pengohej puna në kantier. Që nga prilli deri më tani, përveç asfaltimit të rrugës nga dalja e tunelit në Xibër deri në Fshat-Klos, punimet në kantier duken se kanë ecur ngadalë.

Nga muaji korrik kompania po punon për hapjen e degëzimit dalje Ura e Vashës - Klos, me gjatësi rreth 3 km, i cili këto ditë ishte drejt përfundimit, në pritje të shtresës së parë me asfalt. Në këtë segment nuk ka filluar akoma puna për ndërtimin e urës në Klos, e cila për momentin do të funksionojë me një kah lëvizje. Lëvizja në këtë urë do të duhet të rregullohet me semafor.

Puna po vazhdon edhe në segmentin Ura e Vashës - Qafa e Buallit, përgjatë luginë së Planit të Bardhë. Punimet në këtë segment janë përqendruar në dalje të Urës së Vashës, me krijimin e tarracave sipër rrugës, për më shumë siguri në lëvizje.

Një burim pranë kompanisë konfirmoi për gazetën se më 29 nëntor do të hapet rruga deri në degëzimin e Klosit, ndërsa ajo drejt Bulqizës pritet të hapet në pranverë të vitit të ardhshëm.

Në segmentin Ura e Vashës-Bulqizë, rreth 10 km i gjatë, puna ka nisur në vitin 2011. Që nga viti 2018, kur Gjoka Konstruksion e mori rrugën me PPP, në këtë segment punimet kanë ecur shumë ngadalë. Burime nga kompania thonë se aktualisht në këtë segment, përfshirë edhe degëzimin e Klosit, janë përqendruar punimet.

Ndërkohë, punimet po vazhdojnë normalisht edhe në tunelin e Murrizit. Në tunelin kryesor, që do të shërbejë për kalimin e mjeteve, aktualisht janë rreth 900 metra tunel pa u hapur akoma, ndërsa në tunelin e emergjencës kanë mbetur pa u hapur rreth 800 metra.

Sipas burimit tonë, me këto ritme hapja e tunelit do të bëhet e mundur në pranverë 2021, ndërsa për punimet e brendshme do të duhen muaj të tjerë punë.

***

Megjithëse jemi në prag të dimrit, lajmi për nisjen e qarkullimit të pjesshëm në Rrugën e Arbrit është një lajm i mirë. Kjo tregon se, pavarësisht vështirësive, nuk ka më kthim pas dhe shumë shpejt rruga do të jetë e kalueshme në të gjithë aksin nga Tirana na Bllatë, 70 km i gjatë.

DISA KËSHILLA PËR TË QARKULLUAR TË SIGURT NË BYPASS-IN DHE TUNELET E RRUGËS SË ARBRIT



Nga **DEMIR OSMANI**

Siç jeni në dijeni, më 29 Nëntor 2021, do të hapet për qarkullim Rruga e Arbrit, një ëndërr e vjetër e dibranëve që po bëhet realitet.

Është e kuptueshme dëshira e madhe dhe nostalgjia për shumë qytetarë që në këtë datë dhe në vazhdimësi, do të udhëtojnë në këtë rrugë. Meqenëse kalimi në rrugë do të kryhet përmes bajpasit, për të qarkulluar të sigurtë, për drejtuesit e mjeteve po japim disa rekomandime që duhet ti kenë parasysh dhe ti zbatojnë me korrektesë.

Në **BAJPASIN** e tunelit të Xibrit, rruga ka një malore dhe dishezë të gjatë, e shoqëruar me kthesa, ku fushëpamja e drejtuesve të mjeteve është e kufizuar.

- Zvogëloni shpejtësinë e lëvizjes, duke e përshtatur atë me dukshmërinë (fushë pamjen e drejtuesit të mjetit), dhe spostohuni në anën e djathtë të karrexhatës.
- Mbani timonin me dy duar, për të patur kontroll të sigurtë të mjetit;
- Mos ndaloni për pushim dhe qëndrimi si në ngjitje ashtu edhe në zbritje
- Mos parakaloni në ngjitje dhe kthesa, pasi rruga është me dy sense dhe me një korsi për sens.
- Mos ndryshoni sensin e lëvizjes, si në ngjitje ashtu edhe në zbritje.
- Në ngjitje lëvizni me marsh të ulët, për të shfrytëzuar më mirë fuqinë e motorit dhe përballuar më mirë ngjitje e mjetit.
- Në zbritje, zvogëloni shpejtësinë duke lëvizur me marsh të ulët, për të shfrytëzuar veprimin frenues të motorit, përdorni sa më pak frenat pasi mbinxehen elementët frenues, rrisni distancën me mjetet para, meqenëse rritet hapësira e frenimit, tregoni kujdes të shtuar kur rruga është e lagur;
- Nëse dëshironi të ndaloni për të parë bukuritë e natyrës, apo për ndonjë nevojë tjetër, duhet të zgjidhni vendin ku mjeti mund të pozicionohet jashtë karrexhatës dhe të jetë i dukshëm për drejtuesit e tjerë të mjeteve që kalojnë pranë jush, por asnjëherë në dhè të hedhur dhe bankinë të dëmtuar nga punimet;
- Në kthesa, përveç dukshmërisë, shpejtësia duhet të rregullohet edhe në vartësi të rrezes së kthesës, lagështisë, ngarkesës dhe gjendjes së gomave. Mos lëvizni prapa me marsh injetro.

NË TUNELE.

Përveç mesazheve që japin sinjalet para se të hynë në tunel, duhet të keni parasysh edhe këto këshilla:

- Te përshtatni shpejtësinë në përputhe me dukshmërinë (fushëpamjen tuaj);
- Të ndizni fenerët jo verbues;
- Ndalohet pushimi dhe qëndrimi. Nëse qëndrimi është i gjatë, i detyruar për arsye trafiku apo avarie, duhet të fiket motori për të mos ndotur mjedisin;
- Ndalohet kthimi në vend (ndryshimi i sensit të lëvizjes) brenda tunelit;
- Nëse sinjalistika lejon parakalimin, zbato me rigorozitet rregullat e parakalimit;
- Mbani fort timonin me dy duar dhe tregoni kujdes të shtuar në dalje të tunelit, pasi mund të përballeni me ndonjë goditje të erës anësore

Pranë skarpateve të larta, sidomos në rrugë të reja, rreziku i rënies së gurëve është më i madh, pasi pas punimeve, ende nuk është stabilizuar ajo nga punimet, duhet të keni kujdes:

- Ulni shpejtësinë, për të mos goditur gurët ose masa dheu që mund të kenë rënë në karrexhatë;
- Tregoni kujdes për mundësinë e frenimit të papritur të mjetit që keni përpara;
- Këshillohet të shmangni ndalesa të gjata në këto segmente rrugore.

Ju uroj udhëtim të sigurt dhe të këndshëm.

Fusha me pjellore e Dibrës padyshim nga vendet me prodhuese që së bashku me Maqellarën ishin vërtet një hambar jo vetëm drithi.

Sa humbet Dibra nga ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Mbytja e fushës pjellore të luginës së Drinit të Zi, fushë që ka mbajtur me bukë e prodhime blegtorale ndër shekuj popullsinë e fushës dhe maleve të Dibrës është shikuar, si pikë e parë, si masë për mos përmbytjen e Shkodrës, si pikë e dytë si hurdhë uji zbrazja periodike e së cilës do të krijojë stabilitet në kaskadën e hidrocentraleve të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës dhe Bushatit dhe së treti si prodhim energjie elektrike shumica e së cilës do të shkojë për plotësimin e nevojave të Kosovës...

Asnjë zë, asnjë germë e shkruar publikisht, nuk është dëgjuar e shkruar për dëmin e jashtëzakonshëm natyrorë, për bukën që ka dhënë dhe jep ajo në shekuj nëpërmjet prodhimit bujqësor e blegtoral.

Por sa humbet Dibra dhe ekonomia shqiptare në këtë kohë që ka filluar (e nuk i dihet fundi)krize ekonomike, shtrenjtimit të drithit e të produkteve blegtorale?

Një përgjigje në facebook na e jep një ndër statisticienët më skrupuloz që ka punuar në Dibër (e që po përgatitet për një libër statistikor në shtrirje të gjatë kohore për mbarë trevën), Agim Kasa.

Agim Kasa, siç deklaron vetë, i thotë Po Skavicës kur e mat (sipas tij) me prodhimin e energjisë elektrike dhe stabilitetin në prodhimin e saj në hidrocentralet e kaskadës së Drinit. Ndërsa i dhemb ajo që në punimet statistikore të tij është pasuri e pazëvendësueshme për Dibrën.

Agim Kasa deklaron:

"Fusha me pjellore e Dibrës padyshim nga vendet me prodhuese që së bashku me Maqellarën ishin vërtetnjë hambar jo vetëm drithi.I kam thënë Po Skavicësmegjithëse kjo fushe pjellore çdo vit jepte mbi 4000 ton drithëra.Në vitin 1990 kur u shemb dhe sistemi kooperativist prodhoi 2258 ton drithëra, ama ka patur dhe vitin e mirë ta quajmë 1983 kur u prodhuan 4735 ton drithëra. Ishte kjo Luginë e Drinit që mbante edhe 3500 gjedhë, ku afërsisht gjysma e tyre ishin lopë e që prodhonin 600 ton qumësht,kur viti më i mirë ishte 1988 e prodhimi arriti 711 ton por edhe afro 140 ton mish.E do pyesni ju, ku shkuan këto prodhime se populli buke misri hante e mish e qumështhiç e hiç. Te drejte keni, por tjetër gjë mendoj unë ....Ai prodhim nuk do te realizohet ndonjëherë."

Komuniteti shqiptar në New York proteston para selisë së OKB



Komuniteti shqiptar në New York protestoi të enjtën me 4 nëntor para selisë së OKB kundër ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës.

Protestuesit kundërshtojnë planet e qeverisë shqiptare, që me mbështetjen e biznesit amerikan, synojnë ndërtimin e hidrocentralit, i cili do të sjellë pasoja të rënda për komunitetin që jeton përgjatë luginës së Drinit të Zi.

Protesta ishte e organizuar nga aktivistët e komunitetit Dibran, me lejen dhe sipas rregullave të bashkisë së New Yorkut, me mbështje edhe nga Organizata Albanian Roots-Rrënjët Shqiptare.

> Në vitin 1990 kur u shemb sistemi kooperativist prodhoi 2258 ton drithëra, ama ka patur dhe vitin e mirë ta quajmë 1983 kur u prodhuan 4735 ton drithëra. Ishte kjo Luginë e Drinit që mbante edhe 3500 gjedhë, ku afërsisht gjysma e tyre ishin lopë e që prodhonin 600 ton qumësht, kur viti më i mirë ishte 1988 e prodhimi arriti 711 ton por edhe afro 140 ton mish...

Kundërshtimi i mbytjes së Dibrës fatkeqësisht është larg intelektit dibran, larg argumentimit se me heqjen nga harta e prodhimit bujqësor të tokës ku burojnë të gjitha të mirat materiale njerëzore, të tokës që është mjeti më i pa zëvendësueshëm natyror, shuhet përgjithmonë burimi kryesor i ushqimit, burim që nuk zëvendësohet me asnjë burim tjetër.

Në bashkinë e Dibrës ka një drejtori bujqësie me specialistë me njohje të gjerë të luginës së Drinit të Zi e me dije shkencoretë mjaftueshme për ti dhënë përgjigje pyetjeve që lidhen me vizionin bujqësor të Dibrës me e pa mbytjen e luginës, me e pa mbytjen e saj. Nuk kemi dëgjuar asnjë zë dhe nuk kemi lexuar asnjë shkronjë.

Specialistët që e duan profesionin e tyre nuk duhet të bëhen asnjëherëpatronazhistë të shtetit për të ruajtur karrigen.

Në Dibër, në kodrën e Pollozhanit, ka një stacion meteorologjik nga më të vjetrit e sistemit të matjes së reshjeve, temperaturave, mjegullës dhe tregues të tjerë klimatikë. Lugina e Drinit është e njohur për mjegullat e dendura që vazhdojnë me ditë të tëra e në ditët e dimrit sjellin ngrica të padurueshme e jashtëzakonisht të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe të gjallesave.

Sa do të ndikojnë mjegullat shtrirë mbi hurdhën e Skavicës për javë dhe muaj të tërë, verës dhe dimrit, në jetën e njerëzve që do të jetojnë në breg të liqenit?

Sa do të ndikojë mungesa e prodhimeve bio (që i zhduk Skavica) në kthimin e trevës së Dibrës në një ndër zonat malore më të vizituara nga turistët?

Ka shumë pyetje që kërkojnë përgjigje përpara se të nisë diga e hurdhës së Skavicës.

Shumë...

Dhe u takon intelektualëve dibranë të përgjigjen. Druhem në një përgjigje pro apo kundër. Patronazhistët nuk e hapin dot gojën për ti thënë JO SKAVICËS. Pozicioni i tyre është mbi katër këmbë karrigeje që po të lëvizin thyhen...

VËZHGIM

Kur do të ketë bashkia Dibër tregun e prodhimeve bujqësore?

Prej 30 vitesh Dibra nuk ka një treg të prodhimeve bujqësore. Sot prodhimet bujqësore tregtohen çdo ditë anës rrugës së ish-parkut të makinave. Tregtohet në rrugë, pa standarde dhe po ashtu pengohet qarkullimi i qytetarëve dhe mjeteve. Shkurt: nuk kemi një treg ku të tregtojnë 1000 fermerë, vendi i tregtimit dhe produktet të plotësojnë standardet minimale dhe të parkohen 2000 mjete dhe qytetarët e mjetet të qarkullojnë lirisht. Kanë qarkulluar deri tani 6 kryetarë bashkish, por asnjëri nuk e ka zgjidhur këtë problem.

I njëjti problem është dhe për tregun e kafshëve. Ka qarkulluar ideja se nuk nevojitet një treg i tillë, sepse fermerët e gjejnë tregun përmes rrjeteve sociale. Nuk është absolutisht e vërtetë. Ndoshta 10 apo 20 fermerë kështu e zgjidhin problemin e tregut, por kjo zgjidhje nuk përbën as 1% të nevojës, pa thënë se marrëdhëniet e sigurta për shitblerjen e një produkti krijohen e realizohen në një treg fizik.



Mjafton të shohim sa njerëz e ndjekin panairin, numër i cili shkon dhe në 10,000 veta, sa njerëz shkojnë tek ky treg ekzistues i së dielës, i cili shkon në 5000 veta dhe bindemi që një treg me sipërfaqe prej 2 ha i nevojitet Dibrës. Dikush mund të thotë se tregtari le të shkojë në parcelë e ta blejë prodhimin. Edhe kjo është një mënyrë e krijimit të marrëdhënieve, por në treg njihesh jo vetëm me shumëllojshmëri prodhimesh, por edhe më shumë prodhues, e ke mundësinë të zgjedhësh. Jo vetëm kaq, por konsumatori i thjeshtë shkon e blen në treg dhe jo në parcelë, pasi shumica nuk kanë mundësinë të shkojnë direkt në parcelë.

Me përfundimin e Rrugës së Arbrit, i cili duket se është afër, nevoja për një treg të tillë do të jetë edhe më e madhe, pasi pritet të rritet kërkesa për produktet e Dibrës.

Ne mendojmë se këta fermerë që kanë mbetur e që punojnë e prodhojnë me kaq përkushtim, duke qenë "heronjtë e mbushjes së tavolinës me ushqim", kanë merituar prej kohësh një treg me standarde.

Dibra është ndër të paktat bashki që nuk ka treg dhe është e pafalshme të mos e kemi. Le të shpresojmë se duke bashkuar dhe reagimet tuaja në këtë status, ato të "vrasin" syrin dhe mendjen e drejtuesve vendorë, Ministrisë së Bujqësisë apo më shumë, për të vënë në planin e zgjidhjes ngritjen e një tregu.

(Marrë nga Facebook "Vizioni Bujqësor Për Dibrën")

debat

Skavica? “Po” apo “Jo”



Ka vite që flitet për Skavicën dhe ka po aq vite që individë, personalitete, publicistë, shoqata, grupe intelektualësh kanë botuar apo organizuar protesta kundër ndërtimit të HEC Skavica. Shumë mirë që janë bërë gjithë këto gjëra, me një qëllim, që është ngritja e zërit kundër HEC dhe në mbrojtje të të drejtës së dibranëve dhe Dibrës.

Nga **BESNIK ALKU**

Këto ditë në New York do të mbahet një protestë kundër ndërtimit të HEC Skavica. Një ide e mirë, pasi organizohet në kryeqendrën e botës dhe ku jeton një komunitet i madh dibranësh. Ka vite që flitet për Skavicën dhe ka po aq vite që individë, personalitete, publicistë, shoqata, grupe intelektualësh kanë botuar apo organizuar protesta kundër ndërtimit të HEC Skavica. Shumë mirë që janë bërë gjithë këto gjëra, me një qëllim, që është ngritja e zërit kundër HEC dhe në mbrojtje të të drejtës së dibranëve dhe Dibrës. Deri më sot dukej që nuk ka qenë ndonjë nismë serioze, sepse gjithmonë ishte qeveria shqiptare në mes, dhe kur nuk ke një qeveri serioze, edhe çështja nuk merret seriozisht. Tashmë duket se gjërat janë më serioze me ofrimin e investitorit amerikan. Unë po jap disa opinione se si të jemi më të qartë për procesin e ndërtimit të HEC Skavica.

Çështja e parë është që duhet me qenë të përgatitur për dy skenarë:

1. Jo, HEC Skavica nuk do të ndërtohet.
2. Po, HEC Skavica do të ndërtohet.

SKENARI 1: JO, HEC Skavica nuk do të ndërtohet.

Individë apo grupe që janë krijuar deri më tani janë më shumë emocionalë dhe nuk kanë një strategji apo plan veprimi për të kundërshtuar. Falë njohjeve të tyre apo mbështetjes që kanë, apo aksesit në media, kanë bërë edhe ato aktivitete kundërshtuese që janë bërë. Por këto nuk mjaftojnë dhe sigurisht që, përveç zhurmës, nuk kanë ndonjë efekt te politikëbërësi, që është edhe vendimmarrës apo investitori.

E para: Duhet të krijohet një strukturë e mirorganizuar, me përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit që janë kundër HEC (përfaqësues të banorëve, bizneseve, intelektualë, shoqata, media, publicistë, emigrantë, politikanë etj). Ky grupin duhet të ketë një emër: “Aleanca kundër HEC Skavica” apo diçka tjetër. Kjo strukturë duhet të ketë një mision të qartë të punës së tij, duhet të ketë besimin e njerëzve dhe të jenë të guximshëm në misionin që kanë marrë, si dhe të pakorruptuar.

E dyta: Ky grup duhet të përzgjedhë një grup ekspertësh dhe specialistësh që të analizojnë me tregues teknikë dhe profesionalë të gjitha dëmet që sjell ndërtimi i HEC, të përgatisin një dokument studimor për këtë qëllim, i cili të jetë i krahasuar me studimin e fizibilitetit që kanë paraqitur qeveria ‘pro’ ndërtimit të HEC. Ky studim duhet të jetë me fakte dhe shifra për të demonstruar të kundërtën dhe të jetë i matshëm dhe real. P.sh., një fakt se nëse miliona euro që investohen në ndërtimin e HEC, do të investoheshin në bujqësi dhe agro-turizëm për zonën e Dibrës, cili do të ishte më ekonomik dhe më social?

E treta: Kjo strukturë ose ky grupim duhet të ketë një plan advokimi dhe masash të qarta që të kundërshtojë qeverinë dhe vendimmarrësit, që nga format paqësore demokratike (peticione, protesta, rezolutë në parlament etj.), në masat ekstreme demokratike që kapin ngushtë politikën (si p.sh., të gjithë anëtarët e PS të braktisin partinë dhe në votime masivisht kundër të majtës apo masa të tjera të ngjashme, kjo edhe për të djathtën nëse është vendimmarrëse), dhe pastaj një fushatë e mirorganizuar mediatike, ku të transmetohet mesazhi i saktë (jo njëri thumbit e tjetri patkoit), të lobohet në institucionet dhe forumet vendase dhe të huaja dhe të ketë një forcë kërcënuese personale dhe

Individë apo grupe që janë krijuar deri më tani janë më shumë emocionalë dhe nuk kanë një strategji apo plan veprimi për të kundërshtuar. Falë njohjeve të tyre apo mbështetjes që kanë, apo aksesit në media, kanë bërë edhe ato aktivitete kundërshtuese që janë bërë. Por këto nuk mjaftojnë dhe sigurisht që, përveç zhurmës, nuk kanë ndonjë efekt te politikëbërësi, që është edhe vendimmarrës apo investitori.

Duhet të krijohet një strukturë e mirorganizuar, me përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit që janë kundër HEC (përfaqësues të banorëve, bizneseve, intelektualë, shoqata, media, publicistë, emigrantë, politikanë etj). Ky grupim duhet të ketë një mision të qartë të punës së tij, duhet të ketë besimin e njerëzve dhe të jenë të guximshëm në misionin që kanë marrë, si dhe të pakorruptuar.

politike për të gjithë vendimmarrësit ose siç thotë shkrimtari i madh Agron Tufa te “Fabula Rasa”, “duhet të përdoren metoda vençe, siç i ka hije popullit të Dibrës”. Ky lloj presioni duhet të bëhet edhe jashtë Shqipërisë nga grupe apo përfaqësuesit e kësaj strukture në Amerikë apo kudo ku ka aktivistë.

SKENARI 2: PO, do të ndërtohet HEC Skavica.

Për këtë duhet të mbahet një qëndrim dhe të hartohet një strategji që dibranët të dalin me sa më pak humbje nga ndërtimi i kësaj vepre. Si në skenarin e parë, gjithmonë duhet të ketë të mirorganizuar strukturën që do të përfaqësojë dhe mbrojë banorët e Dibrës nga HEC Skavica. Struktura është ajo që thamë në skenarin e parë. Kjo strukturë duhet të:

- Të mbrojë alternativat që ndërtimi i HEC të sjellë sa më pak dëme. Kjo arrihet pas një procesi transparent dhe pjesëmarrës të përfaqësuesve të kësaj strukture në zgjidhjet teknike që jep kompania dhe qeveria për tipin dhe zgjidhjet teknike që jepen për HEC. Pra, në proceset e dhënies të alternativave të shkohet tek alternativa që bën sa më pak dëm, që mund të jetë një HEC me 3 diga dhe me 3 liqene të vogla, jo një digë dhe një liqen i madh. Këtu duhet të presion mbi kompaninë dhe qeverinë që të hapen konkurse për të dalë me disa alternativa teknike të HEC.

- Të mbrojë të drejtat e dibranëve si në aspektin social, ekonomik, mjedisor, politik për ato banorë që do të preken direkt dhe për banorët që nuk preken direk, por indirekt.

Banorët që preken direkt:

- Vlerësimi i pronës të jetë real, duhet të këmbëngulet. Kjo do të thotë se në listën e pronës të shkruhet tokë arë, kaq dynymë, në pronësi të “x” familje, dhe tokë pyll kaq ha, dhe në pronësi të “x” familje. Në një kolonë tjetër të shënohet nëse janë më dokument pronësie apo pa dokument pronësie, dhe masa e kompensimit të jetë për atë pronësi që ke në të vërtetë, jo për atë që ke apo nuk ke dokumente.

- Kompensimi duhet të jetë në disa mënyra:

E para, të kërkohet një kompensim sipas rregullave komerciale të tregut në Shqipëri apo në botë, kur zhvillohet një pronë, e cila ndryshon destinacion. Kjo do të thotë që banorët e prekur të jenë aksionerë në veprën e ndërtuar në përqindjen që ju takon. Për të negociuar për këtë duhet të përzgjidhen kompani biznesi që merren më këtë punë, për të dalë në modalitetet e pranuara. P.sh., pse në Tiranë kur ndërtohet një pallat i zoti i pronës merr 25-35% të pallatit, pse dhe banorët e kësaj zone mos jenë aksionerë në HEC?

E dyta, të kërkohet një mënyrë kompensimi sipas traditës në Dibër apo vençe, që kur zihet një sipërfaqe toke për ndërtim, kompensohet me të njëjtën sasi toke diku tjetër me të njëjtat kushte, nëse është më e keqe në raport 2 ose 3 herë më shumë. Pra, të kërkohet që, nëse këto banorë të lëvizin të ikin diku në luginën e lumit Erzen, Tiranë, Shkumbin apo diku tjetër dhe të kompensohen si me tokë arrë, kodrinë, pyll apo tjetër me raporte që do të bien dakord. Kompensimi i shtëpive apo pasurisë tjetër sipas normave dhe kokë më kokë. Pra, nëse ke humb shtëpi, të marrësh shtëpi, nëse ke humb plantacione me fruta, të marrësh plantacione me fruta, etj.

Banorët që preken indirekt.

Këto janë gjithë banorët e tjerë të Dibrës, të cilët në rastin e parë do të ndryshojë relievi, do të ndryshojë klima, do të vështirësohet lëvizja, do të zvogëlohet tregu vendas, do të bjerë fuqia blerëse, sasia e prodhimit dhe do të zvogëlohen mundësitë social-ekonomike. Për këta banorë, mënyra e kompensimit është komplekse dhe kërkon një marrëveshje të përhershme qeveritare, e cila konsiston në:

- Dibra të ketë një status të veçantë të trajtimit social, ekonomik dhe politik nga qeveria. Ky status i veçantë të zgjidhet me modalitet dhe të bëhet pjesë e ligjeve, procedurave

Duhet të mbahet një qëndrim dhe të hartohet një strategji që dibranët të dalin me sa më pak humbje nga ndërtimi i kësaj vepre. Të mbrohen alternativat që ndërtimi i HEC të sjellë sa më pak dëme. Kjo arrihet pas një procesi transparent dhe pjesëmarrës të përfaqësuesve të kësaj strukture në zgjidhjet teknike që jep kompania dhe qeveria për tipin dhe zgjidhjet teknike që jepen për HEC.

dhe masave qeverisëse. Ata të paktën duhet të sigurojnë:

- Program zhvillimi të veçantë me fonde të dedikuara për Dibrën për zhvillimin e bujqësisë, turizmit, sipërmarrjeve dhe ekonomisë lokale në përgjithësi;

- Investim për të rritur aksesimin me rrugë dhe ura apo vepra të tjerë për të mos mbetur xhep i një territori me liqen në mes.

- Për banorët/familjet me të ardhura të vogla të ketë bonuse të veçanta për të siguruar me ushqim dhe nevojat e tjera jetike. Këto të jenë me status të veçantë vetëm për Dibrën.

- Bursa dhe forma të tjera të mbështetjes së fëmijëve për edukim, pasi zvogëlimi i numrit të nxënësve do të çojë në mbylljen e shumë shkollave dhe vështirësi për arsimin e nxënësve. Një politikë e veçantë për arsimimin e fëmijëve duhet për Dibrën.

- Fonde të veçanta të dedikuara për sipërmarrjet e reja dhe inovacionin. Për të zhvilluar degë apo sektorë të tjerë të ekonomisë, të lidhura më shumë më ekoturizmin dhe mjedisin.

Këto ishin disa ide dhe mendime që desha t’i ndaja sot. Një pjesë e tyre janë të mbledhura nga diskutime me miq dhe shokë që e duan Dibrën dhe nuk kanë vetëm autorësinë time (sidomos me inxhinierin Edmir Sula), dhe një pjesë janë listë dëshirash, por që këto të jenë sa më afër realitetit duhet patjetër të ketë një strukturë të fortë që të përfaqësojë dibranët për këtë çështje dhe një strategji të saktë dhe me plan veprimi. Përndryshe, do të bëhet siç u ka dashtë qejfi qeverisë dhe interesave të një grupi të vogël njerëzish që përfitojnë, dhe ne do të jemi dëshmitarë të një liqeni të madh. Në fund ne duhet të përpiqemi të dalim sa më të mbrojtur nga kjo vepër, por asnjëherë të hyjmë në luftë mes vetit, me rajonet e tjera siç duan të na fusin apo të na faturojnë idenë se po lemë Shqipërinë pa rezervë energjetike, apo historira të tjera….

Vjeshtë në Dibër



Rriten **prodhimet,** por **tregu** vazhdon të jetë **problem**

Nga **OSMAN XHILI**

Vjeshta ka kohë që ka ardhur dhe njerëzit rendin të vjelin e të grumbullojnë prodhimet e stinës. Një pjesë frutash ka muaj që i kanë mbledhur si qershitë,vishnjat, kumbullat, apo ndonjë mollë të hershme verore. Tashmë është radha e mollës, rrushit, arroreve dhe ndonjë tjetër, që në fakt përbëjnë dhe pjesën më të madhe të tyre.

Të thuash të vërtetën, ky vit ka qenë i mbarë me prodhime. Molla, si zakonisht mban peshën kryesore të këtij prodhimi, me një rendiment në total mbi gjashtë mijë ton. Por ka një paradoks, pasi vitin që prodhimi është më i madh, kërkesat për produktin janë më të vogla. Pas shumë përpjekjesh fermerët arritën t'i shisnin prodhimet e tyre me një vlerë prej 30 deri 40 lekë, duke u ndjerë të lehtësuar, për tu marrë me pjesën tjetër të fushatës.

Shumë gjëra kanë ndryshuar që nga fillimi, në varësi të tregut dhe shijes së konsumatorit. Varietete të tilla si Starking, Gold, Hajdaret, po zëvendësohen nga të tjerë Gold Melina, Fuxhi, Piklet e ndonjë tjetër dhe natyrisht, që këto ndryshime kanë kostot e tyre. Kjo kërkon që në të ardhmen të ketë studime të mirëfillta shkencore, në mënyrë që tu paraprihet gjërave e jo të mbetemi në fund të karvanit.

Pati fermerë, që këtë vit prodhuan mbi 100 ton mollë secili, si Veip Salkurti, Adriatik Kaja, Premtim Agolli, duke u bërë promotorë të këtij aktiviteti për fermerët e tjerë. Vlejnë të përmenden vëllezërit Kryemadhi, vëllezërit Mehmeti, apo dhe vëllezërit Tifeku, që prodhojnë sasi të konsiderueshme, por dhe prodhime cilësore, duke i pasur të prenotuara që më parë nga tregtarët.



Këtë vit qenë të mbara dhe prodhime të tjera si patatja dhe qepa, madje dhe tregu për to ka qenë shumë i leverdisshëm. Ato po shiten me një çmim shumë të leverdisshëm, që e kalon vlerën e 50 lekëve për kilogram.

MBJELLJET E VJESHTËS

Krahas mbledhjes së prodhimeve, vjeshta hap dhe një front tjetër shumë të madh angazhimi, siç janë mbjelljet e kësaj stine. Është pikërisht tetori, muaji vendimtar, që përcakton nëse do të korrim diçka për vitin tjetër. Të gjitha këto mbjellje futen në termin "të lashta", por kuptohet që peshën kryesore e ka gruri. Ishte krijuar një trend rënie i kurbës së mbjelljes së grurit, në këto vitet e fundit. Nga tre mijë hektarë që mbilleshin para pesë gjashtë vitesh, ra nën nivelin e dy mijë hektarëve të mbjellë. Ndoshta ngritja e çmimeve në tërësi, por sidomos ajo e bukës, i bëri fermerët disi më të ndjeshëm, për tu kapur sërish pas kësaj kulture,që po shkonte në harresë. Këtë vit, dhe pse fushata akoma nuk ka përfunduar, mendohet se do të mbillen 500 hektarë më tepër me të lashta. Preferohen të mbillen varitete të tilla si ato italiane, Altezia dhe Antile, pobjeda serbe, ato franceze, Soisons dhe Apash. Ka dy vite që po kultivohet me shumë sukses dhe variteti francez Eusilda, që po kënaq dëshirat e fermerëve.

Ka shumë kohë që fermeri Ramazan Kaza po mban kreun e fermerëve, duke mbjellë gati çdo vit rreth 20 hektarë me grurë. Ai ka ekskluzivitetin e trajtimit të varitetit Apash, si farë gruri për fermerët e tjerë. Të shumtë janë ata fermerë që këtë vit kanë mbjellë më shumë se një hektarë me grurë. Në zonën e Maqellarës mund të përmendim fermerë të tillë si Pajtim Asllani, Çlirim Sallai, Qatip Doda, Gëzim Shamku, Miri Turshilla, Gëzim Toçi e shumë të tjerë si këto. Ndofta dhëna e subvencionit të naftës për fermerët ka qenë një shtysë jo e vogël në këtë drejtim. Ishte risi këtë vit dhënia e një mijë litra naftë për çdo hektarë tokë të mbjellë. Numri i fermerëve përfitues të naftës ishte plot njëmijë veta.

Vërtetë që gruri ka peshën kryesore tek të lashtat, por fermerët kanë shtuar disi mbjelljen e thekrit dhe elbit, pasi kanë një rezistencë më të madhe ndaj fusariozës dhe disa sëmundjeve të tjera. Një interes të veçantë kanë zgjuar përzjerjet foragjere , që vijnë nga Italia, që kanë si përbërës burxhakun, thekrën, loliumin dhe grurin. Ky kombinim i këtyre kulturave jep një masë të jashtëzakonshme mase të njomë, deri në 600-700 kuintalë për hektarë. Mund të jenë mbi 20 fermerë, që e kanë

Largimi i të rinjve po e bën të vështirë menaxhimin e fermave. Subvencionet akoma nuk po bëhen efektive dhe vetëm 20% e aplikantëve kanë përfituar. Krahasuar me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, subvencionet janë pothuajse të pandjeshme në treg.

eksperimentuar këtë gjë dhe kanë mbetur shumë të kënaqur.

Nuk mund të lëmë pa përmendur një fermer të shquar të Maqellarës, Selim Kosiqin. Prej vitesh ai përpiqet që të mos heqë dorë nga mbjelljet tradicionale. Këtë vit ai mbolli katër dynym misër me fasule, duke marrë rendimente vërtetë fantastike, mbi 40 kuintalë misër dhe mbi 7 kunjtalë fasule. Fasulen e shiti me tre mijë lekë kilogramin dhe në total nga katër dynymë të mbjellë mori 3,5 milion lekë.

HALLET NUK KANË TË SOSUR...

Fermeri dibran përpiqet ta mbajë traditën e të parëve në bujqësi dhe blegtori, por ndjen që toka po i rrëshqet nën këmbë. Qatip Doda,përgjegjësi i bujqësisë në Qarkun e Dibrës, numëron disa arsye që kanë çuar në këtë situatë.



Uji për vaditje mungon në gati gjysmën e sipërfaqes të tokës arë dhe kjo i vështirëson mjaft gjërat. Shumë liqene e kanale vaditës, të ndërtuar që para viteve nëntëdhjetë, janë jashtë funksionit, ku shumica e tyre për probleme mjaft të vogla.

Një tjetër problem është largimi i të rinjve nga vendi, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë menaxhimin e fermave. Ka raste fushatash si vjelja e qershisë, rrallimi dhe vjelja e mollës, që kërkojnë forca pune dhe pse jo dhe me njëfarë specializimi.

Nëse përmendëm që u bë një punë e mirë me naftën për fermerët, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për subvencionet,ku deri tani vetëm 20 përqind e aplikantëve kanë përfituar.

Me gjithë zhurmën mediatike që bëhet, subvencionet e shtetit kanë qenë si me pikatore. Krahasuar me Kosovën dhe fqinjin tjetër, Republikën e Maqedonisë së Veriut, jemi shumë prapa. Atje ndihmohet fermeri për mbjellje, për bujqësinë dhe frutikulturën në një masë shumë të kënaqshme. Kur të kujtohemi ne ti kthehemi bujqësisë dhe të investojmë në të , njerëzit do jenë larguar masivisht e nuk kthehen më.

Shpesh problem mbeten farërat e pakontrolluara, që vijnë nga shtete të ndryshme. Pika fundore që e pëson, natyrisht që është fermeri. Askush nuk e kompenson në rast humbje dhe pse ai i ka bërë të gjitha shërbimet e duhura teknologjike. Problemet janë dhe me pesticidet, janë apo nuk janë të çertifikuara, e kështu me radhë.

Padyshim që dhe tregu është një mister në vete dhe nuk ka asgjë të garantuar. Kemi parë të hidhen mollët e kalbura, nganjëherë hidhen qepët e patatet e herë tjetër hidhet qumështi në rrugë. Kur do ti eliminojmë të gjithë këto faktorë negativë, që sfidojnë suksesin e fermerit? Kur do ta kuptojmë se akoma një pjesë e mirë e popullatës jeton në fshat dhe nuk kërkon asnjë lloj punësimi? Fermerët vetëm prodhojnë e prodhojnë për qytetin, duke punuar në shi e në diell, në të ftohtë e në të nxehtë. Le tu kushtojmë pak vëmendje këtyre heronjve, që nuk kanë orar pune e nuk kanë pushim në fundjavë. Pak kujdes për to do të na shpërblehet shumëfish prej tyre dhe e ardhmja jonë dhe e fëmijëve tanë do të jetë më e mirë.

Në bashkinë Dibër që prej hyrjes në fuqi të ligjit 'Për pyjet' janë indetifikuar 22 raste të prerjeve të paligjshme deri në korrik të vitit 2021

Moratoriumi nuk e ndal masakrën e motorsharrave në pyjet shqiptare

Procedimet e pakta penale dhe mungesa e akteve nënligjore nuk e ka ndaluar shpyllëzimin në qarkun e Dibrës, ku ekspertët paralajmërojnë se masakra ndaj pyjeve nuk do të ndalojë pa diversifikimin e burimeve energjetike.

Nga **HYSEN LIKDISHA** | BIRN | Bulqizë

Më 7 shator 2019, Rolandi ishte ulur me dy shokë në një kafe-karburant buzë rruge në Bulqizë, kur përpara tij ndaloi një kamion i mbushur me trungje ahu të prerë në pyll. Instiktivisht ai hapi kamerën e telefonit celular dhe nisi të filmonte.

Tre shokët i bllokuan rrugën kamionit me makinën e tyre dhe u përballën me shoferin, i cili në fillim i kërcënoi, më pas shkarkoi lëndën drusore dhe u largua. I riu nga Bulqiza e denoncoi në polici shoferin dhe ai u procedua penalisht.

Sipas policisë lënda drusore ishte është prerë me motosharrë me qëllim për t'u përdorur si shtylla galerie në miniera e kromit të zonës.

Pasi u dërgua për gjykim shoferi i kamionit u dënua me 60 mijë lekë gjobë, një dënim relativisht i lehtë duke marrë parasysh se vetëm trungjet e ahut kushtojnë gati trefishin e kundravajtjes penale.

Ky vendimi është i ngjashëm me tre të tjerë të marrë gjatë vitit 2020 në Gjykatën e Dibrës, ku druvarët apo drejtuesit e mjeteve që transportojnë lëndë drusore të prerë në mënyrë të paligjshme janë ndëshkuar me gjoba që luhaten nga 60 mijë lekë deri në 80 mijë lekë.

Në vitin 2016, Shqipëria miratoi një moratorium për shfrytëzimin e pyjeve dhe ndaloi eksportin e lëndës drusore, por ky ligj nuk e ka ndaluar prerjen e paligjshme të pyjeve.

Edhe pse gjatë dy viteve të fundit në Prokurorinë e Rrethit Dibër janë regjistruar dhjetra procedime për këtë vepër penale, prokurorët kanë preferuar ti referojnë shumicën rastet të evidentuara për masa administrative – të cilat janë më të larta.

Por sipas ekspertëve këto masa administrative mbahen peng nga mungesa e akteve nënligjore dhe si rrjedhojë janë nul, duke mos e dekurajuar masakrën e motorsharrave në pyjet e zonës.

Ata theksojnë se mungesa e strategjive ekonomike për të diversifikuar burimet energjetike e bën të vështirë mbrojtjen e pyllit për shkak të kërkesës së lartë për lëndë drusore.

KUNDRAVAJTJA PENALE MË E LEHTË SE GJOBA

Sipas të dhënave nga 'Global Forest Watch', një shërbim monitorimi të pyjeve me qendër në SHBA, në vitin 2010, Shqipëria kishte 538 mijë hektarë pyje që mbulonin rreth 20 për qind të territorit të saj.

Që nga miratimi i i moratoriumit në vitin 2016, në Shqipëri janë shkatërruar më shumë se 6858 hektarë pyje, pjesa më e madhe e tyre për shkak të shpyllëzimit.

Të dhënat e 'Global Forest Watch' tregojnë se një nga tre rajonet më të prekura nga shpyllëzimi në 20 vitet e fundit ka qenë ai i Dibrës, i cili ka humbur më shumë se 6 mijë hektarë pyll nga vitit 2001 deri në vitin 2020, nga ta cilat 598 hekatarë janë humbur pas miratimit të moratoriumit.

Të dhënat e Prokurorisë së Dibrës tregojnë se në dy vitet e fundit janë regjistruar 50 procedime penale për veprën e 'prerjes së paligjshme të pyjeve', por vetëm dy raste janë dërguar për gjykim në gjykatë.



Pemë e prerë për dru zjarri në qafën e Murrizit | Foto : Besar Likmeta

Të dhënat e Prokurorisë së Dibrës tregojnë se në dy vitet e fundit janë regjistruar 50 procedime penale për veprën e 'prerjes së paligjshme të pyjeve', por vetëm dy raste janë dërguar për gjykim në gjykatë.

Nga analiza e prokurorisë Dibër e vitit 2020, theksohet se pavarësisht se kishte shumë procedime për këtë vepër penale, prokurorët kanë zgjedhur të heqin dorë nga ndjekja penale dhe ti referojnë rastet për gjoba administrative, për shkak se masat administrative janë shumëfish më të larta se kundravajtja penale.

"Duhet theksuar se masa e dënimit me gjobë është shumëfish më e lartë për kundërvajtjen administrative - për të cilën aplikohet një gjobë prej 5 milionë lekësh në bazë të ligjit nr.5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë" se sa për kundërvajtjen penale, ku në bazë të nenit 34 të Kodit Penal, masa e dënimit me gjobë mund të jetë nga 50 mijë deri në 3 milionë lekë", thuhet në analizën vjetore të Prokurorisë Dibër për vitin 2020.

Edhe ligji i ri "Për pyjet", i miratuar në prill të vitit 2020, përmban ndëshkime administrative të larta për prerjen dhe transportin e paligjshëm të materialit drusor. Por ngjashëm me moratoriumin edhe masat e parashikuara në këtë ligj nuk zbatohen për shkak të mungesës së akteve nënligjore, duke mos e ndalur aktivitetin e paligjshëm të motorsharrave në qarqet verilindore të vendit.

"Ligji 57/2020, nuk i ka kufizuar prerjet e paligjëshme dhe ende nuk po funksionon, pasi ka akte nënligjore që nuk kanë dalë akoma," tha bashkia Klos në një përgjigje me shkrim për BIRN.

Sipas ligjit, bashkitë, të cilat kanë tashmë nën administrim shumicën e pyjeve në vend, do të duhet të ngrenë inspektoriate të specializuara dhe një task-forcë që ndërlidh Policinë e Shtetit, inspektorët e pyjeve dhe Inspektoriatin Kombëtarë të Mbrojtjes së Territorit, por në mungesë të akteve nënligjore kjo strukturë ende nuk është krijuar.

Inspektorët vendorë pranë bashkisë Mat dhe Bulqizë i thanë BIRN se vetëm gjatë vitit 2020 kanë sekuestruar rreth 471 m2 dru, por sasia e pyjeve e prerë në mënyrë të paligjshme besohet se është shumë herë më e madhe.

Ndërkohë në bashkinë Dibër që prej hyrjes në fuqi të ligjit 'Për pyjet' janë indetifikuar 22 raste të prerjeve të paligjshme deri në korrik të vitit 2021

KRIZË ENERGJETIKE

Të pandehurit e proceduar penalisht për veprën penale 'prerja e paligjshme e pyjeve' në vendimet e Gjykatës së Dibrës të analizuara nga BIRN shfaqen të penduar. Gjyqtarët ndër të tjera kanë arsyetuar se bëhej fjalë për persona të padënuar më herët dhe që nuk konsideroheshin të rrezikshëm dhe për këtë nuk mund të mbaheshin në burg.

Në një vendim të datës 30 qershor 2020, ndaj një një personi të ndaluar me një kamion me dru të njomë, gjyqtari Ardit Kuka thotë

"Duhet theksuar se masa e dënimit me gjobë është shumëfish më e lartë për kundërvajtjen administrative - për të cilën aplikohet një gjobë prej 5 milionë lekësh në bazë të ligjit nr.5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë" se sa për kundërvajtjen penale, ku në bazë të nenit 34 të Kodit Penal, masa e dënimit me gjobë mund të jetë nga 50 mijë deri në 3 milionë lekë", thuhet në analizën vjetore të Prokurorisë Dibër për vitin 2020.

"Kriza në sektorin e pyjeve kërkon zgjidhje ekonomike bazuar në parimin e diversifikimit dhe përdorimit eficent të burimeve të energjisë, më shumë sesa rregullim i kuadrit ligjor apo i lidhur me keqqeverisjen dhe keqmenaxhimin e tij.

se i pandehuri ndërsa ishte shfaqur i penduar, pretendoi se kishte prerë dru i detyruar nga gjendja ekonomike.

Ai u dënua me 80 mijë lekë gjobë për dëmin e shkaktuar, por gjyqtari konstatoi se për shkak të situatës ekonomike ai nuk mund ta paguante gjobën njëherësh dhe i dha kohë një vit, ndërsa gjoba u nda në katër këste.

Inxhinier Vullnet Tafa, përgjegjës i sektorit të Pyjeve dhe Kullotave në bashkinë Dibër thotë se varfëria dhe mungesa e alternativave për të siguruar mjete për tu ngrohur shtyn shumë banorë të zonës ta shkelin ligjin.

"Shkalla e lartë e dëmtimit në pyje duhet konsideruar si krizë energjitike, që aktualisht kërkon zgjidhje," shprehet Tafa, i cili theksoi se as ligji i ri dhe as moratoriumi nuk mund t'i japin zgjidhje përfundimtare këtij problemi.

Ai thekson se nevoja për dru zjarri, që për shumicën e banorëve të këtyre zonave është burim i vetëm energjie, krijon një situatë që nuk mund të ndalohet me ndëshkime. Inxhinieri paralajmëron se pa një zgjidhje përfundimtare të problemit të ngrohjes së popullsisë me burime të tjera alternative të energjisë, nismat ligjore nuk mund ta ndalojnë shpyllëzimin.

"Kriza në sektorin e pyjeve kërkon zgjidhje ekonomike bazuar në parimin e diversifikimit dhe përdorimit eficent të burimeve të energjisë, më shumë sesa rregullim i kuadrit ligjor apo i lidhur me keqqeverisjen dhe keqmenaxhimin e tij, fenomenet korruptive apo çështje të tjera të organizimit apo funksionimit," përfundoi Tafa.

(Marrë nga www.reporter.al)

Kryerja e këtyre punimeve, pa asnjë studim e projekt të miratuar si; - shkarkimi i dherave në shtratin e lumit Seta, rrëshqitjet e masivit të argjilës, inerteve të malit, ndikuan në këtë katastrofë mjedisore.

Kompania Bio-Trofta në Arras, pas humbjes prej 300 mijë USD në rezervatin e peshkut, humb edhe gjyqin

Gjykata e Dibrës, pas rreth 5 vitesh, zbardh vendimin për zgjidhjen e konfliktit mes kompanisë Bio-Trofta Dibër dhe asaj të HEC "Balkan Green-Energy", të cilat shfrytëzojnë rrjedhën e lumit Seta, për bizneset e tyre.

Nga **HYSEN LIKDISHA**



Pas një zvarritje prej rreth 5 vitesh, më në fund Gjykata e Shkallës së Parë Dibër, me Vendimin nr.208 datë 09.06.2021, ka zbardhur vendimin, për zgjidhjen e konfliktit, mes një kompanie të kultivimit të peshkut, Bio-Trofta Dibër, mbi lumin Seta dhe asaj të hidrocentralit "Balkan Green Energy" (BGE), te cilat shfrytëzon ujin e lumit Seta, për bizneset e tyre.

Kështu pas një beteje të gjatë prej 56 seancash gjyqësore, gjykata në qershor, vendosi fitoren e HEC-it, ndaj shoqërisë Bio-Troftën Dibër.

Konflikti ka nisur më 10 nëntor 2016, kur nga reshjet e dendura të shiut, që vijuan nga 10 deri 13 nëntor, shembet kanali së bashku me tubacionin e ujit të Hec-it në Arras, marrë me konçesion nga kompania BGE. duke shkaktuar edhe shembjen e një masivi argjilor tek vepra e marrjes se ujit. Masivi rrëshqitës me gjatësi lineare shtrirje prej rreth 1 km dhe thellësi shkëputje prej 5-6 m, duke përfunduar në lumin Seta, duke e ndotur atë Ndotja me zhavor, llum argjili dhe aluvione të ndryshme, e ujit të lumit, shkaktoi dëme të mëdha në rezervatin e peshkut të kompanisë Bio-Trofta Dibër, ku sipas saj, u dëmtua 80 përqind të prodhimit.

PADIA ME ARGUMENTE DHE KUNDËR ARARGUMENTET E PALËS SË PADITUR

Kompania Bio-Trofta, për dëmin e shkaktuar në rezervatin e peshkut akuzoi kompaninë e HEC-ve BGE, me pretendimin se rrëshqitja e masivit argjilor, ka ndodhur si pasojë e kryerjes së punimeve të paligjëshme, që kjo kampani zhvilloi në zgjerimin dhe thellimin me 50 cm të kanalit të marrjes së ujit për hec-in. Kështu Bio-Trofta, paditi në Gjykatën e Shkallës së Parë Dibër, kompaninë e Hec-ve BGE, për dëmin e shkaktuar ndaj saj.

Gjykimi filloi pas kësaj padie, për një dëm në vlerën 300 mijë euro, në dhjetor 2016

Bio-Trofta, pretendonte se dëmtimi në rezervatin e peshkut, erdhi si rezultat i punimeve pa leje ndërtimi, mjedisore dhe pa studim gjeologjik, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën e konçesionit. Kështu, sipas saj, kompania BGE, ka rritur kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike nga 1.2 megavat që mori konçesionin e parë në 4.8 megavat, pra 4 herë më të madh, duke thelluar e zgjeruar kanalin e prurjes së ujit. Këto punime, thotë për Rruga e Arbërit, administratori I shoqërisë Bio-Trofta, Bajram Krashi, janë bërë në kundërshtim me kontratën konçesionare, të miratuar me VKM nr 467 datë 03/ 10/ 2002, ku në këtë vendim nuk është miratuar rritja e prodhimit në 4.8 megavat. Të gjitha punimet, vijon të tregojë për Rruga e Arbërit, administratori Krashi, u bënë pa lejen KRRT, pa studim gjeologjik, hidro-gjeologjik, mjedisor etj. Gjatë kryerjes së punimeve dherat u hodhën pa kriter në lumin Seta dhe në anët e kanalit. Çarjet në dyshemenë e kanalit, si pasojë e përdorimit të lëndës eksplozive, në pjesën shkëmbore, ndikuan në plasaritjen e tabanit të trasesë së kanalit. Po kështu, nga këto punime të kryera nga shoqëria BGE, vijon të tregojë Krashi, rritja e peshës së presionit mbi argjilin me mbi 4 herë, u bënë shkak për shembjen e masivit argjilor. Por jo vetëm edhe të dherave të hedhura pa kriter, nga punimet e paligjëshme, për zgjerimin dhe thellimin e kanalit ujësjellës. Ndërkohë, vijon ai, të gjitha këto ndërtime, nga pala e paditur, kanë vijuar pa leje ndërtimi, pa leje mjedisore, pa studim gjeologjik në kundërshtim me kushtet e përcaktuara, në kontratën e konçesionit, të kësaj shoqërie.

"Një grumbullim i tillë i masës argjilore bllokoi të gjitha velzat e troftës me llum e zhavor, duke prishur kështu cilësinë në përbërjen e ujit, gjë e cila çoi në ngordhjen e 500 kv peshku,deklaron, Bajram Krashi. Ndodhur para kësaj situate, shoqëria Bio-Trofta, paditi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, shoqërinë BGE, të H/C Arras, për ta dëmshpërblyer , për dëmin e pësuar.

Zvarritja e gjykimit, shkak i mungesës së ekspertëve.

Gjykimi filloi, pas padisë së Bio-Troftës, për të detyruar palën e paditur (BGE), të paguajë:

1- Dëmin e shkaktuar paditësit, nga punimet e kryera pa leje mjedisore, në Hec-in Arras, të marrë në konçesion, në shumën 56.563.174 lekë .

2- Të detyrohet pala e paditur, të bëjë rehabilitmin e masivit argjilor tek vepra e marrjes, me studim hidrogjeologjik, që të jepet garanci, për aktivitetin prodhues, të kërcënuar të paditësit.

3- Detyrimin e palës së paditur, për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, sipas faturave të administruara , në dosjen gjyqësore, ekspertë dhe avokatë.

Gjykimi nisi në muajin dhjetor 2016, pore curia e tij, nuk ishte e zakonshme, për shkak të zvarritjeve të shpeshta të seancave gjyqësore.

Saga e zhvillimit të seancave gjyqësore, mes Kompanive Bio-Trofta dhe BGE, të cilat shfrytësojnë ujin e lumit Seta, për bizneset e tyre, eci me mjaft vështirësi, duke zgjatur për rreth 5 vite. Një zvarritje e tilla erdhi si nga shtyrja e seancave, për mungesë të avokatëve, sidomos atij të palës së paditur BGE. Por ajo që ndikoi dukshëm, në këtë zvarritje, ishte mungesa e ekspertëve të fushave të ndryshme si; mjedisi, hidro-gjeologjisë, vlerësimit të dëmit, kontabilistë etj, etj.

Në zhvillimin e seancave gjyqësore, pala paditëse, këmbëngulte sipas saj, me prova dhe fakte, se dëmtimi i madh i saj, kishte ardhur si pasojë e punimeve të paligjëshme, që pala e paditur, kishte bërë në vazhdimësi që nga viti 2012, në zgjerimin dhe thellimin e kanalit të marrjes së ujit për Hec-in.

Por nëse pala paditëse, i konsideronte këto punime pa leje, si shkakun e rrëshqitjes së masivit argjilor, që dëmtoi rezervatin e peshkut në 80% të prodhimit, pala e paditur BGE, e kundërshtonte një gjë të tillë, duke pretenduar se situata e krijuar ishte thjesht një aksident natyror, shkaktuar nga reshjet e dendura të shiut më 10 nëntor 2016 dhe nuk kishte lidhje me punimet e kryera prej saj.

VENDIMI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR, ME ARGUMENTE E KUNDËR-ARGUMENTE TË PALËS PADITËSE

Më në fund, pas 56 seancash, me rreth 37 orë, Gjykata Dibër, arriti të japë vendimin për zgjidhjen e këtij konflikti, mes dy shoqërive të biznesit.

Vendimi gojor u dha më datë 09.06.2021 dhe u zbardh i arsyetuar zyrtarisht në tetor2021. Rruga e Arbërit, ka mundur të sigurojë një kopje të vendimit të Gjykatës Dibë, citojmë:

-Në seancën e datës 09.06.2021, Gjykata Dibër, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me nr. Regj. Them.286 që i përket:

Paditëse: Shoqëria Bio-Trofta Dibër me NIUS J67125751M

E paditur Kompania Balkan Green Energy (BGE) shpk me NIUS k71624026M.

Objekti: Detyrimi e palës së paditur të paguajë dëmin e shkaktuar paditësit nga punimet e kryera pa leje mjedisore në Hec-in Arras, të marrë me konçesion, në shumën 56.563.174 lekë (Pesëdhjetë e gjashtë million e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

-Të detyrohet pala e paditur të bëjë rehabilitimin e masivit argjilor tek vepra e marrjes, me studim hidrogjeologjik, që të jepet garanci, për aktivitetin prodhues, të kërcënuar të paditësit.

- Detyrimin e palës së paditur për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, sipas faturave të administruara në dosjen gjyqësore, për taksë gjyqësore, ekspertë dhe avokatë.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të palës paditëse dhe të palës së paditur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, pasi administroi provat e paraqitura në gjykim, dëgjoi palën paditëse që në pretendimet përfundimtare kërkoi pranimin e kërkesë-padisë, palën e paditur e cila kërkoi rrëzimin e kërkesë-padisë,

Pas arsyetimit juridik të kërkesë-padisë, Gjykata bazuar ne nenet 126-306 të K. Pr. Civile, Gjykata konkludoi se gjatë gjykimit, nuk u vërtetua, se dëmi që i është shkaktuar palës paditëse, të jetë rrjedhojë e veprimeve të palës së paditur, pra mungon lidhja shkakësore. Gjykata, thuhet në vendimin e marrë prej saj, konkludon në rrëzimin e padisë, sit ë pabazuar në ligj dhe në prova

Për këto arsye, Gjykata, bazuar në nenet 126-306 të K.Pr.Civile:

V E N D O S I

1- Rrëzimin e kërkesë padisë.

2- Shpenzimet gjyqësore, në ngarkim të palës paditëse.

3- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim brënda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat, nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar..

Në arsyetimin e këtij vendimi nga Gjykata, thuhet se gjatë gjykimit, nuk u provua në asnjë rast, se në datën 10.11.2016, të ketë ndodhur rrëshqitje dheu, në veprën e palës së të paditurit, e cila të ketë dëmtuar aktivitetin e palës paditëse. Asnjë nga ekspertët e caktuar gjatë gjykimit, nuk arriti në përfundimin e mësipërm. Në këto kushte, vijon të thuhet në arsyetimin e vendimit, ky ngeli një pretendim i palës paditëse. Gjatë gjykimit, nuk u vërtetua se dëmi që i është shkaktuar palës paditëse, të jetë rrjedhojë e veprimeve të palës së paditur, pra mungon lidhja shkakësore. Ndaj Gjykata e Shkallës së Parë Dibër, konkludon në rrëzimin e padisë, si të pa bazuar në ligj dhe në prova, thuhet në zbardhjen e vendimit të kësaj gjykate.

Me këtë vendim të dhënë nga Gjykata, nuk ishte dakord, pala paditëse. Avokati mbrojtës i shoqërisë Bio-Trofta, Xhemal Gazidede, tha për Rruga e Arbërit, se vendimi i marrë nga Gjykata Dibër, është një vendim i pabazuar në ligj dhe prova e fakte. E konsiderojm një vendim të njëanshëm dhe si i tillë, do ta ankimojmë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BIO-TROFTA SHPK, APELON VENDIMIN NË GJYKATËN E APELIT TIRANË.

Me vendimin nr.208 datë 09.06.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila rrëzon padinë e Bio-Troftës, si të pa bazuar në ligj dhe prova, pala paditëse, Bio-TRofta shpk, nuk ishte dakord, ndaj e apelojë atë në **Gjykatën e Apelit Tiranë**. Rruga e Arbërit, ka mundur të sigurojë kërkesë-padinë e Bio-Troftës, dërguar kësaj gjykate, ku apelon kundër vendimit nr. 208 datë 09.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, si të pa bazuar në ligj dhe prova. Ja disa nga argumentet, që sipas avokatit të Bio-Troftës, Xhemal Gazidede, rrëzojnë vendimin e dhënë nga Gjykata Dibërës:

1.- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka nxjerrë konkluzione të gabuara, nga përmbajtjet e Akteve të Ekspertimit. Nëpërmjet



Në konkluzionet e Akt Ekspertizës Gjeologjike, të përpiluar nga eksperti, i caktuar nga gjykata, thuhet se: -Shkaku determinant i dëmit të shkaktuar, është shoqëria BGE, për të gjithë punimet e kryera pa kriter dhe pa asnjë studim gjeologjik, që kanë ndikuar direkt në dëmin e shkaktuar paditësit.

këtyre akteve, provohet se punimet janë bërë pa leje, të instancave përkatëse dhe për pasojë plan-projekte inxhinierike të duhura. Kështu është evidentuar dëmtim i zonës së ndërtimeve nga kjo shoqëri si; krijim skarpatesh, që kanë çuar në destabilizim të shpatit. Nëse do të ishin bërë me studim gjeologjik punimet nga ana e kompanisë BGE, kjo zonë sipas ekspertëve, hidro-gjeologjikë e inxhinierikë, thuhet në ekspertizat e ing.Remzi Pupli e Ilmi Gjeta, konkluduan se kompania e Hec-it, ishte përgjegjëse për dëmin e shkaktuar, Bio-Troftës. Kjo pasi sipas tyre, për shkak se kompania kishte bërë punime pa studime dhe dhe nuk kishte rehabilituar pjesën e lumit, siç kërkohet..

- Ndërkohë, në konkluzionet e Akt Ekspertizës Gjeologjike, të përpiluar nga eksperti, i caktuar nga gjykata, thuhet se: -Shkaku determinant i dëmit të shkaktuar, është shoqëria BGE, për të gjithë punimet e kryera pa kriter dhe pa asnjë studim gjeologjik, që kanë ndikuar direkt në dëmin e shkaktuar paditësit.

2.- Gjykata Dibër, sipas av Gazidede, nuk ka hetuar në lidhje me zbatimin e kontratës konçesionare , miratuar me VKM nr. 930 datë 02.08.2009, nga shoqëria BGE.

3.- Së treti Gjykata Dibër, nuk ka hetuar në lidhje me kryerjen pa leje të ndërtimeve, moszbatimin e Lejes Mjedisore dhe pa plan gjeologjik, nga pala e paditur.

Përfundimisht, thotë avokati, të gjitha këto punime të paligjëshme, janë shkaku i dëmtimit të biznesit të shoqërisë Bio-Trofta. Kjo për faktin se kryerja e këtyre punimeve, pa asnjë studim e projekt të miratuar si; - shkarkimi i dherave në shtratin e lumit Seta, rrëshqitjet e masivit të argjilës, inerteve të malit, ndikuan në këtë katastrofë mjedisore. Shoqëria BGE, si rezultat i shkatërrimit të bazamentit, për të krijuar një shesh për kanalin e prurjeve shtesë të ujit, në H/C, nga 12-15 ml gjërësi dhe skrapate me 20 ml pa asnjë thyerje me minitarraca, për të eleminuar rrëshqitjet, krijuan këtë katastrofë, që solli pasojën për shoqërinë Bio-Trofta, duke i shkatërruar pothuajse plotësisht të gjithë biznesin e saj, mbi 20 vjeçar, me një dëm të konsiderueshëm ekonomik.

Udhëtim në peizazhet e Gjarecës

Nga **SELMAN MEZIU**

Pasdite gushti. Dielli po i afrohej përvëlues vargmalit të Runjës. Me ato njollat bukuroshe të pyjeve të ahut, sikur t'i kishte vendosur ndonjë arkitekt peizazhist. Megjithëse, njeriu edhe atje, ka filluar me i zhgarravit ato. Më duhet të le udhën majtas. E të ngjitem djathtas. Çuditërisht para pak vitesh ajo vazhdonte rrafsh. Ndërsa tani në ngjitje dhe e gërryer nga shirat. Kështu që nuk kalojnë as traktorët me zinxhirë. Poshtë saj vazhdon një rrjet teli, ku brenda jeshilon bari, drurë e shkurre të mbjellë jo më shumë se dy vjet. Në këto brigje me pak dhe, e me shumë shiste argjilore ka ndodhë çudia. Po, vërtet, uji i Drinit, teknologjia e re apo paraja e kanë zbukuruar?

Shpat me strukturë toke gurishtore. Tubacione të mëdha që ngjitin ujin përpjetë. Nëpërmjet kanalit që ndërpritet nga masa betoni e muresh. Pjerrësia dhe dheu i pakët mbi sistemin gurishtor shiste kanë sjellë emërtimin "Shpatet e Gjarecës". Vazhdoj në drejtimin juglindor. Pas disa dhjetëra metrash udha automobilistike ndërpritet. Sa keq nuk arrin të bashkohet me ish atë horizontale, ndërtuar aty rreth viteve 1970. E cila përbënte unazën e kodrës së Gjarecës. E çfarë na duhet në këto kohë moderne e të vetëzhdukjes se dhimbshme të katundeve përqark.

Poshtë kësaj udhe në një kthesë, e cili bie thikë mbi shtratin e Drinit ngrihet Kepi i Shpajs (shtëpisë). Emërtim ndoshta i ardhur nga forma e lartësia e tij. Edhe këtu dikur, ziente në stinën e Verës nga fëmijët që laheshin poshtë tij. Rrjedhja kaltëroshe, gjarpëruese është larguar. Tani poshtë shkëmbit gjigant kemi zhavorrishte e grupe shelgjesh ngjyrë argjendi. Vazhdojmë udhëtimin shpateve të kodrës stërmadhe të Gjarecës, ose Gjarajcës pse jo Gjaricës. Pas një kurrizi vjen një luginë që zgjatet e thellohet në ngjitje, ndërsa poshtë, sa vjen e zvogëlohet, derisa nën rrugës automobilistike zhduket. Ngaqë janë disa, quhen Lugjet e Hoxhe. Shtëpitë e të cilëve duken fare mirë përballë, matanë Drinit mbuluar me gjelbërim.

Ngjitem faqeve të luginës me peizazh trishtues. Qilimi i barit të thatë në disa rrafshina gjysmë harqesh dhe ndërmjet tyre të thara nga vapa e gushtit. Këto quhen taraca ose brezare. Historia e tyre ka rrënjë gjashtëdhjetë vjeçare. Ndërtuar me kazma e lopata. Punë e lodhshme disa vjeçare e fshatarëve që punonin në NBSH (Ndërmarrje Bujqësore Shtetërore). Pra, janë produkt i forcave, energjive, vullnetit të fshatrave përqark kësaj kodre. Diku shikohet ndonjë arrë e vetmuar dhe e ligshtueme. Ndoshta nga vetmia. Ndoshta nga dhimbja e zhdukjes të simotrave. Diku lartësohet një dardhë e egër, gorricë me gjemba të forta e gjethe të vogla në formë elipsi me push të bardhë poshtë, të dendura. E mbushur me frutat e saja karakteristike. Lloji që i përballon thatësirave të tejzgjatura e këtyre shpatinave. Pastaj ferrmana në grupe. Njollat e fierit duken aty këtu me një shkamb ngjyrë të zezë pothuajse në pjesën sipërme të shpatit majtas.

Brezaret i ngjajnë një amfiteatri antik të braktisur prej kohësh. Të pushtuar mjerisht nga barëra, shkurre e drurë frutor të lodhur, vuajtur e përgjëruar nga natyra. Vështroi me kujdes një bimë barishtore në mes gurishtes si një tufëz e bardhë. Shumë e bukur. Më tej gjëmbaçi i bardhë. E takova shpesh në këto shpate kurrize e rrafshina. Pastaj pranë një shkëmbi një dëllinjë e vogël me



të gjelbërtën e saj të thellë e rrethuar nga bari i gjatë mjerisht i tharë. Me andej tre arra në rresht rrethuar nga ferra të shumta. Trup vogla jashtë brezareve. Sigurisht, produkt i kokrrave të arrave që dikur mbulonin të rreshtuar këto shpate kurrize e lugina deri buzë Drinit. Ja edhe lugina e Fierit, paksa e thellë ku shërben si kufi ndarës me fshatin Brezhdan. Më sipër, një shkëmb që quhet i Zyber Sadikut (Damzi). Shumë kohë më parë këtu veronin bagëtia e fisit Hoxhe ku ngrinin stanet.

Me shumë mundime ngjitem aty ku fillon rrafshina e Gjarecës, Një puset betoni ku del ujë i kthjellët plotë kaltërsi e më pak shkumëza të bardha. Ku ai me shumë vrull hynë në një kanal betoni në drejtimin verilindje. Poshtë një arë me misër. Mbi kallirin duken mustaqet e kefejta. Ajo ka humbur të gjelbërtën e thellë. Ndërsa kjo copëz arë më ngjan me një oaz plotë jetë e jeshillëk të shkretëtirës të Saharasë. Sepse përqark saj gjithçka është pa jetë, e thatë e vyshkur, e mpirë që të idhëton, të ngrinë buzëqeshjen.

Ndjekim kanalin mbushur me ujë. I gjithi i veshur me çimento. Mund të kapërcehet nga djelmoshat mbi gjashtëmbëdhjet vjeç. Në të dy anët gjelbëron bari ose ndonjë shkurre si shkoza, frashëri e ndonjë lloji dushku. Papritmas, ai merr një kthesë dhe vazhdon udhëtimin e tij për të gjallëruar bimësinë e arave, kopshtijeve, bahçeve, e dhënë jetë liqeneve, lëndinave përroskave.

Përpara një peizazh i përthyer, me lugina e kurrize. Ato fillojnë në harkun e rrafshinës së Gjarecës, pastaj humbin për gjatë udhëtimit në zbritjen, poshtë në drejtim të udhës automobilistike Fushë Muhurr - Peshkopi. Të cilët formojnë përroin e Lleshe, i cili pas disa



kilometrash derdhet në Dri. Pra, formohet një gjysmë hinke me këto relieve me prerje gjatësore që emërtohen ose thirren Lugjet e Lleshe. Vetë Gjareca ka qenë mera e fshatrave përqark, por me zbritjen e fiseve të ndryshme nga Bulaçi malor një pjesa e tyre edhe janë ndarë në toka, pyje ose kullota private.

Për ta mbajtur lexuesin lidhur pas rreshtave të shkruar po fillojmë të përshkruajmë shkurt sipas toponimeve këta peizazh sa të thyer e kurriz zhveshur aq edhe lugina që hieshohen nga drurë të veçuar shelgjesh, plepash arrash etj. Lugu i Dhelprës është këtu pranë nesh që zbret vrullshëm, por në shpate me disa arra kurorë gjëra aty këtu, "mbeturina" të gjelbërta që i kana shpëtuar kasaphanës të pas viteve '90 të shekullit që mbyllëm. Luginë e veshur me bimësi shkurrëzash pak të dobishme që ndoshta i kanë dhënë emrit ngaqë gjejnë vend të jetojnë dhelprat. Ajo zbret deri pak poshtë rrugës automobilistike duke u bashkuar me një degëzim tjetër përroi.

Lugu i shtrembër është më pak i thellë me dy kurrize të mprehta, me shumë pak shkurre e bimësi barishtore. Rrallë herë duken formacione rrasash, duke i dhënë një pamje të zymtë. Ndërsa ndryshe shfaqet lugu i Ujit, ku kemi një burim i cili iu ka dhënë jete disa plepave e shelgjeve edhe pse të rralla. Lugu i Gjanë ka shpate me sipërfaqe të madhe e me njolla bimësie aty këtu. I tillë shkon deri në rrafshinën gjatësore të Gjarecës. Të tre këto lugina pëfundojnë mbi rrugën automobilistike duke formuar një rrafshe të stërgjatur me maje te rruga. Shumë vite më parë ka qenë e mbushur ose rriteshin mollë. Tani ka vendosur shtëpinë Sefedin Lleshi nga



Bulaçi duke i kthyer peizazhit gjallërinë, bukurinë, me arat, jonxhat, misrat, bahçen, shtëpinë dhe stanin.

Tani ngjitem në rrafshinën e Gjarecës. Edhe pse pak hapësira gjatoshe me rrafshina të daluna në krahun verior e jugor në formë gjuhëzash. Nuk shikoi ndryshime thelbësore në mbulesën bimore e cilësitë e tokës. Po ai qylym bari, i pafund, i zhuritur nga vapa e tej zgjatur, me disa dëllinja trup vogla me të gjelbërtën e thellë. Përshkruar kjo nga një udhë automobilistike ku shirat e pakta kanë filluar gërryerjet duke lënë kështu gjurmët e shkatërrimit të saj.

Në rrafshen e Shenjes me lartësi 506 m mbi nivelin e detit është ngritur një antenë e kompanisë Vodafon. Kjo kullë e çeliktë të befason. Vepra e vetme, për këto tridhjetë vjet demokraci. Megjithëse pozicioni i kodrës së Gjarecës është strategjik në luginën bukurishumtë të Drinit të Zi. Ngjarjet e shumta tregojnë se ka qenë e preferuar nga pushtuesit turq, serb, bullgar etj. Beteja të përgjakshme e luftime deri trup me trup janë zhvilluar ndër shekuj nga muhurrakët e dibranët e shumtë këtyre relieveve me thyerje gjatësore. Dhe ja lexoni se çfarë më ka thanë i ndjeri Bajram Hysen Mani në një intervistë: "Në luftën e Gjarecës (1920) kanë marrë pjesë: Dini Hoxha, Hysen Mani, Liman Xhani, Dan Leka, Liman Berisha dhe gjithë meshkujt e zonës së Muhurrit". Tokë e përthyeme, kodër në formën e një breshke, me bimësi shumë të varfër këto vite, në kapilarët e saj ka ujë, ku ka sjell burime në pjesët fundore, por në kapilarët e saj ka edhe shenja gjaku e djerse të derdhur në luftën për mbrojtjen e trojeve, familjeve e në punën për lulëzim e prodhim për të jetuar.

Ulem poshtë deri në tehun, ku fillon një luginë, por që ka shpate të pjerrëta, shtratin e ngushtë mbushur me bimësi të pa dobishme, e në fund ara të mbjella. Më tej hapet shtrati i Drinit prej disa hektarësh me ngjyrën e gjelbërt në të argjend. Ndërsa Drini ka gjetur shtratin e tij rrëzë malit të Mollës, si një kordele e kaltër. Mbi atë, një peizazh trishtues, lakuriqësi trupëruese, ngjyrë kafe, shpatesh, rrafshinash e kodrash krejtësisht të zhveshura. Rrjedhojë e shkatërrimit të mbulesës pyjore në vitet 1980, për t'i kthyer në livadhe polifite, për të ushqyer blegtorinë.

(vijon në faqen 18)

Rruga e Arbërit nr. 182

vendlindje



Radoveshi

FSHATI ME KULAKË

Nga dr. **Besnik RAMA**

Radoveshi njihet historikisht si një ndër fshatrat më të begatshme të krahinës së Gollobordës. Doje drithëra, i gjeje; doje pemë, i kishe me bollëk; doje livadhe e pyje, nuk mungonin në të katër anët; doje trima, gati ishin në çdo kohë; doje nuse për shtëpi, nuk zhgënjeheshe; doje ustallarë, mjaftonte t'i kërkoje; doje mundës, kampionë i kishe; doje burime, mund te freskoheshe si askund tjetër. Shkurt, aty nuk mungonte asgjë. Si askund tjetër, në fshat ishte dhe një arrë budallaqe, e cila nuk gabonte asnjë vit të bënte fruta me thasë.

Në gjithë këto të mira, fshatit iu ngjit dhe një e keqe, që e mbajti gati dyzet vjet. Në fillim të viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar e bënë fshat me kulakë. Se si erdhën punët deri aty, është e pashpjegueshme dhe e vështirë të kuptohet dhe sot e kësaj dite. Një shtëpi me kontribute edhe në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, një ditë prej ditësh u zgjua me damkën "kulakë". Po kështu dhe një tjetër shtëpi në lagjen përballë. Në fëmijërinë time të hershme, as që ia kisha idenë se çfarë donte të thoshte kulak. Nuk bëj dot të diturin. Më vonë, kur nisa të frekuentoj bibliotekën e shkollës 8-vjeçare, hapa fshehurazi fjalorin e gjuhës shqipe dhe, me nxitim, gjeta fjalën "kulak". E lexova gjithë frikë. E mësova kuptimin e fjalës, por nuk gjeja ndonjë lidhje mes kulakëve të fshatit tim dhe atij shpjegimi. "Fshatar i pasur" – ata nuk kishin pasuri (as kishin pasur aq sa të quheshin të pasur), "që kishte shumë tokë" – nuk kishin aspak më shumë toka se të tjerët (as para kooperativës), "shfrytëzonte punën e argatëve a të fshatarëve të varfër dhe pasurohej në kurriz të tyre" – bashkëfshatarët e mi shkonin argatë te njëri-tjetri sa herë i kishin punët deri në fyt (p.sh., në muajin e dushkut, në kohë prashitjesh apo të korrash etj.). Do thoni ju: Çfarë të shtyu të hapësh fjalorin për fjalën "kulak"?! Po vazhdoja klasën e shtatë. Në pranverë, shkolla bëri një aksion për të mbledhur humus. Shkrova një kronikë dhe m'u botua në revistën "Pionieri" (e kisha aq të dashur sa mezi prisja të vinte, ndaj postieri, Bektashi, veteran lufte, që e dinte këtë, nxitonte e trokiste në orën e mësimit për të ma dhënë në dorë). Gëzimi i botimit të asaj kronike për mua zgjati vetëm një ditë, sepse dikush nga shokët e klasës kishte vërejtur që unë kisha lavdëruar edhe Xhelalin. Xhelalin e kisha moshatar dhe shok klase, por nuk u dashka lavdëruar, sidomos në revistë apo gazetë, se ishte djalë kulakësh (ndërkohë që i ati i tij, Rifati, ishte veteran lufte!). Në darkë, mora stilografin dhe e fshiva me bojë emrin e Xhelalit te revista ime. Dhe jo vetëm të Xhelalit, po fshiva dhe dy emra të tjerë që kishin lidhje gjaku me kulakët. Me këtë veprim, e qetësova veten – mendje fëmije: fshiva emrat në revistën time, po ata ishin të shkruar në mijëra kopjet e tjera anembanë të "Pionieri"-t!

Gjatë viteve në vazhdim mësova më shumë gjëra për "të prekurit" (njerëzit me biografi të keqe), siç i përmendnin sa herë binte fjala për të cilësuarit "kulakë". Megjithatë, nën zë mësova se "shkak" që "kishin merituar të jenë kulakë" na qenka një zënkë në kohën e luftës midis më të madhit të djemve të Izeirit, Istrefit, dhe komandantit H. Lleshi. Istrefi kishte bërë burg. Po kështu dhe vëllain e tij, Qamilin (Qamon) e kishin burgosur dy herë, herën e dytë për ca fidanë lisi që i paska prerë për hunj gardhi.

Duke u vlerësuar si armiq të klasës, kulakët mbaheshin të izoluar nga pjesa tjetër e fshatit. Ata nuk kishin triska fronti (Fronti Demokratik i Shqipërisë). Si të tillë, nuk mund të merrnin pjesë në mbledhjet e popullit, nuk kishin të drejtë të votonin, sa herë bëheshin zgjedhjet (për t'u zgjedhur as që bëhej fjalë). Shtëpitë e tyre ishin nën vëzhgim e kontroll nga sigurimi i shtetit. Nëse tek ata vinin miq, mbaheshin nën mbikëqyrje derisa iknin nga kishin ardhur. Vonë mësova se, sa herë që arratisej nga burgu ndonjë i dënuar, shtëpia e kulakëve rrethohej nga çeta e gatshme e zonës gjithë natën dhe vëzhgohej gjithë ditën se mos i arratisuri vinte e strehohej aty. Kjo duket shumë qesharake kur e kujton. Ku e si do ta gjente një i burgosur, ngado që të ishte, shtëpinë e kulakëve? Sa kohë i duhej atij të udhëtonte nga burgu deri në fshatin tonë? Frika e pushtetit ishte se mos të prekurit do të ndihmonin të pakënaqurit të arratiseshin në Jugosllavi.

Një aspekt i përjashtimit ishte mohimi i të drejtës së fëmijëve dhe të nipërve e mbesave të kulakëve për të ndjekur arsimin e lartë, edhe pse ata mund të ishin shumë të mirë apo të shkëlqyer në mësime. Fëmijët e tyre nuk nxirreshin në tabelë nderi, as në aktivitete të rëndësishme nuk guxonte kush t'i përfshinte. Ishte një diskriminim i hapur dhe askush nuk guxonte të hapte gojën.

Më bënte përshtypje se thuajse të gjithë djemtë e kulakëve punonin jashtë fshatit, kryesisht në ndërtim, ustallarë. Si rregull, çdo shtëpi e fshatit ishte e detyruar që të paktën një mashkull të rritur ta mbante në kooperativë si krahë pune. Djemtë e Rifatit ishin shumë, por, për fat të mirë, për ta nuk kishte kufizim, siç ndodhte për të tjerët. E vërteta e kësaj "tolerance" komuniste na qenka: Kulakët të mos kenë shumë djem e burra në fshat, se ngrenë kokë. Në ndërmarrje janë nën kontroll më mirë.

Përjashtim i rëndë ishte veçimi i të prekurve në konak, në dasma e morte. Nëse në një konak burrash do të ishte i pranishëm një i prekur, i zoti i dasmës duhet të bënte shumë kujdes që aty të mos fuste ndonjë komunist, ose, para se të futej aty komunisti, i prekuri duhej "transferuar" në një konak tjetër me dasmorë më pak të rëndësishëm. Po kështu dhe në raste fatkeqësish. Kur vinte ndonjë "i prekur", e ulnin në konakun ku nuk kishte komunistë apo kuadro (kryetar kooperative a këshilli, drejtor a doktor).

Me gjithë këto shtrëngesa, në fshatin tonë ekzistonte një "harmoni e heshtur" mes të cilësuarve "kulakë" dhe pjesës tjetër të banorëve. Të prekurit, me edukatën dhe punën e tyre, impononin respekt. Sa herë bënin dasma, fshati ndiqte ceremonialet e ndryshme, megjithëse brenda avllisë hynin vetëm të ftuarit dhe fëmijët. Të organizuarit, ose ndërronin rrugë, ose kalonin "pa e kthyer" kokën.

Si simbol të "kulakëve" të fshatit po veçoj njërin, Qamon. Duhet t'i kishte kaluar të pesëdhjetat, kur unë isha nxënës në fillore dhe, si të gjithë djemtë e tjerë, shkoja për t'u qethur tek ai, ndryshe nuk na pranonte mësuesi në klasë. Ishte njeri i këndshëm, fliste me zë të plotë, pak të ngritur, por të sigurt. Tek ai shikoje një burrë që nxirrte fjalë të mençura nga goja, dinte çfarë thoshte dhe fjala e tij nuk binte në tokë. Dinte t'i jepte këshilla çdokujt. Tek ai merrnin mend edhe brigadierët e agronomët e kooperativës për punët e stinës. Një mesoburrë i papërtuar për çfarë ta doje. Një punëtor i palodhur dimër e verë. Ishte i vetmi që kujdesej për vijën e ujit që kalonte përmes fshatit. E pastronte kohë e pa kohë, edhe në ditët me akull. Nuk vazhdonte ecjen, nëse shihte në rrugë diçka që pengonte lëvizjen apo shkaktonte ndotje. Mbante elmaz e vizore dhe priste xhama sikur të ishte mjeshtër. Kavaletat e grurit dhe mullarët e barit e të dushkut askush nuk i bënte aq shpejt e aq mirë si ai. Nuk e duronte rrëmujën askund. Jetoi gjatë, e arriti demokracinë, por nuk ngriti krye kundër atyre që e shtypën. E kishin pjekur fëmijëria, vuajtjet, sakrificat, jeta gjithë sfidat. Qamos nuk i shkonte për shtat asnjë çast emri kulak. Bënte dhe mbante miq. Tek ai burrë, unë nuk munda të lexoj kurrë qenien e tij kulak. Mbahej gjithë krenari. Për gjithë sa ishte e bënte, respektohej kudo e nga të gjithë.

Rifati, vëllai i Qamos, partizan në luftë, ishte njeri i Zotit. Ai burrë që rriti tetë fëmijë, i edukoi ata me respektin për njerëzit dhe me shpirtin e punës. Punoi në ndërtim derisa doli në pension, por prapë nuk reshti së punuari. E shikoje me kosë në dorë gjatë gjithë verës dhe me parmenda e plugje në stinët e tjera. Fliste pak dhe me zë të ulët, e karakterizonte një qetësi për t'u admiruar. Kurrë nuk u dëgjua të ngrejë zërin si veteran lufte, të lavdërohet dhe të kërkojë të drejtat e mohuara. Dikush mund të mendojë se Rifati kishte frikë të ankohet, se ia bënin edhe më keq. Jo, unë mendoj se ai ndiqte një logjikë të tijën: Nuk i duheshin të drejtat atij pse kishte luftuar, sa kohë që vëllezërit e tij do të mbeteshin me "damkë".

Fshati im, të cilit i mbeti emri "Fshati me kulakë", veç pasurive natyrore, kishte dhe ka bij e bija të mrekullueshme, me botë shpirtërore të pasur, njerëz të punës.

Fshati im, që u damkos "Fshati me kulakë", kurrë nuk i luftoi "kulakët" e regjimit komunist, përkundrazi i trajtoi ata me dinjitet.

Fshati im, që nuk e meritonte të quhet "Fshati me kulakë", dha shembullin në krahinë se e di çfarë është padrejtësia dhe kurrë nuk spiunoi e nuk persekutoi "kulakët" e etiketuar nga pushtetit i asaj kohe.

Fshati im, "Fshati me kulakë", nuk pati asnjëherë qoftë dhe një incident me "kulakët", të cilët kurrë nuk ishin kulakë, ndaj mbetet me kokën lart.

Fshati im, që nuk e meritonte të quhet "Fshati me kulakë", dha shembullin në krahinë se e di çfarë është padrejtësia dhe kurrë nuk spiunoi e nuk persekutoi "kulakët" e etiketuar nga pushtetit i asaj kohe.

Fshati im, "Fshati me kulakë", nuk pati asnjëherë qoftë dhe një incident me "kulakët", të cilët kurrë nuk ishin kulakë, ndaj mbetet me kokën lart.

Me gjithë këto shtrëngesa, në fshatin tonë ekzistonte një "harmoni e heshtur" mes të cilësuarve "kulakë" dhe pjesës tjetër të banorëve. Të prekurit, me edukatën dhe punën e tyre, impononin respekt. Sa herë bënin dasma, fshati ndiqte ceremonialet e ndryshme, megjithëse brenda avllisë hynin vetëm të ftuarit dhe fëmijët.

profil

Lirim Hoxha, karriera artistike e këngëtarit që nisi nga bangat e shkollës për të ngjitur në skenat artistike të Europës këngë popullore dibrane dhe shqiptare

Familja Hoxha e Grazhdanit

Nga **NEKI OSMANI**
OSMAN XHILI

Historia shqiptare dhe ajo e Dibrës në mënyrë të veçantë, ka kaluar në periudha tejet të vështira. Njëra prej tyre, padyshim që do të ishin vitet 1913 deri më 1920, që përkojnë me mësymjet e shpeshta serbe, për të marrë Dibrën, e më pas për të dalë në zemër të Shqipërisë. Bilancet janë tronditëse dhe që ngelen gjatë në kujtesë. Ne nuk do shkruajmë për Dibrën në tërësi, pasi profesori Kristo Frashëri e më pas studiuesi Moisi Murra, kanë shkruar qartë e bukur për këtë. Ne do të mundohemi të trajtojmë efektet e kësaj tragjedie në fshatin e Grezhdanit, me protagoniste familjen e nderuar Hoxha.

Në tetor të vitit 1913 ofensiva serbe u shoqërua me djegien në masë të fshatrave, vrasjen e mijëra njerëzve të pafajshëm, dhunimin e grave dhe vajzave të pambrojtura. Nuk u kursyen as pleqtë e fëmijët. Serbia e konsideronte Dibrën si tokë sllave të pushtuar nga turqit. Po tu referohemi të dhënave të nxjerra nga arkivi i rrethit, panorama tronditëse e asaj kohe bëhet më e plotë. Në Grazhdan janë vrarë 17 veta, shumica e të cilëve janë groposur në një varr kolektiv, pak poshtë urës së Grazhdanit. Për më tepër, dy prej këtyre fatkeqëve ishin fëmijë të mitur. Janë djegur disa shtëpi, janë grabitur 40 lopë, 200 dhen, 4 kuaj dhe 56 ton misër e grurë.

Më 2 shtator 1920 ofensiva serbe u përsërit për të disatën herë në Dibër. Një varg fshatrash në zonën e Maqellarës patën një fat tragjik. Gratë e fëmijët braktisën shtëpitë, kaluan Drinin dhe u sistemuan përkohësisht në fshatrat matanë, deri në Selishtë. Një pjesë tjetër u ngjit në mal, te Guri i Erebarës. Dibranët e pritën serbin me luftë, duke bërë që të mos i arrinte objektivat e tij. Në librin "Lufta e Dibrës e vitit 1920", në faqen 231 thuhet: "Karaman Ismail Hoxha(1890), ka marrë pjesë aktive në kryengritjen e vitit 1920. Gjatë këtyre përpjekjeve, u kap së bashku me të jatin, Ismailin dhe me dyqanxhiun e fshatit, që ishte nga Dibra e Madhe. Gjyshja e Karamanit, Hajria, ishte bijë Herbeli dhe e dinte gjuhën sllave. Ajo u lutet serbëve që t'i falin dhe ata në këmbim kërkojnë një sasi floriri. Hajria e gjen floririn dhe ua sjell, por ata nuk e mbajnë premtimin. Në fillim vrasin Karamanin, pastaj Ismailin dhe në fund tregtarin. Kufomat mbetën për një kohë pa u varrosur, pasi njerëzit kishin ikur e fshati ishte bosh. Vetëm disa gra plaka dolën më vonë dhe i varrosën si mundën në oborrin e shtëpisë".

Me vendim të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Dibër, numër 72, datë 23-05-1978, Karaman Ismail Hoxha, shpallet "Dëshmor i Atdheut". Ai luftoi në mbrojtje të trojeve shqiptare dhe u përjetësua në histori.

Fisi Hoxha, siç është shquar për bujari e dituri, ashtu ka shkëlqyer dhe për trimërinë e treguar, sa herë ka qenë nevoja. Në luftë për mbrojtjen e Shkodrës nga pushtuesit malazezë kanë shkuar për të luftuar Sadik Hoxha, Shaban Hoxha, Mislim Hoxha dhe Hajredin Hoxha, bashkë me burra të tjerë të fshatit. Kontributi dhe trimëria e kësaj familje dhe e këtij fisi u shtri dhe përgjatë luftës nacionalçlirimtare. Nasuf Hoxha morri pjesë me armë në dorë në brigadën e pestë sulmuese. Ai ndërroi jetë në moshën 22 vjeçare dhe vendin e tij e zuri i vëllai, Shuipi. Në radhët e kësaj lufte për çlirim morën pjesë Hamdi Hoxha dhe Osman Hoxha, që u dalluan për guxim e trimëri.

DJALIM JETIM, AKOMA I PALINDUR

Me vrasjen e Karaman Hoxhës, bashkë me të atin, u duk sikur u shua jeta dhe aktiviteti i kësaj familje të shquar. Por Zoti nuk kishte thënë të ndodhte kështu. Gruaja e tij e re, Xhilja, kishte vetëm pak muaj shtatzënë dhe po priste ardhjen në jetë të një fëmije, që



do të dëshironte shumë të ishte një djalë. E donte djalë se dëshironte që të rritej e zhvillohej trungu familjar, por dhe që ti vinte pikërisht emrin e të shoqit, Karaman Hoxha. Sërish Zoti i plotësoi dhe këtë dëshirë, duke i dhënë një djalë të shëndetshëm e kështu filloi të rritej Karamani i ri . I pashëm, i zgjuar e punëtor, ai shpejt mori drejtimin e familjes së madhe, siç ishin të tilla në atë kohë. Si rezultat, familja e madhe u rrit dhe u zhvillua ekonomikisht, derisa erdhi momenti i ndarjes së saj. Mani, siç i thërrisnin shkurt, më pas u kujdes për familjen e tij më të vogël, duke u dhënë edukatën e punës dhe dijes.

Mani gëzonte respekt të madh në shoqëri e miqësi, pasi bënte shumë për të afërmit dhe shoqërinë. Kështu, trungu i Karamanit të vjetër, jo vetëm nuk u shua, por u shtua dhe u fuqizua shumë më tepër me fëmijë, nipër, mbesa e shumë breza të tjerë. Një nga këta stërnipër, është dhe Lirim Hoxha, që ka mbaruar Akademinë e Arteve në Tiranë.

LIRIM HOXHA, ZËRI I NGROHTË I KËNGËS DIBRANE

Thonë që talenti lind bashkë me njeriun. "Ka qenë diku nga klasa e pestë, - tregon Lirimi, - kur zysha e muzikës, Fatbardha Osmani, e pikasi talentin tim muzikor, nëse vërtet mund të quhej i tillë".

Lirimi ndiqte festivalet e këngës në radio



televizionin shqiptar, i mësonte këngët përmendësh dhe mundohej ti imitonte sadopak. Zysh Bardha e vinte t'i këndojë para klasës këngët e motrave Libohova, Parashqevi Simakut, Tonin Tërshanës, Bashkim Alibalit e shumë të tjerëve. Lirimi përjetonte kështu emocione të veçanta. Përfytyronte klasën si një skenë të vërtetë dhe shokët e shoqet, si një publik të zjarrtë që e duartokisnin pa fund.

Për momentin, jeta e tij nuk mundi të marrë drejtimin muzikor. Vazhdoi shkollën e mesme në gjimnazin e Maqellarës, por sërish nuk i ndahej këngës. Aktivizohej në

Karaman Ismail Hoxha luftoi në mbrojtje të trojeve shqiptare nga pushtuesit serb dhe u vra mre tyrë në vitin 1920. Ai është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Fisi Hoxha, siç është shquar për bujari e dituri, ashtu ka shkëlqyer dhe për trimërinë e treguar, sa herë ka qenë nevoja. Në luftë për mbrojtjen e Shkodrës nga pushtuesit malazezë kanë shkuar për të luftuar Sadik Hoxha, Shaban Hoxha, Mislim Hoxha, Hajredin Hoxha bashkë me burra të tjerë të fshatit.



korin e shtëpisë së kulturës në Maqellarë, në drejtimin e mjeshtrit Medat Burnazi. Ishte ky një ngushëllim, për të mos u shkëputur përfundimisht nga kënga, që aq shumë e pati dashur në fëmijërinë e tij. I doli e drejta e studimit për në shkollën e lartë, në fakultetin e inxhinierisë, dega gjeologji miniera. Tani dukej se çdo gjë kishte marrë fund në aspektin muzikor. Do të shtegtonte maleve të Dibrës e Shqipërisë, me çantën e gjeologut në shpinë, në kërkim të mineraleve të çmuar e do të merrte ndonjë melodi nëpër dhëmbë, shoqëruar me vargjet e këngës. Gurët, drurët e zogjtë e pyllit do të ishin publiku dhe juria që do të gjykonin për nivelin artistik të këngës.

Me shumë vështirësi të kohës, Lirimi pati siguruar një kitarë të zakonshme. Në fillim me gabime, pastaj duke u perfeksionuar, falë një pune këmbëngulëse e plot pasion. Në vitin 1995 mbrojti gjuhën angleze me notën maksimale, dhjetë, dhe kjo e njohu më nga afër me këngët e Beatles, Rolling Stones, Deep Purple, Pink Floyd, Metallica, The Doors, Nirvana e shumë të tjerë si këto.

Pak nga pak, Lirimi po e kuptonte se jeta e tij do të ishte përfundimisht e lidhur me muzikën, dashurinë e tij të parë. E kishte nxjerrë ëndrrën e vjetër nga sirtari, për të mos e futur kurrë më aty. Këndonte nëpër gëzime familjare, me një grup amator dhe shihte që këngët e tij po pëlqeheshin gjithnjë e më shumë. Një ditë, teksa këndonte një këngë të Aleksandër Gjokës, u afrua Agim Skara, që kishte nuhatur talentin muzikor të Lirimit. I tha se mund të vinte e të këndonte me estradën e Peshkopisë.

Ishte dalja e parë në një skenë akoma më profesioniste. Lirimi kujton se ka kënduar një potpuri të Afrim Muçiqit, shumë e njohur në atë kohë. Përgjegjshmëri e madhe para publikut, por që u prit mjaft mirë, mjaft ngrohtë, falë atyre duartrokitjeve, që nuk



kishin të sosur. Pastaj vazhdon pjesëmarrja e Lirimit në çdo premierë të Estradës, si dhe në festivale popullore, brenda dhe jashtë vendit, Maqedoni, Kosovë e më tej akoma.

Moment i rëndësishëm në karrierën e tij artistike ka qenë pjesëmarrja në Festivalin e këngës qytetare në Pallatin e Kongreseve. Këndoi bashkë me kolegun e tij të njohur, Dritan Jashari, këngën "Bana brof e rashë në mal", popullore e përpunuar nga kompozitori i talentuar dibran, Përparim Tomçini. Suksesi dhe mbresat e këngës ishin vërtet në lartësitë e pritshme. Pjesëmarrja në festivalin e këngës në Elbasan, ishte një tjetër kënaqësi e frymëzim për Lirimin, për të vazhduar më tej akoma.

Edhe pse tashmë ishte lidhur ngushtë me muzikën, një brengë e vogël sillej e pështillej në qenien e tij. Vërtet kishte mbaruar shkollimin e lartë, por jo për muzikë. Ishte i sigurt, se krahas dinjitetit, ajo do ti jepte akoma më shumë njohuri, që do ti shërbenin punës dhe jetës artistike në të ardhmen. Në vitin 2009, pas një përgatitje profesionale me profesor Burhan Spahiun, konkuron dhe fiton të drejtën e studimeve për kanto në Akademinë e Arteve në Tiranë.

Duke qenë akoma student i kantos, aktivizohet me Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve, me shfaqje, koncerte e programe, brenda dhe jashtë vendit. Përveç Maqedonisë e Kosovës, skenat e Italisë, Gjermanisë, Suedisë dhe shumë shteteve të tjera u bënë normale e familjare për Lirim Hoxhën dhe shumë miq të tij artistë.

Realizimet e tij artistike janë të shumta, por ne po përmendim vetëm disa prej tyre: "Dibra e vogël, Dibra e madhe", plot dhjetë këngë dibrane, krijuar e përpunuar prej mjeshtrit Tomçini, "Ta kërcejmë vallen dibrane", "Moj dibrane, lulja e blinit", "Inshallah, ti bohesh mbret", "Beqarnisë ia grise kmishën", "S'ka jetë pa dashni", "Zemra ime fal veç dashuri" e shumë të tjera si këto.

Vetëm pak ditë më parë, Amari, djali i Lirimit, pati ditëlindjen. Lirimi u mendua gjatë se cila do të ishte dhurata më e bukur dhe më e denjë në këtë përvjetor. Diçka që nuk prishej, nuk digjej, nuk konsumohej. Një tortë do të konsumohej shpejt e do humbiste bukurinë e momentit, një tufë lule do të vyshkej në vetëm pak ditë. Një tufë të hollash do të shpenzoheshin në fare pak kohë. U mendua dhe ca më tepër dhe një ide i shkrepi në mendje. Do t'i bënte një dedikim krejt të veçantë, një baladë, që do t'i kushtohej djalit dhe do të titullohej, "Më e shtrenjta pasuri!".

Të shumta janë idetë dhe projektet e artistit të talentuar Lirim Hoxha, të këtij vullkani gjithmonë aktiv e shpërthyes, por ne po e përmbyllim duke i uruar suksese në karrierën e tij artistike, jetë të gjatë djalit Amar dhe përherë lumturi në familjen e tij.

Zhvillohet edicioni i 27 i Odës Dibrane, grupi folklorik "Përparim Tomçini" fiton vendin e parë



Festivali "Oda dibrane" zhvilloi edicionin e saj të 27-të në qytetet e Dibrës së Madhe Peshkopisë më datat 7-9 tetor 2021.

Në këtë manifestim të madh kulturor morën pjesë 14 grupe, shoqëri artistike dhe ansamble folklorike popullore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Nga Shqipëria morën pjesë Ansambli "Folklori nder breza", Belsh; Shoqata Kulturore "SKAMPA" e Këshillit të Qarkut Elbasan; grupi folklorik "Gjergj Arianiti", Mallakastër; Ansambli "Krahu i shqiponjës" - Taip Madani, Vlorë; Ansambli "Visaret e Krrabës", Tiranë; Qendra Kulturore Bulqizë dhe Qendra Kulturore Peshkopi.

Nga Maqedonia e Veriut morën pjesë tre shoqëri kulturore: "Jeta e RE", Sllupçan - Kumanovë; "Jahi Hasani" - Gostivar dje "DUFLA"- Race, Shkup.

Nga Kosova morën pjesën Ansambli "Lidhja e Prizrenit"-Prizren, "Prishtina"-Prishtinë; "Hasan Prishtina"-Vushtri dhe "Shote Galica" - Drenas.

Gjatë ditëve të festivalit u zhvilluan edhe parada e kostumeve, në Dibër të Madhe më 7 tetor dhe në Peshkopi me 8 dhe 9 tetor 2021.

Në këtë festival morën pjesë afro 350 artistë, këngëtarë, instrumentistë dhe valltarë.

Edicioni i këtij viti u zhvillua njëkohësisht me "Festë e të Vjelave", një panair tradicional me prodhimet bujqësore e të pemtarisë së Dibrës.

Interesimi i publikut ishte shumë i madh, megjithëse shfaqjet shkonin mbi dy orë, sallat kanë qenë gjithmonë plot, duke u përjetuar si një festë e madhe në qytet.

Në këtë festival u nderua edhe puna dhe krijimtaria e kompozitorit Përparim Tomçini, i cili ka qenë një nga ideatorët dhe organizatorët e parë të këtij festival. Ansambli Dibra, pjesëmarrës në këtë festival, mori emrin e kompozitorit të dashur për publikun dibran e më gjerë, "Përparim Tomçini".

Juria e përbëre nga Isak Shehu - Mjeshtër i madh, dekan i Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve, z.Kastriot Tusha - Mjeshtër i madh, Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut, pedagog në Universitetin e Arteve dhe z. Jeton Pustina, pedagog në Universitetin e Muzikës në Tetove dhë përgjegjës për kulturën në Komunën e Tetovës dhanë çmimet për këtë edicion.

Vëndin e parë e mori grupi folklorik "Përparim Tomçini". Në vendin e dytë u renditën Shoqëria Kulturore-Artistike "Jahi Hasani" -Çegran, Gostivar dhe Ansambli "Folklori nder breza"- Belsh, Elbasan.

Më çmimet e treta u nderuan ansambli "Lidhja e Prizrenit" - Kosovë, "Krahu i shqiponjës" i grupit Çamëria-Vlorë dhe grupi folklorik "Gjergj Arianiti" - Mallakastër.

Vëndin e parë e mori grupi folklorik "Përparim Tomçini", Peshkopi.

Në vendin e dytë u renditën Shoqëria Kulturore-Artistike "Jahi Hasani" -Çegran, Gostivar dhe Ansambli "Folklori nder breza"- Belsh, Elbasan.

Më çmimet e treta u nderuan ansambli "Lidhja e Prizrenit" - Kosovë, "Krahu i shqiponjës" i grupit Çamëria-Vlorë dhe grupi folklorik "Gjergj Arianiti" - Mallakastër.

***

Oda Dibrane e ka zhvilluar edicionin e parë të saj në vitin 1994. Ishte një iniciativë e përbashkët e artistëve dibranë dhe e Shoqatave Kulturore artistike të shqiptarëve të Maqedonisë që kishin nevoje për më shumë hapësira për jetën e tyre artistike. Ky festival, që nga ajo kohë, vazhdon pa ndërprerje.

Oda Dibrane në gjuhen popullore simbolizon dhomën e pritjes së mikut. Ajo është simbol i vatrës së besës e bujarisë, qëndresës e trimërisë së shqiptarëve, ku bëheshin dasma e kuvende, ku shpalosej urtësia e mençuria e këtij populli.

Oda ka shërbyer ndërkohe dhe si vendi ku thureshin e merrnin udhë këngët e bukura epike e lirike, ku pritej e përcillej miku i shtëpisë, ku përdorej fjala e urte e dialogu alegorik.

Festivali është një takim specifik, origjinal në llojin e vet, jo vetëm në Shqipëri, por dhe me gjerë. Është takim i këngës e valles humoristike, riteve e lojërave popullore. Qëllimi është ti rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës tonë, t'i sjellë në kohë e ti bëjë të të asimilueshme për publikun e kohës.

Specialistët më të mirë në këtë fushë e kanë quajtur këtë festival një zbulim dhe kontribut të çmuar në traditën e kulturën shqiptare, si festivali me i rëndësishëm në Shqipëri në fushën e traditës, pas atij të Gjirokastrës.

Në shkallë kombëtare, "Oda dibrane" pasuron me origjinalitet larminë e evenimenteve artistike që zhvillohen në vendin tonë. Bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë e studiues nga të gjitha trevat shqiptare për të promovuar një mozaik të pasur të trashëgimisë kulturore, artistike, folklorike. Pasuron jetën kulturore artistike të qytetit të Peshkopisë, duke edukuar në brezat e rinj thellësinë e mendimit të "shkollës së Dibrës" mikpritjen, bujarinë, artin fin të fjalës, të këngës e valles dibrane.

Në këto 27 vite jetë kanë marre pjesë rreth 130 grupe e shoqata artistike dhe kanë interpretuar rreth 9000 artistë.

Të gjithë emrat e shquar të artistëve popullorë të trevave shqiptare kanë marrë pjesë në këtë festival. Që nga i mirënjohuri, artisti dibran Hazis Ndreu e me radhe Ndue Shyti, Frok Haxhia, Bujar Qamili, Ilir Shaqiri, grupi çam, Arif Vladi, Liri Rasha, Vera Laçi; grupet polifonike shoqëritë artistike e kulturore nga Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Fieri; Korça, Kukësi, Puka, Lushnja, Elbasani, Shkodra, Kolonja, Prishtina, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Kumanova,Tetova dhe e gjithe Maqedonia, Ulqini, Presheva, Medvegja e Bujanovci etj. Nuk ka trevë nga Shqipëria apo trojet shqiptare përtej kufirit që nuk ka marrë pjesë të paktën një herë në "Odën Dibrane". Ajo ka qenë porta e parë hyrëse e shqiptarëve nga matanë kufijve për në Shqipëri.





cyan magenta yelloë black

GJATË MUAJIT NËNTOR

LIBRA TË ZGJEDHUR 20% ZBRITJE



800 lekë



1000 lekë



1000 lekë





1000 lekë



800 lekë



700 lekë



500 lekë



600 lekë



700 lekë



700 lekë



700 lekë



1000 lekë



1000 lekë



1000 lekë



1500 lekë



1000 lekë



700 lekë



800 lekë



1000 lekë



500 lekë

Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia; librari *"Art's"* të Stacioni i Trenit në Tiranë; *FletaXXI* në Peshkopi ose porositeni te libraria e lagjes suaj.
Për çdo porosi në Tiranë ose në rrethe, kontaktoni në email:
mbbotime@gmail.com, Cel. 0686508441 (Whatsapp), 0692068603 (Viber). Posta brenda vendit është FALAS.

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 182

veprimtari



Peshkopi, përkujtohet 100 vjetori i betejës së Lanë-Lurës

Beteja e LANË-LURËS, ose e quajtur ndryshe beteja e Qafë-Gëlqeres është një nga ngjarjet më të rëndësishme historike e të lavdishme për popullin dibran.

Në kuadër të 100-vjetorit të kësaj beteje (26-28.10.1921), e cila i dha fund luftës së ashpër 9-vjeçare të dibranëve me pushtuesit serbë, nën kujdesin e veçantë të Bashkisë Dibër, në hyrje të fushës së Lanë-Lurës, u përurua më datë 27 tetor 2021 një pllakë përkujtimore në nderim të kësaj beteje heroike.

"Këtu, më 26-28 tetor 1921, u zhvillua beteja heroike midis vullnetarëve dibranë të lirisë dhe ushtrisë pushtuese të Jugosllavisë së parë, e njohur në histori si Beteja e Lanë-Lurës ose e Qafë-Gelqeres, që çoi në përmbylljen me fitore të një lufte të ashpër 9-vjeçare. Lavdi qëndresës së Dibrës!" - shkruhej në pllakën përkujtimore.

Kjo pllakë përkujtimore iu dhurua bashkisë së Dibrës nga shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" dhe për të kontribuan Mustafa Tola, Hajredin Toca dhe Nazmi Bushi.

Mes shumë lurasve të mbledhur anë e mbanë, historianë e personalitete, morën pjesë në këtë ceremoni përkujtimore Kryetari i Bashkisë Dibër z. Shkëlqim Murrja, i shoqëruar nga artisti dhe njëkohësisht Drejtori i Qendrës Kulturore "Haki Stërmilli" z.Arif Vladi, Prefekti i Qarkut z.Nexhbedin Shehu, si dhe Kryetarja e Këshillit të Qarkut Znj.Valentina Haliti, Kryetari i Keshillit Bashkiak z. Sokol Sava etj.

Një ditë më pas, më 28 tetor 2021, në Pallatin e Kulturës "Haki Stërmilli" Peshkopi u zhvillua konferenca me temë "100- vjetori i luftës së Dibrës kundër pushtuesve serbë"..

Kjo veprimtari u hap me 'Himnin e Flamurit', si dhe 'Himnin e Djelmnisë Dibrane' kënduar nga dy mjeshtrat e mëdhenj të muzikës shqiptare, Kastriot Tusha dhe Arif Vladi.

Në këtë veprimtari u lexua nga Haki Përnezha kumtesat e akademik Shaban Sinanit "Lufta e Dibrës në kujtimet e Ismail Strazimirit". Më pas, profesor Adem Bunguri mbajti referimin "Barbarizmat serbe në Dibër në vitet 1913-1921", prof.Bajram Xhafa mbajti temën me titull "Pse zgjati 9 vjet Lufta e Dibrës?"; prof.ass.dr. Moisi Kamberi paraqiti referimin me temë "Kuvendi i Arrasit dhe Beteja e Lan Lurës", lexuar nga Miranda Çiku.

Dr. Dritan Murrja referoi temën "Krijimi i Prefekturës së Drinit për shtrirjen e administratës dhe mbajtjen e zgjedhjeve"; Zabit Lleshi referoi temën "Gryka e Vogël në luftën kundër serbëve në vitet 1912-1921".

Shkrimtari Xhafer Martini nuk mundi të ishte në këtë sesion shkencor, por tema e tij e përgatitur me këtë rast "Personaliteti i Elez Isufit", u referua nga Dr. Hysen Uka.

Historiani Haki Përnezha e mbylli ciklin e referimeve me temën "Kontributi i çidhnakëve në vitet 1912-1921".

Kujtesa e kësaj lufte të lavdishme në historinë e Dibrës do të kulmojë më 10 dhjetor në Akademinë e Shkencave, me një sesion shkencor organizuar prej saj.

"Këtu, më 26-28 tetor 1921, u zhvillua beteja heroike midis vullnetarëve dibranë të lirisë dhe ushtrisë pushtuese të Jugosllavisë së parë, e njohur në histori si Beteja e Lanë-Lurës ose e Qafë-Gelqeres, që çoi në përmbylljen me fitore të një lufte të ashpër 9-vjeçare. Lavdi qëndresës së Dibrës!" - shkruhet në pllakën përkujtimore.

Më 28 tetor 2021, në Pallatin e Kulturës "Haki Stërmilli" Peshkopi u zhvillua konferenca me temë "100- vjetori i luftës së Dibrës kundër pushtuesve serbë". Kujtesa e kësaj lufte të lavdishme në historinë e Dibrës do të kulmojë më 10 dhjetor 2021 në Akademinë e Shkencave, me një sesion shkencor organizuar prej saj.

100 vjetori i betejës së Lanë-Lurës *dhe i tërheqjes përfundimtare të serbëve nga territoret shqiptare*

Nga SAKIP CAMI

Ushtria serbe me 8 Dhjetor 1921 u tërhoq në kufirin e përcaktuar prej konferencës së ambasadorëve, në Londër dhe i liruen tokat shqiptare të Dibrës. Me 10 dhjetor 1921 fuqit tona kombëtare hynë në Diber, Peshkopi e në Lume si ngadhnjimtarë tue pasë në ballë komandantin e pergjithshëm Elez Isufi dhe Kapiten Ali Rizain, dy burra të çmueshem që meritojne çdo nderim për trimëni, burrërine e atdhedashuni e tregueme kurdoherë e veçanarisht gjatë kohës kritike që vazhdoi lufta.

SITUATA POLITIKO – USHTARAKE E VITIT 1921

Pas mbarimit me sukses të luftës së Dibrës të gushtit 1920, me 17 dhjetor 1920 Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve sipas kufijve të vitit 1913.

Jugosllavia duke shfrytëzuar njëklauzolëtë vendimit të Lidhjes së Kombeve për ratifikimin e kufijve nga kjo datë e në vazhdim, nuk i largoi fuqitë e veta ushtarake nga Shqipëria. Ajo kishte për qëllim që të depërtonte në kufirin e Tre Qafave, "Qafën e Buallit", "Qafën e Murrës" dhe "Qafën e Merkurthit", si hap të parë që më pas të depërtonte drejt Durrësit, ëndrrës së vjetër për dalje në Detin Adriatik.

Nisur nga këto veprime të qeverisë jugosllave, qeveria shqiptare ju drejtua Lidhjes së Kombeve me një kërkesë për një komision ndërkombëtar, pasi Jugosllavia po vazhdonte agresionin e saj drejt vendit tonë. Jugosllavia për të mos rënë në sy të Lidhjes së Kombeve e paraqiti atë si çështje të bejlerëve shqiptarë që luftojnë për pushtet duke ju referuar kështu bajraktarit të Mirditës Markagjoni që më 17 korrik 1921 kishte shpallur në Prizren Republikën Autonome të Mirditës. Qeveria e Tiranës nuk mund ta lejonte këtë akt irredentist dhe nisi drejt Mirditës trupat e saj qeveritare.

Ismail Strazimiri[1], bashkëkohës dhe bashkëluftëtar në këtë luftë në kujtimet e tij shkruan:" Me nji urdhër tëkryeministrit Iljas Bej Vrioni, të ministrit të brendshem Sulejman Delvina dhe të ministrit të luftës Selaudin Shkoza, Elez Isufi u nis për me u marrë vesh me Marka Gjonin.Elezi shkoi në Lurë dhe dërgoi Ibrahim Gjocin ke Marka Gjoni për ta caktue vendin e kohën e takimit. Kur u kthye Ibrahim Gjoci e njoftoi Elez Isufin se Marka Gjoni kishte dredhue dhe nuk dëshironte me hy në marrveshje me qeverinë.

Serbia u përpoq që të dërgonte në Mirditë për të ndihmuar bajraktarin Markagjoni trupa shqiptare që komandoheshin nga Taf Kaziu, Halit Lleshi, trupa të cilat nuk arritën në Mirditë dhe nuk e ndihmuan dot bajraktarin e Mirditës. Për këtë Serbia dërgoi për në Mirditë trupat e saj për të ndihmuar .

Profesor Kristo Frashëri[2] te Historia e Dibrës, faqe 363 shkruan se Jugosllavia e nxiti politikisht dhe e ndihmoi financiarisht kapedanin konservator të Mirditës Marka Gjonin që të organizonte një kryengritje të armatosur kundër shtetit shqiptar, rebelim që filloi në fund të qershorit të vitit 1921. Meqenëse kapidani nuk pati mbështetje në masë as edhe nga mirditorët e tij u detyrua të arratisej në Jugosllavi. Kthehet përsëri për të marrë fronin, por hasi në rezistencën e malsorëve dhe luftëtarëve të Reçit, Dardhës, Çidhnës dhe Lurës që drejtoheshin nga Elez Isufi.

Në qershor të vitit 1921, për të përballuar në mënyrë sa më të shpejtë dhe efektive problemet e shkaktuara në Mirditë u formuan edhe 3 batalione të lëvizëshme që vareshin direkt nga Ministria e Luftës dhe komandanti i operacionit Ali Rizai. (AQSH Fondi i kryeministrisë D II-15/1, viti 1920, f.81.)[3]

Me ardhjen në fuqi të qeverisë së "Grupit të shenjtë" qeverisë që kryesohej nga Iljas Bej Vrioni u vendos që të mos lëshohet asnjë pëllëmbë territor dhe të kundërpërgjigjej me luftë të armatosur.

BETEJA E QAFË GËLQERES NË LAN LURË

Pala serbe njoftoi komandën shqiptare në Arras se në rast se nuk lirohej Arrasi e gjithë katundet për rreth tij brënda 24 oreve, do t'i bombardonte dhe do t'i sulmonte për t'i pushtuar.

Kur panë autoritetet serbe se shqiptarët nuk e morën në konsideratë notën e tyre verbale dhe nuk i liruan teritoret, me 18 shtator 1921 filluan me bombarduar me topa e me msye me ushtri të rregullt. Gjëmimi i topave serbe dëgjohesh deri në thellësitë e Lurës. Me nji here u çue Elez Isufi dhe me nji fuqi që mbodh aty për aty u nis me shkue në ndihmë të Arrasit. Pa humbur kohë e thirri të nipin Suf Xhelilin e kapiten Rizain që të vinin në ndihmë me forcat që dispononin. Ndër kohë, lëshoi kushtrimin edhe në Dardhë e në Reç.

Kur arrit i populli i Dardhës dhe i Reçit, simbas kushtrimit të marrë dhe batalioni i kapiten Ali Rizait e fuqija e Suf Xhelilit, u nis lufta e egër në mes të shqiptarëve e të serbëve qëkishin sjell njiqind topa të vegjel e të mëdhej të cilët i përdoren në këtë levizje.

Raportet zyrtare të dhëna prej komandantëve të kufirit vërtetojnë se vetëm në ballin e Lurës janë përdor tridhjetë topa. Për ballë frontit të Dibrës serbët kishin përdorur regjimentet 12,17,18,19,25,27, dhe 28, përveç forcave serbe të ardhun nga Prizreni për tu përdor kundra ballit të Lurës .

Ismail Strazimiri, dëshmitar okular dhe pjesëmarrës nëkëtë betejë në librin e tij me kujtime e përshkruan me detaje atë:

Përballë kësaj mizorije serbe të armatosun gjer në dhembë qëndroi fuqia e dibranëve me rreth njëqind e sa vetë nga Arrasi, Sina e Epër, Sina e Poshme, Grykë Noka, Çidhna, Mustafe si dhe me nja njëqind e sa vetë nga Dardha, Reçi e Lura. E tërë fuqija e dibranëve përbëhej nga 200 – 300 forca dhe nga nji top dhe disa mitroloze që ua morën me luftë serbve.Me gjithë forcat e qeverisë të komanduara nga Ali Rizai bëheshin 400 burra të armatosur.

Luftëtarët herë herë shkëputeshin për të parë fëmijët e tyre që i kishin strehuar ndër shpella, pyje e bjeshkët e nalta dhe që po vuanin nga uria dhe të ftohtit.

Përmbi katundin Sine e Epër e Sine e Poshtme të Dibres ngrihen male të larta, ku kishte organizuar pritë Murat Kaloshi me nji fuqi dibranësh, çidhnakësh e të tjerë duke bërë një qëndresë heroike.

"Nga ana e Lurës, pa rreshtun, serbët mësynin vazhdimisht, por hasën në rezistencë e luftëtarëve dibranë që luftonin në pozicionet e tyre dhe në vendin e tyre që e njihnin pëllëmbë për pëllëmbë. Suf Xhelili me vetëm njëzet e shtatë trima e zbrapsi sulmin e nji fuqie serbe që përbëhej prej katërqind ushtarësh duke e kaluar matanë Drinit dhe duke i marrë edhe armatimin, një top dhe disa mitroloza. Zotësia e trimërija e komandant Ali Rizait ishte e jashtëzakonshme. Malësorët dibranë e admironin atë për drejtësinë dhe guximin.

Me 26 tetor 1921 serbet arritën të kapën dy pika strategjike, Shkallën e Deshve dhe Sharrën e Zogollit dhe e prenë rrugën prej nga i shkonte ushqimi e municioni forcave tona në Lurë. Në këtë mënyrë pozita e Lurës gati mbet e rrethueme dhe e rrezikshme, mbasi nuk i shkonte më as ushqim as edhe municion.

Shënime në një ditë të mbushur si asnjëherë me histori Dibre, në një bisedë me Dr. Prof. Adem Bungurin dhe nismëtarë të një ngjarje që u ndez për të mos u shuar kurrë

Jam atje, *me mend e me shpirt, por* **pa penë** *e fotoaparat* **në dorë...**

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**, gazetar

Nuk i kam bërë ndonjë portret pune Adem Bungurit, as e kam marrë në ndonjë intervistë sa kohë punoja gazetar profesionist; në ATSH, shtypin qendror e atë vendor. Më ngelet merak ashtu siç edhe për shumë figura që në këtë kohë, janë nga mëngjesi në mëngjes në Dibër, flenë me Të, zgjohen me Të, përgjërohen për Të...

Na lidhi nyje mbrojtja e Dibrës nga synimi i pushtetarëve të djathtë e të majtë për ta mbytur e për të mbushur xhepat nga ajo që tashmë nuk është një toponim fshati por toponim që e njeh edhe Amerika, Kina, bota...nga SKAVICA...

Ai prej Greve, larg nga bregu i Hurdhës, në ballkon të pamjes.

As toka, as varre, as kujtime...i mbyten.

Megjithatë ai i thotë JO SKAVICËS!, me kompetencat e një shkencëtari, një arkeologu të elitës shqiptare që nuk donë që vlerat historike të saj të mbyten e kjo trevë të mos i flasë historisë shqiptare thellësisë së shekujve.

Dhe i ka radhitur të gjitha vlerat arkeologjike që mbyten, vlera që deri më sot nuk kanë parë kazmën e arkeologut, nuk kanë parë ekspedita kërkimore, kanë mbetur larg vëmendjes shtetërore dhe shkencore...

Unë jam prej Zdojani. Hurdha e Skavicës më vjen nja pesëdhjetë pashë poshtë trojeve të babait tim. Po të kisha jetë do të ngreja një shtëpi në krye të kodrës, ballkon natyror i pamjes me Drinin gjarpërues brigjeve të Mollës së Luznisë e Muhurrit, tokave të begata të Çapit të Brezhdanit. Hurdha e Skavicës nuk më mbyt as troje, as tokë, as varre të të parëve të mi. Mbyt luginën e Drinit të Zi, luginën më pjellore të maleve të vendit, luginën ku u derdh gjak i kuq dibran në betejat e mëdha kundër pashallarëve më të mëdhenj otomanë, betejat kundër serbit i etur për ta sllavizuar Dibrën e më tej për ta prerë e tërheqë pas vetes për "kullani".

Nuk e dua Dibrën të mbytur për asnjë lloj arsyeje, ASNJË LLOJ... Edhe pse e di se zjarri, uji dhe shteti, të djegin, të mbysin pa exhel...

Këtu jemi bashkuar tashmë prej disa vitesh me Adem Bungurin, profesor e doktor i shkencave. Dhe nuk tërhiqemi. Këtë e bëjmë publike edhe përballë, "patronazhistëve", siç i quan Ademi, soj i ri piavicash që po mbushin xhepat e forcojnë këmbët e karrigeve ku janë ulur...





I DASHUR DURO,

Të falënderoj shumë për emalin dhe mesazhet.

Unë do të kisha dashur të jesh i pranishëm në këtë aktivitet të rëndësishëm dhe të thoni fjalën tuaj si publicist i shquar në këtë 100 vjetor të rëndësishëm të luftës kundër pushtimit serb në Peshkopi (25-26 tetor) dhe Tiranë (6-8 dhjetor).

Unë besoj se prania juaj në Konferencën e Peshkopisë,do ti bënte nder kësaj konference, pjesëmarrësve dibranë dhe historisë së Dibrës.

Meqë unë jam në komisionin organizues, besoj se në pikëpamje organizative, kjo gjë mund të realizohet, të paktën për në Peshkopi dhe Lan Lurë.

Prandaj mund të më shkruani për sasinë e nevojshme të kostos së shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit tuaj për Peshkopi, që unë të di sasinë që duhet të planifikojmë për këtë gjë.

Unë tani po nisem për në Peshkopi, për të ndjekur përgatitjen e konferencës etj. Duke shpresuar të shihemi së shpejti, ju përshëndes dhe ju uroj çdo të mirë,

Miqësisht, Ademi

Tiranë, 9 tetor 2021

SHUMË FALEMINDERIT ADEM BUNGURI!

Ekisha shumë dëshirë të vija, por, me gjithë dashamirësinë tënde që të më "dërgosh kalë" për të ardhur, nga dita e djeshme e kam të vështirë të lëviz nga njëra dhomë në tjetrën e jo më të dal jashtë. Një aksident i vogël në kavilen e këmbës më detyroi që ta ve atë në allçi.

Më llogarit sikur jam atje.

Në fund të fundit ajo që kam kërkuar para 29 vjetësh dhe para një viti, megjithëse me nxitim, u bë realitet.

Po tu dha rasti në fjalën tënde përcillu të pranishmëve respektin tim të lartë.

Unë shkrova. Jam i gëzuar që njerëzit lexuan diçka nga brenga ime historike për Dibrën.

Më informo për zhvillimin e veprimtarive.

Gjitha të mirat!

Shpresoj të takohemi vitin e ardhshëm në Golem!

Me respekt

Abdurahim Ashiku

Athinë, 9 tetor 2021

Na bashkoi këto dy vjet, një elitë nga historia shqiptare, historia e asaj që quhet "Beteja e Lanë-Lurës", betejë që deri në vitin 1990 kishte ngelë në kujtesë me një lapidar të vogël në një shkëmb në krye të fushës së Lanë-Lurës e që dikush, dikujt që në këtë kapërcyell "demokracie", i interesoi që ta shkulë, ta copëtojë, mos i lejë as nam dhe as nishan. Unë atëherë shkrova diçka, bëra protestën time qytetare shqiptare, protestën tim si dibran.

Për 29 vjet për të nuk u kujtua kush, nuk u shkrua as edhe një rresht në përvjetorë të zakonshëm e "rrumbullak".

E zgjova 28 vjet më vonë. Xheloz për 100 vjetorin e Luftës së Vlorës, festuar me madhështi në 100 vjetorin e hedhjes së italianit në det, hedhje me "pushkën" mbarë shqiptare. Kërkova thjesht që 100 vjetori i betejës së Lanës së Lurës të festohej me të njëjtin seriozitet shkencor e veprimtari publike zyrtare sa dhe si i Vlorës...

Mu bashkua Adem Bunguri nëpërmjet komunikimeve në email e në një takim të ngushtë në Golem në gusht 2021, një mbështetje që më ngrohu e mbushi shishen që boja të mos i mungonte penës sime.

Mu bashkua edhe Dr. Mustafa Tota. Erdhi në korrik 2021 në Golem dhe biseduam gjatë. Kishte bërë hapa të mëdhenj që beteja e Lanë Lurës dhe vendimi i Këshillit të Kombeve për vendosjen përfundimtare të kufijve të Shqipërisë të ngjitej në një veprimtari të gjerë shkencore në Akademinë e Shkencave, në veprimtari zyrtare shtetërore në Peshkopi e në Lanë Lurë.

Nga informacionet që kam marrë jam i gëzuar, gëzim që ndër të tjera ma sjell Prof. Dr. Adem Bunguri çdo ditë.

Kam marrë prej tij sot një ftesë, një mundësi që të jem pjesë e tubimeve shkencore e historike, të kem një vend në sallë, të jem në një rreshtim në Lanë-Lurë...

Do të desha të jem atje, në salla, rrugëve të vendlindjes, maleve të Dibrës.

Do të desha sepse për mua do të ishte reportazhi i jetës sime. Nuk më vjen më.

Me dhimbje nuk mund ti përgjigjem pozitivisht ftesës.

Arsyen e keni në letërkëmbimin sot me legjendën e mbrojtjes së Dibrës në ditët tona, Prof. Dr. Adem Bungurit...

Jam atje, me mend e me shpirt, por pa penë e fotoaparat në dorë...

Athinë, 9 tetor 2021

100 vjetori i betejës së Lanë-Lurës *dhe i tërheqjes përfundimtare të serbëve nga territoret shqiptare*

Historiani Fatos Daci e përshkruan me detaje dhe me emra këtë betejë me heroizëm të të pashoq. "Beteja e fundit me ushtrinë pushtuese serbe u zhvillua në Lanë-Lurë, në vendin e quajtur Qafa e Gëlqeres. Qeveria serbe, në tentativë që të zinte vijën strategjike Qafë-Buall, Lanë-Lurë e Qafë-Murrë dërgoi në këtë rajon 5400 ushtarë, që rreshtoheshin në 12 regjimente me 31 topa. Ndërkohë, më parë në Reç-Dardhë ishin pozicionuar edhe 2000 mercenarë të Tafë Kaziut e të Halit Lleshit për synimin për t'i shkuar në ndihmë të ashtuquajturës Republikë të Mirditës të Gjon Marka Gjonit.

Përballë tyre ishin rreth 400 vetë të forcave qeveritare të komanduar nga Ali Rizai dhe rreth 700 forca vullnetare të Reçit, Dardhës e Lurës. Prandaj, më 26 tetor 1921 serbët nisën përpunimin me artileri të zonës ku do të zhvilloheshin luftime me forcat qeveritare e vullnetare dibrane. Kjo situatë vazhdoi dhe më 27 tetor, ndërsa më 28 tetor shpërtheu lufta frontale mes dy palëve. Beteja u zhvillua shumë e ashpër. Lurasit e reç-dardhasit luftuan me heroizëm e trimëri të pashoqe. Lufta u bë dhe trup me trup. forcat dibrane dhe ato qeveritare e ndalën përparimin e ushtrisë serbe te Qafa e Gëlqeres.

Lurasit në këtë luftë komandoheshin nga Selman Mena, Ibrahim Gjoçi, Gjon Doçi dhe Hakik Mena. Vetëm nga Lura, në këtë betejë morën pjesë 34 veta, si: Gjon B. Doçi (i cili dhe u plagos), Kolë Mark Rajta, Ibrahim Gjoçi, Ahmet Gjoçi, Hasem Haldeda, Ali Vladi, Xhemë Vladi, Dullë Vladi, Osman Vladi, Liman Buci, Mehmet Ajazi, Islam Peka, Han Hoti, Demë Leka, Sulë Buci, Dan Kaçorri, Kolë Rajta, Liman Haldeda, Xhemë Haldeda, Riza Vladi, Musë Vladi, Xhafer Haldeda, Selman Haldeda, Bajram Haldeda, Ramadan Markola, Dan Haldeda, Rexhep Haldeda, Sulë Mena, Demë Mena, Bajram Vladi.

Luftuan si luanë të vërtetë gjithë ushtarët e civilat, shkruan Ismail Strazimiri dëshmitar okular, ndërsa evidenton oficerët që morën pjesë në këtë luftë: Kapiten Ali Rizai, Kapiten Suf Xhelili, Kapiten Murat Kaloshi, Kapiten Ibrahim Gjoçi, Kapiten Haziz Pilafi, Toger Mehmet Skepi, Toger Misim Ahmeti, Toger Qazim Aziz Ndreu, Toger Dervish Lusha, Toger Haxhi Noka, Toger Xhezmi Frashëri, Toger Xhevdet Starova, N/Toger Abdulla Tirana, N/Toger Munir Tershana, N/Toger Rrok Qafa, N/Toger Hakik Mema, N/Toger Demir Curri, Aspirant Gani Dida, Asp.Sali Doda,Asp.Dali Lami, Asp.Selman Ahmeti, Asp.Hasan Faliu, Asp.Bajram Lusha, Asp.Hysni Kaca, Asp.Xhetan Gjoni, Asp. Sadik Kerçova, Asp. Sul Cani etj… Më 9 nëntor 1921 Konferenca e Ambasadorëve e quajti Jugosllavinë agresore dhe hodhi poshtë pretendimet e saj për "vijën strategjike". Megjithatë ajo vazhdoi provokacionet për të shkaktuar trazira, provokime që dështuan me turp.

Ushtria serbe me 8 Dhjetor 1921 u tërhoq në kufirin e përcaktuar prej konferencës së ambasadorëve, në Londër dhe i liruen tokat shqiptare të Dibrës. Me 10 dhjetor 1921 fuqit tona kombëtare hynë në Diber, Peshkopi e në Lume si ngadhnjimtarë tue pasë në ballë komandantin e pergjithshëm Elez Isufi dhe Kapiten Ali Rizain, dy burra të çmueshem që meritojne çdo nderim për trimëni, burrërine e atdhedashuni e tregueme kurdoherë e veçanarisht gjatë kohës kritike që vazhdoi lufta.

Poeti popullor e përjetësoi në këngë këtë betejë të madhe:

"Qafë Gëlqerja gropa gropa, / Fort po e rref serbi me topa / Qafë Gëlqerja krisa krisa / Qëndrojnë trimat në kamb' si lisa / Sup më sup Dardhë e Reç / Asht ngrit' Lurame fëmijë e pleq / Gryka e Nokës ka lidhë besë / Ti biem qenit përmidis kresë"[5]

HYMNI I DJELMËNISË DIBRANE

Në Lurë dhe në këtë kohë u këndua për herë të parë "Hymni i djelmënisë dibrane"[6] të shkruar nga Haki Sharofi dhe të muzikuar nga Sami Gonxhe

Drin, o lum i gjanë, Plaku i malësisë / A ke me ia lanë Dibrën Serbisë? / Kurrë nuk durohet kjo robëni / Dibra e Mojsiut asht Shqipëni.

1. Ismail Strazimiri, kujtime
2. Kristo Frashëri, Historia e Dibrës, faqe 363
3. AQSH Fondi i kryeministrisë D II-15/1, viti 1920, f.81.
4. Fatos Daci, Beteja e Lan Lurës
5. Xhelal Luca, libër poetik
6. Haki Sharofi, Sami Gonxhe, Hymni i djelmënisë dibrane

Studjuesi Besnik S.Kebej sjell fakte arkivore dhe burimore për origjinën dibrane të Skënderbeut

Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë

***Nga* HALIL RAMA**

Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të ka lënë si testament: "Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm..." (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr)

Librin "Origjina dibrane e Skënderbeut" (*Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë*) të autorit Besnik Selman Kebej, që është një studim vërtetë shkencor, ndër të tjera e bën të besueshëm një referencë nga historianët e mirënjohur, prof.Stafanaq Pollo e prof.Kristo Frashëri. Në një fletore që ruhet me fanatizëm nga arkitekti i këtij muzeu Besnik S. Kebej, ish drejtor i shkollës 8 - vjeçare Sinë, akademikët e mirënjohur, si dhe disa autoritete vendore të kohës në rrethin e Dibrës, lexojmë shënimin:

"Sinë, 12 shtator 1982.

Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përshëndesim nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm për edukimin e brezit të ri. Urojmë që së shpejti në Sinë të ngrihet muzeu kombëtar kushtuar Familjes së Kastriotëve e bijve e bijave që nxorri kjo derë e shkëlqyer, veçanërisht heroin e pavdekshëm, Skënderbeun".

Kristo Frashëri, Hysen Lala, Stefanaq Pollo, Hazis Ndreu – Firmat (Libri "Origjina dibrane e Skënderbeut", faqe 218- botimet M&B.) .

Në vitin 1974, çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve, u bë objekt i një studimi të veçantë të Profesor Kristo Frashërit, i cili për herë të parë trajton shkencërisht edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e tij me titull *"Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?"*, ai shtroi për diskutim dhe ballafaqim, të gjitha burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mblodhi në terren. Nga analiza e këtyre të dhënave, Profesor Frashëri del në përfundimin se, me emrin Has, kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak i Fermexhinit, nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, pasi kjo krahinë, deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik. Ata, sipas Profesor Frashërit, kanë patur parasysh një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna, e masakruar barbarisht nga Sulltan Mehmeti II më 1466, në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut.

Tridhjetepesë vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës, (18 shtator 2020) një vizitë impresionuese këtu në vendorigjinën e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e Kreut të Shtetit shqiptar Ilir Meta, do të shërbente për ripërtëritjen e traditës së kësaj zone. Një ditë historike kjo, pasi referuar pikërisht veprës madhore të prof.Kristo Frashërit "Historia e Dibrës", që qëndron hijerëndë përkrah bustëve të Gjon, Pal e Gjergj Kastriotit në hyrje të Muzeut, presidenti Meta, ashtu si edhe elita historike e kombit që vizituan këtë muze para tre vitesh, do të "legjitimonte" këtë fshat si vendorigjinë e kastriotëve.

Por ai që i ka paraprirë kësaj ngjarjeje madhore është pikërisht, mësuesi i apasionuar pas historisë Besnik S. Kebej, i cili pas një pune studimore 30 vjeçare na dhuron veprën e tij monumentale "Origjina dibrane e Skënderbeut – Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë", me 255 faqe, plot



referenca, burime arkivore e bibliografike.

Redaktori i librit, dr.Fejzulla Gjabri, ndër të tjera e vlerëson atë për një mënyrë ndryshe të trajtimit të origjinës së Kastriotëve. Kjo sipas tij për faktin se, Besnik S.Kebej, "duke qenë punonjës për disa kohë në Muzeun e Skënderbeut në Sinë, ka fituar përvojën e trajtesave historike, duke përfituar dhe nga debatet e shumta rreth origjinës së Kastriotëve, të parëve të Skënderbeut. Në këtë libër është puna e tij më se 30 vjeçare, duke mbledhur e sistemuar të dhëna për vendin e origjinës së Heroit".

Bazuar në referenca të shumta nga studjues të njohur vendas e të huaj që janë marrë me këtë temë, autori i këtij libri trajton shkencërisht tema të tilla si "Kastriotët dhe Skënderbeu", "Cilët janë dibranët", "Kastriotët, trashëgimia dhe territoret", "Kastriotët, etimologjia, flamuri dhe stema", etj. Ndërsa në kapitullin e 7 "*Disa toponime që formojnë një territor unik*", ai jep të dhëna për disa fshatra sipas defterit turk, për të vijuar më pas në kapitullin e 8-të me "*Pak arkeologji në trojet e Kastriotit*".

PAK HISTORI....

Muzeu i Kastriotëve në Sinë, qe gati që më 28 Nëntor 1979, por për arsye subjektive dhe pengesa të qëllimshme nga ndonjë autoritet vendor i rrethit Dibër, përurimi i tij u bë pas gjashtë vitesh, më 2 Nëntor 1985. Gjithsesi edhe gjatë këtyre viteve vijoi intensivisht puna për pasurimin e tij.

Që në gusht 1978 kur filloi punën drejtor në shkollën 8-vjeçare "Nimete Progonati" në Sinë, B.S.Kebej ra në kontakt më gojëdhëna e emra vendesh për Skënderbeun, njëlloj si në Muhurr. Më pas vijoi për disa kohë me toponiminë dhe intervistat me të moshuarit për Skënderbeun. Ndërkohë, u ishte dhënë detyrë nxnësve që të vazhdonin me gjetje

Bazuar në referenca të shumta nga studjues të njohur vendas e të huaj që janë marrë me këtë temë, autori i këtij libri trajton shkencërisht tema të tilla si "Kastriotët dhe Skënderbeu", "Cilët janë dibranët", "Kastriotët, trashëgimia dhe territoret", "Kastriotët, etimologjia, flamuri dhe stema"...

tudimin e tij të mirëfilltë për origjinën dibrane të Skënderbeut Besnik S.Kebej e mbyll me konkluzionin se "Territori Muhurr-Sinë është ai që plotëson dhe përputhet me dokumente, me pozicionin gjeostrategjik, me toponiminë, me arkeologjinë, se ky është pikërisht territori më minimal që përmend Gj.Muzaka për gjyshin e Skënderbeut".

arkeologjike të rastit,

Deri në vitin 1982 organizuan dy sesione shkencore për Skënderbeun, duke pasuruar materialet dhe shtuar njohuritë për Heroin. Gjithashtu në librin e tij (fq.213) mësojmë se më 29 Maji 1982 kooperativisti Isa Kadriu kishte sjellë në Drejtorinë e Shkollës *një medalion prej bronzi me portretin e Skënderbeut*. Madje, ky objekt medalion vuri në lëvizje deri Autoritete shkencore të Akademisë së Shkencave në Tiranë.

Gjatë vizitës në Sinë në vjeshtën e vitit 1982, akademikëve të mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo dhe prof,Kristo Farshëri u tërhoqën vëmendjen *tre objekte arkeologjike, të gjetura në Sinë të Poshtme: një unazë floriri me portretin e Skënderbeut, që kishte përfunduar në pronësi të Ahmet*



Zogut; një vulë e thatë me trup guri, pjesa me shkronja e së cilës kishte stemë metalike (kjo vulë është gjetur rreth viteve 1967-1968, kur është hapur kanali vaditës që del në anën e përtejme të Drinit), si dhe një pllakë metalike me stemë, e gjetur rreth vitit 1940, e cila, siç tregojnë, kur fërkohej, ndriçonte derisa të vriteshin sytë deri në vërbim. Aso kohe, studjuesi i zellshëm B.S.Kebej u ka folur profesorëve të nderuar Pollo e Frashëri edhe *varrin e Ballaban Pashës në Sinë të Epërme, me "kryqet në gur", për Kllezin e Poshtëm (ku një perrua e ka zanafillën në Këllezin e Epër dhe ky përrua njihet me emërtimin "përroi i qytetit"), për Trojen e Mzeze, ku ka shumë toponime e mikrotoponime me objekt pazaret dhe dyqanet*. Mbështetur mbi këtë toponimi mjaftë të pasur, studjuesi Kebej argumenton vendndodhjen e Gardhit të Poshtëm (Zhgjerdhi) në Muhurr. Ai pohon se këtu ka gjurmë banimi, të cilat janë dëmtuar gjatë viteve të ish-kooperativës bujqësore e më vonë u vendos edhe një repart ushtarak, që e dëmtuan edhe më shumë.

Gjithsesi, studjuesi Kebej nuk i rreshti kërkimet. Pas intervistave me disa pleq mendjehollë nga Muhurri e Sina, u fokusua në *tri legjenda: "Kepi i Skënderbeut sepse ka pasur gjurmë kali"; "Tre gjurmë të kalit të Skënderbeut janë edhe sot në Hurdha të Mshela; "Skënderbeu në Sheh të Thatë ka pas ndërtuar një kala dhe që edhe sot njihet si Kalaja e Skënderbeut"*.

Me këto e shumë të dhëna të tjera burimore e arkivore u pasurua më tej Muzeu i Kastriotëve në Sinë që u përurua zyrtarisht më 2 Nëntor 1985. Ky muze i vogël, me një ndërtesë njëkatëshe, me gur të gdhendur nga mjeshtrit e Sinës dëshmon një fakt të madh historik për atë kohë dhe për brezat që do vijnë se origjina e Kastriotëve është Sina e Dibrës.

Jo më kot, historiani i njohur dibran Haki Përnezha, në rolin e ciceronit, ndër të tjera do t'i bënte të njohur një vit më parë vizitorit më të rëndësishëm të këtij muzeu, Presidentit Meta, atë që ka lënë si testament Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të: "Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm..." (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr).

KONKLUZIONE

Studimin e tij të mirëfilltë për origjinën dibrane të Skënderbeut Besnik S.Kebej e mbyll me konkluzionin se "Territori Muhurr-Sinë është ai që plotëson dhe përputhet me dokumente, me pozicionin gjeostrategjik, me toponiminë, me arkeologjinë, se ky është pikërisht territori më minimal që përmend Gj.Muzaka për gjyshin e Skënderbeut". Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka sjellë dokumenta dhe argumenta se gjyshi i Skënderbeut quhej Kostandin Mazrek Kastrioti dhe se ai ishte nga Mazreka e Epër në Muhurr. Në këto përfundime ai arrin edhe nga fakti se *nëpër Muhurr kalonte Rruga kalorsiake me emrin Rruga Dibrane*, ndërsa *nëpër Sinë kalonte Rruga Plakë*. Po ashtu edhe për faktin se në Muhurr ndodhet Qyteza e shekullit V-VI pas Krishtit, në Sinjë ndodhet Kllezi dhe mes Sinës e Muhurrit Qyteti i Trojes, që ka varre të shumta, ka ujin, ka dyqanet dhe pazaret, ka vendet fetare me emërtimet Popteshja e Madhe dhe Popteshja e Vogël.

Sipas tij, Kastriotët kanë lëvizur për jetë më të mirë nga Mazrekat në Sinë dhe nga Sina dolën në fshatin që formuan vetë në krahun e djathtë të Drinit të Zi, me emrin e tyre, Kastriot.

botim i ri

“Kalabardha - Kështjellë e Arbërisë” - arkiv i gjallë i historisë, kulturës dhe identitetit etnik të popullsisë së Kalabardhës

Më 2 tetor 2021, ora 10.00 -11.00, në sallën UNESCO të Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë, u promovua libri: “Kalabardha - Kështjellë e Arbërisë”, i autorëve Kadri Dauti dhe Arif Shutina. Pavarësisht kufizimeve për takimet për shkak të situatës së pandemisë, mes miqve dhe bashkëpatriotëve të shumtë të krahinës së Kalabardhës pjesëmarrës në këtë promovim ishin mjaftë personalitete e intelektualë të shquar të trevës së Dibrës e më gjerë si: Prof. dr. Nazmi Koçi, Prof. asoc. dr. Adem Bunguri, Prof. asoc. dr. Teki Kurti, z. Ramazan Hoxha, z. Hysni Çela, z. Ismail Oshafi, z. Ruzhdi Mata, z. Hajri Shehu, z. Kujtim Boriçi, z. Eduart Abazi, Mark Marku, Mile Budini, avokat Mehmet Kurti, z. Selman Ferhati, z. Pëllumb Cani, z. Ismail Garipi, z. Ferhat Gruja, z. Ilir Petraj, z. Dritan Halili etj.



* * *

Librin autorët e kanë shkruar me gjithë shpirt për vendlindjen e tyre të dashur. U është dashur plotë 8 vjet punë e përkushtim për të hulumtuar, grumbulluar, sistemuar dhe shkruar atë. Ata kanë shkelur në çdo fshat, në cep të Kalabardhës për të parë me sy e prekur vetë çdo gjë që lidhet me popullsinë, vendbanimet, objektet, ngjarjet historike, origjinën, zakonet e traditat e popullsisë së krahinës së tyre.

Libri ka vlera të shumta historike, etnike dhe kulturore. Është një botim që i shërben të vërtetës historike, evidentimit të identitetit kombëtar shqiptar të Kalabardhasve, dinjitetit të banorëve fisnikë, bujarë, patriotë shqiptarë, besnikë të të parëve të tyre, gjakut të tyre iliro-arbëror. Ai është shkruar me një gjuhë të pastër dhe të qartë, larg çdo ndikimi shpirtëror, romantik apo nacionalist.

Libri titullohet sipas emrit të lashtë shqip i kësaj treve: Kalabardha. Ky është toponimi antik i saj, të vendosur nga vetë popullsia vendase, fiset ilire, emër që ka ekzistuar deri në fillim të shekullit 20-të, siç përmendet nga konsulli rus, I.S. Jastrebov, e shumë autorë të tjerë. Burrat e saj kanë ushtruar historikisht profesionin e ndërtimtarisë dhe në atë kohë ishin të mirënjohur si mjeshtër të ndërtimit të kalave, në trojet shqiptare e në gjithë trevën e Ballkanit. Ndaj, krahina e tyre u quajt Kalabarda (Kalabardha).

E veçanta e këtij libri është dokumentimi i fakteve historike për të vërtetën e identitetit iliro-arbëror, pra shqiptar, të kalabardhasve dhe përpjekjet heroike e patriotike të tyre në mbrojtje të ADN-së së tyre, përballë gënjeshtrave e spekulimeve nacionaliste të autorëve sllavë në funksion të strategjive pushtuese të shteteve të tyre ndaj trojeve shqiptare.

Kalabardhasit “janë etnikë shqiptarë të pastër në doke, zakone, tradita”. Popullsia e Kalabardhës është autoktone, e lashtë në trojet e veta. Ajo ka mbrojtur identitetin kombëtar me gjithë forcën e shpirtit, ndaj nuk është asimiluar nga fiset barbare apo armiqtë e saj. Përmes dokumenteve dhe dëshmive autentike faktohen rrënjët e cdo fisi të gjithë fshatrave të Kalabardhës, si dhe dokumentojnë gjendjen reale të familjeve dhe banorëve të tyre.

Kalabardhasit kanë ruajtur vlerat e të parëve të tyre; kanë ruajtur gjërat më të shtrenjta: etnosin dhe gjuhën shqiptare. Në faqet e këtij botimi kemi hedhur edhe këngë popullore të disa fshatrave që flasin qartë për këtë etnos iliro-arbëror. Kështu, mesazhi themelor që transmeton ky libër është të njohim rrënjët tona dhe të mbrojmë identitetin tonë etnik kombëtar iliro-arbëror përballë falsifikatorëve nacionalistë sllavë.

E veçanta e këtij libri është dokumentimi i fakteve historike për të vërtetën e identitetit iliro-arbëror, pra shqiptar, të kalabardhasve dhe përpjekjet heroike e patriotike të tyre në mbrojtje të ADN-së së tyre, përballë gënjeshtrave e spekulimeve nacionaliste të autorëve sllavë në funksion të strategjive pushtuese të shteteve të tyre ndaj trojeve shqiptare.

* * *

Kalabardhasit janë shquar gjithmonë për dashurinë për jetën, punën, për kulturën. Janë të njohur për karakterin fisnik, burrëror, atdhetar, që e kanë treguar përgjatë ekzistencës në trojet e veta. Kalabardhasit nuk e kanë kursyer asnjëherë gjakun për atdhe. Ata kanë luftuar kundër çdo hasmi për të mbrojtur vatanin e tyre, duke u prirë gjithmonë flamuri i kuq dykrenor.

Kalabardha ka qenë baza e përgatitjes dhe e luftës së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skendërbeu, kundër osmanëve. Kalabardhasit e këndojnë në çdo odë burrash, sikurse gjithë dibranët, këngën e Hajredin Pashës, betejës epope zhvilluar në hapësirën e Kalabardhës, në të cilën ata morën pjesë dhe luftuan heroikisht bashkë me malet e tjera të Dibrës.

Burrëria është tipar i spikatur te kalabardhasit dhe atë e kanë treguar kalabardhasit kudo e kurdoherë. Selman Stafa dhe Osman Gjoka, vranë në Shkodër valiun turk, Haxhi Mela, për të ruajtur nderin e Dibrës. Valiu e shau Selmanin se pa dashje, në një rrugicë të ngushtë, i kishte takuar me sup taganin (shpatën) e tij.

- *“Nuk më shau si person, por më shau Dibrën. Sonte në Shkodër Dibrës vetëm unë i kam qëlluar, nëse do t’i dal zot.”,* – i tha Selmani Osmanit.

Kur valiu e shau përsëri Selmanin,

Hë, mor goge dibre!

zëri i Selmanit ushtoi fort në shëtitore:

- “*E kë shane ashtu, he qafir Anadolli? Nuk jemi, jo goge, por zog dibre*”.

Dhe ja numëroi në kraharor plumbat, ndërsa Osmani më pas e qëlloi në kokë, në mes të njëzet sejmenëve shoqërues, duke e lënë të vdekur në mes të pazarit.

Burrërisë i janë kushtuar shumë këngë, sikurse është edhe kënga e Selman Likës, kënduar bukur nga i madhi Haxhi Maqellara, e cila u soll në videoklip për pjesëmarrësit.

Kënga e vallja janë traditë e vyer në çdo gëzim të kalabardhasve se i kanë kënduar bukur përherë jetës, bukurisë, bujarisë, besës, trimërisë, luftës për mbrojtjen e trojeve të veta, nderit e familjes. Ata këndojnë bukur në gjuhën e tyre kombëtare shqipe dhe kërcejnë rreth flamurit kombëtar shqiptar.

* * *

Autorët kanë bërë një studim dhe dokumentim serioz për të pasqyruar të vërtetën historike të prejardhjes së popullsisë.

Autorët trajtojnë me argumente bindëse të folurën sllave vetëm në një pjesë të fshatrave të Kalabardhës, e cila bëhet shkak për një perceptim të gabuar apo për të ngritur falsifikimet rreth identitetit etnik të kësaj popullsie. Ata theksojnë se folura sllave në disa fshatra të Kalabardhës nuk ka të bëjë fare me identitetin e kalabardhasve ilirë, arbërorë, shqiptarë. Zhargoni sllav është një mbivendosje gjuhësore, që e ka imponuar Perandoria Bullgare në kohën e pushtimit të kësaj zone në shekujt 9-11-të, me mjete të ndryshme. Në ruajtjen e forcimin e gjuhës ndikoi fuqishëm jo vetëm gjuha e administratës së pushtuesit bullgar, por edhe liturgjia fetare e kishave ortodokse në fshatrat e zonës, të cilët ishin mjaft afër qendrës së Patriakanës, Ohrin, “fe që ishte e përbashkët jo vetëm për grekët dhe bullgarët, por edhe për arbëreshët”.

Në dygjuhësinë dhe ngulitjen e saj rol ka luajtur edhe një sërë faktorësh të tjerë: *së* pari, orientimi qeveritar i shtetit bullgar me pikësynim afrimin etnik; së dyti, dhënia e fshatrave të populluara me arbëreshë ortodoks, si prikë zotëve me kombësi sllavo-bullgare, nga zotër që afërsisht mund të kishin edhe kombësi arbëreshe; së treti, për afërsi tregjesh shkëmbimi, sidomos kur shkonin në Strugë, Ohër, Manastir etj.

Pra, autorët argumentojnë se e folura sllave e një pjese të popullsisë së fshatrave të Krahinës nuk është “gjuhë e nënës”, por e huazuar, e imponuar nga rrethana historike, si nevojë jetike krahas gjuhës arbërore. Padyshim, përhapja e zhargonit sllav mbështetej nga pushtuesi në platforma etnike për spastrim etnik dhe shoqërohej me masa shtrënguese e detyruese.

Autorët theksojnë se nuk jeton e banon asnjë familje sllave në fshatrat e Gollobordës, as serb, as maqedonas dhe as bullgar. Kalabardhasit “janë etnikë shqiptarë të pastër në doke, zakone, tradita”, në gjak e në shpirt. Asnjë fis i fshatrave të Kalabardhës nuk ka prejardhje sllave. Fshatrat e Kalabardhës rrethohen tërësisht nga shqiptarë dhe nuk kanë asnjë lidhje, as gjinore, me maqedonas. Ata familje sllave të vendosura si kolonë në krahinën tonë në kohën e dyndjeve sllave u larguan pa lënë asnjë pasardhës, se ishin në tokë të huaj, ishin tribu dhe nuk zunë rrënjë.

* * *

Studiuesi dhe historiani i mirënjohur i krahinës së Kalabardhës, kryetari i Shoqatës atdhetare patriotike “Haziz Lila” z. Ramazan Hoxha, në fjalën e tij tha:

Eventet e promovimit të librave kohët e fundit janë kthyer në ngjarje festive ku autorët dhe lexuesit e tyre komunikojnë natyrshëm të zhveshur nga çdo lloj paragjykimi. Nga ky këndvështrim, unë ndjej kënaqësi që më jepet rasti të përshëndes nga kjo foltore Kadri Dautin dhe Arif Shutinën, të cilët nxorën këto ditë librin e tyre të parë me titull: “*Kalabardha – Kështjellë e Arbërisë*”.

Me të dy autorët ne takohemi jo rrallë, pasi bëjmë pjesë në kryesinë e Shoqatës atdhetare patriotike “Haziz Lila” të Gollobordës, ku diskutojmë e këmbejmë mendime dhe si autorë librash e artikujsh, botuar në shtypin e përditshëm e periodik, për probleme të ndryshme, kryesisht për krahinën tonë, e cila ka mbetur e virgjër dhe e pa eksploruar deri më sot nga pikëpamja e historisë së saj, mbasi nuk është marrë seriozisht në konsideratë nga shkenca e historiografisë shqiptare dhe Akademisë tonë të Shkencave.

Konkluzioni: në këto kushte, kjo barë na takon neve, intelektualëve gollobordas, që nuk janë pak në çdo fushë, për ta lëvruar. Ka ardhur koha që Golloborda (që autorët me të drejtë e quajnë ***Kalabardha***) të flas në botime shkencore në të gjitha fushat nga intelektualët e saj. Mjaftë ka folur dhe bërë histori vetëm në profesionin e ndërtimtarisë, që është një profesion historik i saj e që në këtë drejtim nuk ka të krahasuar me asnjë krahinë tjetër në Ballkan. Por që historia e kësaj treve të trajtohet si shkencë, ashtu sikundër është në të vërtetë, duhen studiues seriozë e racionalë, (sikundër janë autorët e këtij libri), që ta trajtojnë si shkencë ekzakte, sepse ajo e tillë është, mbasi është rrjedhim kronologjik i fakteve dhe i ngjarjeve, të cilat kanë ndodhur në data fikse të përcaktuara saktë dhe jo nga studiues kafenesh, që mund ta trajtojnë historinë sipas qejfit dhe interesit dhe ta interpretojnë edhe kështu edhe ashtu. Mesazhi është i qartë: bukurive dhe pasurive të natyrës dhe historisë le tu shtojmë mundin, djersën dhe aftësitë tona fizike dhe intelektuale, për ta bërë më të pasur, më të kulturuar dhe më me vlerë.

Dy fjalë për librin. Libri i këtyre autorëve që promovojmë sot, është i zhanrit të publicistikës së mirëfilltë, pasi është gërshetim i publicistikës letrare me atë historike e shoqërore, ku autorët na shfaqen si mjeshtër të vërtet, duke shkruar me një gjuhë të kultivuar për historinë, kulturën, traditat dhe figurat e kësaj treve, përmes hollësive, informacionit, kujtimeve dhe përshkrimeve letrare ata shfaqen jo thjesht si regjistrues faktesh, episodesh e ngjarjesh, por edhe si gjykues e analistë kompetentë, përmes një pune të lavdërueshme në mbledhjen e sistemimin e materialit.

Të pasqyrosh të gjithë këto atribute që na sponsorizon krahina jonë e vendlindjes, Golloborda, por edhe Dibra në përgjithësi, është një punë jo e lehtë dhe përbën një mision të rëndësishëm intelektual. Por t´i harmonizosh të gjitha këto e t´i vësh në shërbim të interesave kombëtare që të flasin shqip, është aftësi sa intelektuale aq edhe patriotike dhe njerëzore.

Për të gjitha këto e të tjera, jeni të lutur ta lexoni librin e autorëve Kadri Dauti dhe Arif Shutina: “*Kalabardha – Kështjellë e Arbërisë*” dhe me siguri do të ndiheni mirë e nuk do denjoni ta hiqni këtë libër kollaj nga dora.

(vijon në faqen 18)

Referuar dokumenteve zyrtare, autorët kanë trajtuar edhe ndarjen administrative sipas periudhave historike që nga 1467 deri më 2015. Një vend të veçantë në libër merr dhe trajtimi i popullsisë së kësaj treve, ku mbështetur në defterët osmanë, japin fakte mbi origjinën shqiptare të popullsisë së fshatrave të Kalabardhës. Ata theksojnë faktin se popullsia e kësaj treve ka qenë historikisht popullsi me etni të pastër iliro-arbërore.

"Kalabardha - Kështjellë e Arbërisë" - arkiv i gjallë i historisë, kulturës dhe identitetit etnik të popullsisë së Kalabardhës

* * *

Nga fjala e Prof. asoc. dr. Teki Kurti, drejtor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura:

Është kënaqësi dhe nder për mua, që të shpreh para jush disa konsiderata rreth librit "Kalabardha - Kështjellë e Arbërisë", me autorë Kadri Dauti e Arif Shutina, nga "Shtëpia Botuese M&B".

Kadri Dauti ka kryer dy fakultete në Shqipëri dhe kualifikime afatgjata në Gjermani në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Ka punuar si pedagog në Akademinë Ushtarake, punonjës shkencor në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe drejtues në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura. Është punëtor i palodhur në kërkimin shkencor dhe korrekt e fisnik në mbrojtjen e vlerave gjithëkombëtare shqiptare. Është me origjinë nga Djegasi i N/Prefekturës së Artës të Dibrës, jeton e punon në Tiranë.

Arif Shutina është nga fshati Gjinaj i N/Prefekturës së Artës të Dibrës, hulumtues e botues i përhershëm i shkrimeve me karakter historik për njohjen e trashëgimisë dhe të vlerave më të vyera të historisë sonë kombëtare.

Të dy autorët i përkasin të njëjtës trevë. Nëpërmjet shënimeve dhe mbresave të udhëtimit të tyre 4 vjeçar, kanë qëmtuar sa kanë mundur e me shumë ëndje, çdo gjë që lidhet me njerëzit dhe traditat, kulturën dhe historinë e popullsisë së fshatrave të një prej trevave më punëtore në Shqipëri, që me djersë e fisnikëri ka ngritur nga themelet qytete të tëra në mbarë vendin.

Autorët edhe pse janë rritur në këtë trevë të veçantë të Shqipërisë, nuk rrinë pa e thënë se peizazhi i Kalabardhës na qetësoi shpirtin me hijeshinë dhe madhështinë e tij. Njerëzit që takuam na mahnitën për gjurmët e kujtesës historike dhe na mrekulluan me cilësitë e veçanta humane e fisnike që ruajnë



ende këta banorë.

Ky libër i veçantë prej afro 700 faqesh, bën një përshkrim të detajuar të shtrirjes gjeografike të

Kalabardhës që nga antikiteti e deri në ditët e sotme, e ilustruar kjo edhe me harta të hershme. Një vend të veçantë në këtë punim zë trajtimi me kujdes i tipareve etnokulturore, që bazuar në toponiminë e zonës hedhin poshtë emrat që pushtuesit vendosën në këtë trevë dhe në të tjera.

Referuar dokumenteve zyrtare, autorët kanë trajtuar edhe ndarjen administrative sipas periudhave historike që nga 1467 deri më 2015. Një vend të veçantë në libër merr dhe trajtimi i popullsisë së kësaj treve, ku mbështetur në defterët osmanë, japin fakte mbi origjinën shqiptare të popullsisë së fshatrave të Kalabardhës. Ata theksojnë faktin se popullsia e kësaj treve ka qenë historikisht popullsi me etni të pastër iliro-arbërore.

Në gjithë hapësirën tjetër të punimit trajtohen me radhë fshatrat brenda kufirit shtetëror të Kalabardhës dhe gjithë fshatrat të cilat, si rezultat i ndarjes së vendit tonë nga fuqitë e mëdha, mbetën jashtë kufirit shtetëror. Për çdo fshat autorët na sjellin të dhëna mbi historinë, kulturën, ekonominë, ndërtimet, arsimin, fiset, banorët, personazhe të veçanta e personalitete me vlera krahinore e kombëtare.

Autorët si vëzhgues të traditës së trevës së tyre, gjithë punimin e kanë ilustruar me foto të peizazheve natyrore, veshjeve të krahinës, banesave, ndërtesave arsimore, sociale, shëndetësore e energjike si dhe të kullave karakteristike.

I gjithë libri theksojnë autorët, është shkruar mbështetur në fakte e dokumente dhe është shtjelluar mbi atë që është parë e dëgjuar, ushqyer me ajkën e shpirtit, etosit, kulturës, ndodhive, punës ndërtimore, bukurive natyrore e fisnikërisë së kësaj treve që është pjesë e rëndësishme e Dibrës dhe identitetit kombëtar shqiptar.

Së fundmi dua të falënderoj autorët Kadri Dauti e Arif Shutina si dhe shtëpinë botuese me të mrekullueshmit dibranë Miranda e Bujar Karoshi, që na dhuruan këtë libër special, që do të mbetet si një dritare për brezat e studiuesve dhe një dëshmi e gjallë e një prej trevave më punëtore e fisnike të Dibrës tonë.

* * *

Libri "Kalabardha – Kështjellë e Arbërisë" nuk është historia e Kalabardhës, i zhanrit historik e kulturor, se autorët kanë menduar se kështu do ishte më i vlefshëm, duke dokumentuar, duke arkivuar fakte e ngjarje historike, duke treguar vendbanimet, duke pasqyruar të vërtetën e identitetit të popullsisë, të anatemuar poshtërsisht dhe qëllimisht nga disa pseudohistorianë sllavë, disa shpifarak në shërbim të strategjive nacionaliste sllave ndaj trojeve shqiptare, si rusi I.S. Jastrebov, serbi M.S. Filipoviç, maqedonasit Nj. Limanovski, E. Milanov apo Svetieva, bullgarja V. Tonçeva etj. Botimi fakton të vërtetën historike, përballë shpifjeve, shtrembërimeve dhe gënjeshtrave të tyre nacionaliste. Se me të tilla shkrime e insinuata diplomatike e gjeopolitike rusët dhe bullgarët kanë synuar e synojnë qëndrimin në trojet shqiptare si interes strategjik i tyre për Ballkanin.

Libri është një dhuratë e çmuar që autorët ia kushtojnë vendlindjes së tyre të dashur. Siç thonë vetë autorët, ata kanë shkruar dhe kanë shpëtuar shpirtin e tyre. Libri i përket tashmë Kalabardhës dhe kalabardhasve, kësaj krahine kreshnike në zemër të trojeve shqiptare. Ai është edhe një dëshmi e gjallë për brezat që do vijnë në radhë të parë për identitetin e kalabardhasve, por edhe e shumë ngjarjeve përgjatë historisë së tyre shumëshekullore.

Ky libër përbën një gur themeli i kujtesës historike dhe i identitetit të popullsisë së kësaj krahine, i cili duhet të lexohet me vëmendje dhe të jetë libër nderi e krenarie në çdo familje kalabardhase e më gjerë të çdo studiuesi serioz.

(vijon ng faqja 9)

Udhëtim në peizazhet e Gjarecës

Peizazhe në të dy anët e Drinit, ku njeriu i ka shkërmoqur me vetëdije e pa vetëdije, duke ju nxjerrë brinjët. Përkundrazi, natyra me ujin e Drinit, freskues e zbukurues, ka dhuruar peizazhe në hapësirat e pafund të shtratit të tij, plotë vlera materiale e bukuri magjepse. Ne dhe natyra kundërshtare në shekuj.

Vazhdojmë shëtitjen tonë duke mbajtur tehun jugor të rrafshës, e cila vazhdon për disa kilometra. Shikojmë se kemi disa lugina me shpate shumë të pjerrëta që zbresin në fushën e mbjellë në shtratin e Drinit. Pikërisht aty nga viti 1967 ka qenë e mbuluar me shelgje e verrinj trup lartë e me rrema uji të Drinit të veshur anash, me gjelbërim. Këto sipëfaqe toke kuadrate, kuadrate quhen Çapa e Brezhdanit. Ndoshta emërtim i ardhur ngaqë ujët e Drinit të Zi një herë në disa dhjetë vjeçar e shkatërronte, e pastaj largohesh duke sjellë lym.

Në kurrizet e njërës prej tyre të pjerrëta duket një grup dëllinjash kurorë larta e të gjëra. Në mesin e ish brezareve që nuk e kanë humbur formën. E këto i shikojmë shpesh ne shpate e kurriz me kundrejtimin jugor e jug lindor. Po kështu të shpërndara arra shumë ta rralla, por me kurora të mëdha në shpate e lugjet e thella.

Ndaloi. Para meje, një trung i madh me ngjyrë të zezë i ngulur në tokë. Më tej në një rrafshinë një cung i shkulur, me rrënjë që i ngjanin, gojës së shkyer të nja kali me dhëmbët e vjetra. Pas një vëzhgimi të hollësishëm mendojmë se janë trungje gështenjash. Edhe në fotografitë e udhëtimit tim më 2008, ne relievet e Gjarecës, kam gjetur mjaft trungje të mëdha, aty këtu, kundruall rrafshes dhe përgjatë shpateve.

Nga intervistat me të ndjerin Islam Dida dhe Bajram Hysen Mani më kanë thënë se: "Gjareca ka qenë e veshur me lisa shumë të mëdhenj. Gështenjat nuk janë mell (mbjell), por kanë mbirë vetë, pra natyrale". Peizazhi i tanishëm të provokon për të besuar, mbi bimësinë drunore në shekullin e XIX dhe fillimet e shekullit të XX. Por ngrohja e rruzullit tokësor, nga ndryshimet klimatike e veprimet e tjera të njeriut i kana zhdukur ato. Por përse vallë në kodrën e Mizës nga një cung vegjetojnë, tre apo gjashte filiza gështenjash?

Filluam të vrojtojmë me kujdes tokën, cungjet dhe përhapjen e tyre. Toka ishte e kuqrremtë, me strukturë rriskash, pra shistoze, mjaft e përshtatshme për zhvillimin e gështenjës. Ndërsa aty-këtu gjetëm trungje, me përmasa të mëdha, të thara, me ngjyrë pothuajse të zezë. Ndërsa nga trungjet e rinj fidanët ishin të shëndetshëm, por me lartësi deri në tre metra. Ato prodhojnë shumë pak ose aspak. Kodra bie në formë shpati drejt lagjes Lleshe, ku sa më shumë i afrohemi rrugës automobilistike, ato rrallohen e zhduken krejtësisht.

Nga kodra e Mizës shikojmë poshtë në Lugun e Madh, livadhe të gjelbërta në zbritje njëri pas tjetrit, me dy shelgje vajtues, me kurorë jo vetëm bukuri joshëse, por gjigante. Ky formon me gjithë lugjet e tjerë nën rrugën automobilistike përroin e Lleshe.

Pas shpatit të luginës të sipër përmendur,formohet Lugu i Vogël ku duken mjaft mirë tarracat dhe disa molla kurore sakatuara aty këtu të hallakatura. I rrotullohemi kodrës duke dalë në kundrejtimin verilindor ku kemi krojin Fajk, fare pranë rrugës automobilistike. Më sipër gjendet Hurdha e Xhilit (Lleshit S.M). Sipër saj kemi krojin e Fikët. Në vazhdim formohet lugina e Avdiut ku gështenjat pas një zbritje prej dhjetëra metrash zëvendësohen nga arrat kurore mëdhaja. Diku këndej në këto shpate ndodhet Hurdha e Llanit.

Shpati vazhdon me pjerrtësi të butë drejt rrugës, derisa arrijmë te kurrizi i Zhuzhe. Fis mjaft i madh ky me troje nën rrugën automobilistike, i cili edhe ky ka ardhur nga fshati malor i Bulaçit. Lëmë Kodrën e Mizës ku na pret udhën kanali me ujë të kthjellët si vazhdimi i tubacioneve që kalojnë përmes lagjeve Mikle e Mëzeze të Fushë Muhurit, të cilat lidhen me Kanalin e Madh të hapur në vitin 1967. Ky kanal e merr ujin nga gjurra e Kumbullës në shtratin e lumit Murra, nën Rrabos, shpati juglindor i malit të Shmrisë.

Kaloi kurrizin dhe afrohem te një bunker. Duket si i pa mbaruar. Pra i papërdorshëm në kohë lufte. E çuditshme kjo! Të vetmin që kam takuar gjatë udhëtimit në një sipërfaqe prej 100 hektar të kodrës së Gjarecës. Kjo duhet të jetë Kodër Shame. E këtu më tej kemi Lugun Risk, ku zbret në pjesën e sipërme të tokave të Çapës.

Kalimi i një udhe automobilistike për tu ngjitur në Rrafshen e Gjarecës ka sjellë grryerjen e saj duke krijuar kanale të shumta. Ndërsa përbri saj, një përrua të vërtet ka krijuar uji i kanalit i lëshuar drejt liqenit të Zhuzhe. Në disa vende kemi bimësi të ndryshme shkurrore si: plepa, shelgje, frashër, krekëza, dëllinja etj., të cilat praktikisht pengojnë gërryerjet. Ndërsa kurrizi në zbritje, në të djathtë, ka gështenja me madhësi të ndryshme. Toka ka karakteristikat e kodrës së Mizës, e cila pëlqehet nga ky lloji druri.

Takojmë udhën automobilistike, ku në një puset, brenda së cilës ka mbirë e vegjeton një shelg kurorë dendur. Produkt i ciklit natyror, nga fara mbirja në lymin e pusetës, rritja në kushtet, uji dhe tokë brenda në dhomëzën prej betoni.

Dielli po perëndon, ku së bashku me retë e kuqe, pasqyrohen në ujërat e liqenit prej 3415 m², duke dhuruar një mrekulli natyrore në këtë buzë mbrëmje gushti. Në cepin verior kemi shtarën që ka mbuluar, si maja shigjetash atë, me të gjelbërtën e thelle. Përqark liqenit me gjatësi prej 771 dallojmë shelgje, vidha ferrmane ne lulëzim e barëra të ndryshme të gjelbërta. Kuptohet gjallërinë e bukurinë mrekulluese ua ka dhuruar uji i liqenit. Nga gurra e Kumullës të lumit Murra. Natyra dhe njeriu të miqësuar.



Me rastin e përvjetorit të lindjes

Në poezinë e Naim Plakut gjejmë pjesë historie të Dibrës dhe swhqiptarisë, gjejmë mall, qëndresë, përballje me të keqen, përballje me vetveten dhe kohën, gjejmë vizionet, ëndrrat e munguara, dëshirat që marrin krahë e bëhen degë pranverore ...

Naimi poet

Nga **SHAQIR SKARRA**

Naimi është poet, poet i këngës dhe i etnopsikikës dibrane, por jo vetëm. Poetë ka shumë, por poetë të këngës numërohen me gishtat e dy duarëve, ndoshta edhe pak më shumë. Në kryeradhë, Poet Kënge mbeten Gjokë Beci, Lefter Cipa, Naim Plaku e ndonjë që nuk më kujtohet.

Naimi si poet bën zbritjen e vet (Mbase më mirë duhet thënë ngjitjen, poezia vetë si zhanër arti qëndron shumë më lart, se çdo krijim tjetër, me bazë fjalën).

Naimi vjen në fushën e letrave shqipe, krejt natyrshëm, me një thesar, domosdo të vetin, gjegjësisht në edicionin poetik të saj. Krijimtaria e Naimit tashmë ka marrë përmasa të mëdha. Naimi mishëron disa veçori krejt të vetat të të qenit shkrimtar e poet.

Naim Plaku vështronte përtej kohës së tij, përtej grackave dhe mërive të vogla, përtej dobësive të sistemit, që i kërkonte njerëzit në rresht, njëshkolonë në frontin e "revolucionit". Ai e ngriti Dibrën dhe dibranët në një piedestal poetik, nga ku me anë të figurave të gjalla dhe të freskëta, me gjendje dehëse e magjespsëse, me një thjeshtësi dhe muzikalitet tronditës, na përcolli çaste, kohë dhe epoka që në vargjet e tij u shndërruan në përjetësi. Ky punëtor, pasionat i fjalës, i bëri autopsi shpirtit kolektiv dibran, etnopsikikës dibrane, të folmes dibrane, atyre kodeve të lashta që e kanë veçuar dibranin në raport me bashkëkombasit e tjerë, brenda e jashtë kufijve administrative, alegorisë, shprehjeve frazeologjike. Autor unik tekstesh, poet, letrar, mbledhës dhe analist folklori, studiues, me emrin e tij lidhet një nga faqet më mbresëlënëse të letrave, artit dhe kulturës në Dibër, në të gjitha kohët.

Vepra e tij është një testament fjale, që do të kalojë dorë më dorë e brez më brez, një testament dashurie, të cilin kalimi i kohës jo vetëm nuk e zbeh dot, por e nxjerr akoma më në pah, e sjell më pranë njerëzve dhe kohës. Falë kontakteve dhe punës së tij përkushtuese prej misionari të kulturës dhe gjuhës shqipe, Shkolla e Mesme e Sllovës u bë një vatër e njohur e përhapjes së përvojave nga Dibra dhe i gjithë vendi në fushën e fjalës dhe të qëmtimit të vlerave shpirtërore kolekktive, i asaj përvoje pozitive që do të finalizohej me seminare e simpoziume të mbështetura nga Instituti i Gjuhës e i Letërsisë etj.

Leximi i veprës së Naim Plakut është një ballafaqim i lexuesit me historinë, traditën, ritet, doket dhe përvojën kolektive, atë pasuri të madhe që vjen që nga prehistoria jonë dhe që ky punëtor i shquar i shkrimtarisë e ngriti në një kult të magjisë dhe bukurisë drithëruese.

Perlat poetike, estetike, psikologjike, etike dhe filozofike të shpirtit popullor dibran, Naim Plaku i risolli para lexuesve me një shndërritje të beftë, të qëruara nga çdo lloj molepsjeje, për shkak të kalimit të kohëve, të përcjella me sharmin, elegancën e një gjuhe të përkryer poetike, që vetëm një njohës i thellë i kësaj lëme dhe një pasionant si ai, mund të bënte me atë përkryrjen që tashmë njohim.

Por ende më e beftë, plot sharm, elegancë dhe mesazhe gjithëkohore është krijimtaria e tij vetjake, qoftë në tekste këngësh, qoftë në poezi të mirëfillëta dhe në risjelljen e urtësisë dibrane, me anë të rrëfimeve mbresëlënëse, plot kolorit gjuhësor dhe vlagë poetike.

Është folur shumë dhe me të drejtë për tekstet mrekullore, të një natyre të veçantë, unike të Naim Plakut. Por pak është folur për Naim Plakun poet, për poezinë e tij që plazmon e përcjell me ngjyra të ndezura lirike, me një freski dhe temporitëm të beftë, një botë të thyer, plot esencë jete dhe dramacitet, plot sinqeritet, dhimbje dhe shpresë për jetën dhe dashurinë njerëzore.

Naim Plaku, me zërin e tij unik, me talentin e rrallë dhe fuiqinë e përfytyrimit, me njohjen e thellë të historisë dhe vetëdijen e tij prej misionari, na ka përcjellë një testament poetik për sot e për nesër, për Dibrën dhe dibranët, për brezat dhe historinë.

Poezitë e tij janë të thella e të kapshme në të njëjtën kohë, me një figuracion të freskët, që i përgjegigjet të folmes me rrotulla, të folmes "nën mutaf" të Dibrës, me një lirizëm aq të natyrshëm, të shtruar e spontan, që të zhyt në një botë sa reale aq magjike, sa konkrete aq dhe universale.

Teksa vështronte mëngjezet e qullura me vesë dhe shtrëngesa, të një kohe të pa kohë, brenda shpirtit të Naim Plakut konturohej klithja e në vend të saj, në vend të atij trupëzimi të trishtë, që vinte nga ballafaqimi me një realitet të dyzuar e vrastar, poeti bluante në shpirtin e tij drithin e vetmisë dhe vargjet shpërthenin kanatat e zemrës së robëruar.

Para tij, në atë fushpamje të dritshme të një shpirti të pasur e plot hove djaloshare, dëlirësi e sinqeritet tronditës, shfaqej ikona e thyer e një kohe të dyzuar, bëmat e kohëve të lavdishme që bënin kontrast me shtirjen, dyzimin dhe manipulimin e një epoke, që e shikonte njeriun bashkëkohës nën një politikë të shtrembër e denigruese.

E gjithë historia e Dibrës dhe e shqiptarisë, është aty, në pikjatën e atij vështrimi që rrok Sllatinën, malin kryelartë sipër saj dhe kodrat e bokat poshtë saj: që nga Kryeprijësi dibran, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i cili ndezi kushtrimin e maleve e ruajti identitetin arbëror të këtyre trojeve për një çerekshekulli lavdie, deri tek "hutat që këndojnë nëpër kulla" e që tregojnë heroizmin më të ri dhe qëndresën më të re të dibranëve për liri e dinjitet shoqëror.

Në poezinë e Naim Plakut ekziston një prirje intuitive për ta sendërtuar figurën në rrënjët fabuleske të poezisë, një veçori e poetëve modernë, të cilët shkrijnë në një kulm abstragimi të gjitha enumeracionet dhe lakimet e mundshme të trajtave të vetëdijshme apo inkoshiente të lëndës së parë poetike.

Variacionet poetike në formë mozaiku brenda konstruktit poetik të poezive të tij shkrihen në kodet nëntekstuale, të shartesave të kumteve dhe përcjelljeve të folkut, etnopsikikës kolektive, asaj pasurie të koduar të të folmeve me rrotulla, "nën mutaf", prej të cilave rrjedh mesazhi dhe qëndrimi i poetit ndaj gjërave që e rrethojnë, si ngacmime të vatrave të trillit dhe fiksacionit poetik.

Në poezinë e tij, Naim Plaku i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arkitipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, maturia (mat shtatë herë e pre një herë) etj. Sllova, Sllatina, Drini i Zi, Korabi, Runja, Fusha e Korabit, Bjeshka e Zojave etj, janë toponime që lëvizin në poezinë e tij dhe përftojnë qasje estetike dhe emocionale të forta. "Zogu i verës", "Hana e zezë", "Krojet e ambla", "Flladet e hazdisuna" etj., përdoren nga poeti si stilema identifikuese të trajtimeve të tij poetike, gjendjeve, kujtesave dhe emocioneve që lyp të përcjellë te lexuesi.

Naim Plaku nuk konstaton, ai depërton thellë nën lëvoren e objekteve poetike, duke vizatuar me ngjyra të ndezura peisazhe të thyera të shpirtit njerëzor, copëza qëndrese të mbetura pezull, kohë të turbullta e stoike, të mbetura në kujtesë si vizatime të kohëve shpellore, bukuri të ftohta që mardhin nën brymën e iluzioneve. Ai zbulon magjitë dhe kontrastet e gjërave që e rrethojnë, dehjet dhe stopimet e ëndrrës, duke operuar me figurën bazë të vizionit të tij poetik –metaforën, si natyralizim të kredos së tij të brendshme.

" Çka po i thotë Korabi Drinit:
-M'i këndo kangët e trimit,
Kangët e moçme të kullës së barotit,
Gjak i gjakut të Kastriotit!"
(Poezia "Gjithë trimëria në kuvend", vëllimi "Fllad e frullizë", fq 48)

Në veprat poetike "Fllad e frullizë" ,"Kreshtat e Korabit" dhe "Trëndafila mbi mermer", Naim Plaku na sjell këngë dhe poezi epiko-lirike me një tematikë disi të përcaktuar: ngjarje dhe njerëz të vlerësuar në një detaj të jetës së tyre, mendime e mbresa nga ajo çfarë ai ka dëgjuar e shikuar në jetë e në punën e tij, ku angazhimet në fushën e kulturës, në veprimtaritë kulturore zinin një vend të rëndësishëm.

Eposi heroiko-dramatik, qëndresa e shpirtit të lirë, individë që ngrihen mbi unin e tyre në emër të unit të atdheut, madhështia e trimërisë dhe sakrificës sublime etj. Ato janë pjesë e angazhimit të poetit për të sjellë një realitet të plotë poetik të qëndresës historike të Dibrës kundër mizorisë dhe të gjitha formave të shfaqjes së saj në kohë hapësirën shqiptare.

Autori na përcjell këngët e logut të trimave, këngët e Rabushit, ofshmat e netëve të zeza (elegjitë dhe vajet), "trokitjet në portën e fundit", siç e quan ai ciklin e fundit poetik tek përmbledhja "Flladë e frullizë", ku nga vetë titulli konturohen dy këndvështrime: këndëvështrimi lirik, ku fryjnë erërat e ngrohta të pasionit njerëzor, flladi dhe dashuria për jetën në raport me dhimbjen, rrebeshin e lotit, dhe këndvështrimi epiko-dramatik që sjell me vete ritme të vrullshme të ligjerimit poetik, duke iu përgjigjur rënies së trimave në fushën e nderit të betejave dhe humbjes e të dashurve në luftë apo në paqe.

Balada, elegji, këngë të përvajshme, epitafe mbushin fletët e librit tjetër me poezi "Trëndafila mbi mermer", ku poeti risjell me jehona të shumëfishuara të dhimbjes dhe ëndërrimit krijimtarinë e pasur të popullit, ku brenga, vetmia, loti, mungesa, plagët e shpirtit të shkaktuara nga ngjarje me përmasa të dhimbshme, janë "trëndafilat mbi mermer", që kujtesa popullore dhe poeti që e ridimensionon këtë kujtesë vendosin si homazh për dhimbjen dhe dashurinë njerëzore.

Që nga këngët për bëmat e Motit të Madh (Prina, Gjergj, se na ke ne), tek këngët sokëllimë bjeshke e mali për Elez Isufin, Brahim Gjoçin, Dine Hoxhën, Avni Përnezhën, Sefedin Tomçinin, Besim Çerën, Selim Alliun, Myftar Krashin etj, etj.

Pastaj këngët kushtrim të Nëntë Maleve, (Moj Dibra me Nëntë Male), këngët e dhimbjes krenare të Drinit (Valë me lot pa na sjell Drini), tek magjitë e Sllatinës etj, etj, pena e Naim Plakut, shpirti i tij i mbushur me tinguj hyjnorë dhe melodi magjike, na sjellin një univers mrekullor të Dibrës në histori dhe përditshmëri, me luftërat, bëmat, fitoret, humbjet, heronjtë, martirët, kështjellat e virtytit etj.

Mund të themi se çdo poezi në vetvete e poetit Naim Plaku është prezantimi i një ishulli metaforash, ku frymon historia, përditshmëria, trazimet e kohëve të vështira të shqiptarisë, shpirti qëndrestar për liri i dibranit dhe shqiptarit përballë lukunive të pushtimit të brendshëm e të jashtëm, përballë çdo lloj agresioni që kërkon të cënojë integritetin e maleve dhe krenarinë legjitime të malësorëve.

Poezia e Naim Plakut është një endje në tezgjahun e ndjesive tokësore dhe metafizike, një kërkim arketipal në kujtesën e historisë, të të gjallëve dhe të të vdekurve, është gjendje, ndjesi, imazh, kujtesë, përcjellje e figurave, trajtave strukturore dhe imazheve që herë herë të befasojnë. Freskia dhe spontaniteti i gjetjeve poetike, vëzhgimet e holla, ambivalenca e figurës dhe imazhit, kontrapunkti etj, janë vetëm disa nga pamje të ajzbergut të tij poetik.

Në poezinë e Naim Plakut gjemë pjesë historie të Dibrës dhe Shqiptarisë, gjejmë mall, qëndresë, përballje me të keqen, përballje me vetveten dhe kohën, gjejmë vizionet, ëndrrat e munguara, dëshirat që marrin krahë e bëhen degë pranverore në pemën e jetës, gjejmë motivimet më të thella e më ekzistenciale të dashurisë njerëzore, si ndjenja dhe përjetimi më madhor i njeriut dhe kohës së tij.

Poeti tenton që të shkrijë në një, kohën imagjinare dhe kohën reale, impresionet vetjake dhe deduksionet poetike universale, kumtet e përmbledhura në një vektor tredimensional të kohë-hapësirës poetike dhe befjet e çastit, si shtysa për të dalë në rrugëtimin e kërkimit të tij poetik. Ai është i besueshëm e spontan sikurse kur flet për shiun e verës, hutat nëpër kulla, ndërrimin e kësulave, ("si lshojmë kullat pa i ndërrue ksulat"), ashtu dhe kur na komunikon vrullin e një figuracioni të rrëmbyer e spontan, në gjeneratoren e së cilës vërtiten ndjenjat, pasionet dhe përjetimet më epokale të kohës dhe historisë.

Në poezinë e tij Naim Plaku plazmon një botë në lëvizje, që nga rrugët, ujërat, malet, fushat, kodrat, bregoret, urat, gjurmët deri tek ndjenjat më të thella, që përbëjnë shtratin fundamental të kujtesës dhe emocionit njerëzor. Në poezitë e tij lëvizin emra, vende, gjendje, heronj, martirë, njerëz të thjeshtë që kanë kryer bëma madhore, vajtojca, që përcjellin dhimbjen e të vdekurit, ballafaqime në kohë-hapësirën poetike, lëviz përjetimi dhe emocioni i poetit, të cilat ia përcjell lexuesit me një thjeshtësi dhe magji trinduitëse.

Në këto poezi nuk ka zhurmë, por ashtu natyrshëm, shpalset vektori i një historie dhe përditshmërie të trazuar, me heronj, bëma, ankth, situata heroike dhe lirike, ku vërtiten fati dhe fatalittei njerëzor, e bukura dhe e shëmtuara, humanzmi e fisnikëria, nga njëra anë, dhe barbaria e makutëria, zemërngushtëisia e dritëshkurtësia, nga ana tjetër. Ngjyrat dhe dritat poetike në poezinë e Plakut marrin e japin me njëra-tjetrën në një lojë të pafund imazhezh, gjendjesh dhe formash të shpalimit të lirizmit dhe dramatizmit poetik.

Kjo prirje e brendshme, shpirtërore, psikologjike dhe në thelb mentale, që buron nga njohja e thellë e jetës dhe historisë, nga kontaktet e shumta të autorit me njerëzit, nga freskia e mjeteve shprehëse që vë poeti në shërbim të synimeve të tij poetike, e bëjnë Naim Plakun një kërkues të pasionuar të së bukurës, një mbartës të filozofisë ekzistenciale të dashurisë njerëzore, e cila duket se është kryefjala e artit të tij poetik. Poezia e Plakut është një poezi dinamike, që rrok hapësira jete në lëvizje dhe zhvillim, një verb atdhetarie që përndizet në vatrat e përflakura të metaforës, plot thyerje dhe digresione, siç është vetë jeta njerëzore, që ai plazmon në poezinë e tij.

Nëse do të donim të gjenim sekretin e një komunikimi kaq fin të autorit me lexuesin e tij, me të cilin duket sikur ai bashkëbisedon në një natë dimri me zjarr në vatër dhe mirësi në shpirt, atje në odën e Kullës së tij me oxhak, në Sllatinën e vet, ku netëve të dimrit fryjnë erëra tërbimi. Ndoshta do të na duhej të gjurmonim fijet e jetës së tij, punën e gjallë me njerëzit, mbledhjen odë më odë e kullë më kullë të nektarit poetik, përcjellë me aq ngjyrime në kuvendet e burrave të Ujë e m'Ujës e të Dibrës; gjithë këtë shndërritje mrekullore,

Naim Plaku na e ka përcjellë me një gjuhë të ëmbël e të latuar bukur, me një figuracion të pasur deri në befje, me një temporitëm lirik, që të deh e të bën të përfshihesh në botën e ëndërrimit.

Naim Plaku është një poet i thellë, i shtruar, i vrullshëm, i ngrohtë, plot ritme jete dhe ngjyra të përndezura, ku rrinë aq mirë dhe në simbiozë të plotë elementët klasikë me pak spërkatje të lehtë, një si tis moderniteti. Ai vizaton shkujdesur, por me linja të qarta e të përvijuara ëmbël peizazhe të thyer të shpirtit njerëzor dhe të përditshmërisë, fokuson historinë e Dibrës dhe të Shqipërisë, duke dashur të zgjerojë këndvështrimin rreth të sotmes dhe së ardhmes.

vijon në numrin e ardhshëm

Ne të gjithë mësuam shumë prej tij,
prandaj ai do të mbetet gjatë në kujtesën tonë.

KRONIKE

Udhëtim dinjitoz ndër vite me Hakiun

Nga **SELMAN MËZIU**

Sa kujtime mbart njeriu në hojet e trurit. Ato kur tregohen bien si petlat e luleve, për t'i lënë hapësira thekëve e pistilit për të formuar kokrrat. Ato te dikush shpërthejnë furishëm në biseda të këndshme, të ngrohta, mbushur me përmallime. Te të tjerët në libra e artikuj përkujtimor. Në kangë, rapsodi e poezi duke ju dhuruar përjetësinë si idhuj hyjnor.

Atë ditë u mblodhën shumë. Udhëtuan që në agimin e purpurt vjeshtor të mëngjesit, mbushur me freski ledhatuese të 17 tetorit. Udhëton drejt Tiranës inxhinier Kleanthi Mandi nga Gjirokastra e kalldrëmeve të gurta e gjelbërimit në shpate gëlqerore të malit të Gjërë me pishat e egra të harlisura

Nga Mirdita, Mark Zefi, kolegu e bashkëstudenti i Hakiut, i cili pasi ju mori leje dy miqve nga Shkodra kthen udhëtimin duke ardhur në përurimin e dy librave të Hakiut.

Poeti, historiani, pylltari më prodhimtar e gjithmonë i gjallë e veprues për mjedisin, pyjet, natyrën Ahmet Mehmeti udhëton plotë energji nga Elbasani. Duke ju dhuruar bisedave, ngrohtësi, qartësi, profesionalizëm e patriotizëm

Inxhinier Hasan Kukeli bashkëmoshatar, student për katër vjet me Hakiun, dibran nga Mustafet e Dibrës sa poshtme, vjen edhe pse me këmbën e vrarë për të folur mbi kujtimet e pashlyera për pylltarin nga Sopoti i Zerçanit Haki Kola.

Inxhinier Munir Hoxha foli si një orator, mbi punën krijuese, prej pemtari e pylltari, për inisiativat e idetë e shumta mbi zhvillimin e pylltarisë në unitet mendimi, veprimi dhe pronësie me fshatarin e pylltarët si udhëheqsa teknik në zbatimin e silvoteknikës.

Profesor Gafurr Muka në fushën e gjeologjise kujtoi femininë me bashkëfshatarin e tij Hakiun, si vogëlush mjaft i zgjuar, i zhdërvjelltë dhe që lexonte libra të fushave të ndryshme.

Bashkënxanësi i gjimnazit, Mendu Kallaverja, flet me pasion, respekt e me dinjitet e krenari për Haki Kolën, që në bankat e gjimnazit në auditoret universitare dhe të jetës në brezaret e blloqet e qershive, arrave, lajthive mollëve etj., të fushave, rrafshinave, kodrinave, kodrave e shpateve nga kodrat e Shumbatit deri në Bulqizën me Qafën e Buallit.

Inxhinier Isuf Omuri e Preng Prenga ndjekin plotë vëmendje tubimin për përurimin e librave të Hakiut, duke shprehur herë pas here respektin e mirënjohjen e thella për atë, si koleg bashkëpunëtor, drejtues, organizues shuma i çmuar nga ku duhet marrë shembull vazhdimisht.

Profesor Nehat Çollaku, Dr. Albora Kacani rreken të thurin me kujdes e mëvehtësi mbresa nga puna e gjerë me Hakiun duke treguar shpirtin e tij të madh,



Rroftë përjetësisht në zemrat tona! Urime ditëlindjesh gurgullofshin si ujëvara pranverore nga mot për HAKIUN!

novatorizmin në mendime, arsyetimet plote logjike në problemet që shqetësonin pylltarinë shqiptare shkaktura nga doracakët politik.

Ndërsa po vazhdonte përurimi i librave, Zef Naçaj zgjohet nga gjumi në orën 02 e 30' pas mesnate, duke ndjekur atë me kureshtje e vëmendje. Zaten edhe duke pyetur nëse i ishin realizuar dëshirat e tij. Ai nga Amerika ndoqi gjithë veprimtarinë, ndërsa neve pjesëmarrësit hidhnin vështrimin herë pas here në portretin e Haki Kolës, peneluar me plotë mjeshtri, dinamizëm, gjallëri e rrëmbim psikologjik nga shoku e vëllai shkodran, bashkëstudenti e kolegë i Hakiut, zoti Naçaj.

Me plot merak, me shumë dëshira e plot kërshëri e ndjek minut pas minute, përurimin e librave, ku këshillat e skenari i përurimit ishin parapregatitur prej tij, me imtësi, kujdes, vëmendje, përkushtim e dashuri njerëzore nga Gjon Fierza.

Një detyrë e mbaruam për të ndjerin inxhinierin shkencëtar Haki Kola. Punëra e detyra të reja na presin për të nderuar, respektuar e vlerësuar veprën e tij të realizuar nga ai me punë të vazhdueshme, përkushtim, plotë zgjuarsi e thjeshtësi të tejkaluar.

Rroftë përjetësisht në zemrat tona! Urime ditëlindjesh gurgullofshin si ujëvara pranverore nga mot për HAKIUN!

Haki Kola i mungon Shqipërisë dhe Kosovës, maleve dhe bjeshkëve të vendit tonë

Nga **JANAQ MALE***



Të nderuar lexues, botimi që keni në duar është disi i veçantë në përmbajtje dhe me shumë autorë! Në përmbajtje të tij, janë mbresa e kujtime që lidhen me një person të përveçëm, që puna dhe jeta e lidhi me shumë të tjerë. Disa syresh kanë shkruar nga shumë të tjerë që mund të shkruanin. Këto nuk janë thjeshtë mbresa dhe kujtime vetëm midis tyre, por janë mesazhe, që tek i lexon të bëjnë të vlerësosh dhe të mendosh jo vetëm për personin e përveçëm Haki Kola, por dhe mënyrën si ai punoi dhe kontribuoi, falë intelektit dhe përkushtimit personal dhe bashkëpunimit me kolegët në vite. Ky qe' një model i specialistit dhe intelektualit nga mund të mësohet shumë, sidomos nga më të rinjtë që në vite do i lakojnë emrin, pa arritur ta njohin së gjalli.

Sa vështirë të shkruash për një koleg të paharruar si Hakiu. Kaloi një vit nga ndarja e tij dhe prap s'e besojmë se ai është larguar nga kjo jetë, ndoshta sepse çdo ditë ndeshemi me atë çfarë ai shkroi dhe la pas.

Unë dhe kolegët e mi ndihemi krenarë që patëm fatin dhe mundësinë të punojmë për vite me radhë me Hakiun dhe të mësojmë nga përvoja e tij shumë e vyer në sektorin e pyjeve, kullotave, bujqësisë dhe mjedisit në përgjithësi, për të cilat ai punoi me aq shumë energji dhe përkushtim deri në fund të jetës së tij.

Hakiu i mungon familjes, na mungon ne, i mungon Shqipërisë dhe Kosovës, maleve dhe bjeshkëve të vendit tonë. Na mungon shumë ne bashkëpunëtorëve të tij në shumë vite, ku punuam shumë afër dhe ndërtuam dhe zhvilluam punën tonë në sektorin e pylltarisë dhe zhvillimit rural. Ai ishte një koleg i dashur, shumë profesional dhe mbështetës, ekspert i shkëlqyeshëm në fushën e pylltarisë dhe bujqësisë, që i sherbeu sektorit mbi 35 vjet me përkushtim në Shqipëri dhe në Kosovë.

CNVP (Bashkojmë vlerat e natyrës me njerëzit) është Fondacion hollandez që vepron në Ballkan. U krijua nga ekipi i pylltarëve dhe specialistëve të tjerë që punuan për shumë vite brenda Organizatës hollandeze për zhvillim - SNV. Kur kjo organizatë mbaroi vepimtarinë e saj në Shqipëri, ky grup inxhinierësh të pylltarisë dhe jo vetëm, vendosën të krijojnë CNVP në korrik, 2012. Aktualisht CNVP po zbaton projekte në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Pyjet, kullotat, bimët mjekësore dhe komunitet vendore të lidhura me to, janë fokusi i punës tonë si CNVP. Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të trajtuar sfidat me të cilat përballen natyra dhe njerëzit në vendet në zhvillim. Duke promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, ne ofrojmë mbështetje për komunitetet lokale dhe qeveritë për krijimin e një jete në harmoni me natyrën. Përmes projekteve tona ne do të vazhdojmë të kontribuojmë në Ballkan.

Si specialist dhe drejtues i ekipit të SNV në Kosovë, pastaj si një ndër themeluesit dhe drejtuesit e ekipit të CNVP në Kosovë dhe më pas si specialist në CNVP Shqipëri deri sa doli në pension në vitin 2018, inxhinier Haki Kola ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe në sukseset e këtij fondacioni. Puna drejtuese dhe si specialist e Haki Kolës në CNVP ka marrë vlerësime maksimale nga përfituesit vendor të projekteve, nga kolegët, nga donatorët dhe organizatat e tjera bashkëpunuese. Janë shumë shkrime, manuale, studime, raporte, projekte, etj. që janë hartuar nga inxh. Haki Kola si autor apo me bashkëpunëtorë që tashmë në logon e CNVP kanë vlerë njohje, përdorimi dhe ndërgjegjësimi të pronarëve dhe përdoruesve të pyjeve dhe kullotave, për nivelet e politikëbërjes apo dhe si publikime në shërbim të edukimit të specialistëve të rinjë dhe jo vetëm.

Ne ekipi i CNVP në Shqipëri, së bashku me dhimbjen për ndarjen e tij nga jeta, ndjehemi krenarë që patëm mundesinë dhe kënaqësinë, që Haki Kola punoi dhe kontribuoi midis nesh në periudhën më të mirë të jetës së tij intelektuale dhe profesionale, në një periudhë të madhe transformimesh në jetën shqiptare por dhe të vështirë. Ai ishte ndër të parët specialistë që arriti të gjejë mundësi dhe rrugë për t'u përshtatur në sistemin e ri demokratik dhe në fushën e pyjeve dhe mjedisit ku ai ka qenë promotor dhe pjesëmarrës në hartimin dhe përgatitjen e legjislacionit të sektorit të pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore me në fokus pyjet komunale. Ne të gjithë mësuam shumë prej tij, prandaj do të mbetet gjatë në kujtesën tonë.

Botimi i përgatitur me mbresa dhe kujtime për Haki Kolën, synon të japë dhe atë dimension shoqëror, profesional dhe intelektual që ai ka pasur të manifestura që në rini, të shtuar në vite në punë dhe funksione të ndryshme, ato lidhje dhe njohje jo vetëm me ne kolegët e bashkëpunëtoret e CNVP, por së shumti jashtë nesh.

Falënderoj nga zemra të gjithë kolegët, miqtë dhe bashkëpunëtorët që kontribuan me shkrime në këtë botim. Një falënderim i veçantë në përgatitjen e këtij libri, si nismëtar, që grumbulluan dhe përgatitën për botim këto kujtime dhe mbresa nga jeta dhe vepra e Hakiut është për "grupin e punës"; Gjon Fierza, Selman Mëziu, Zef Naçaj dhe Ilir Kola, që punuan me përkushtim dhe dashuri për finalizimin e tij.

Kënaqësi, që tashmë shumë botimeve me logon e CNVP do ju shtohet dhe ky botim.

** Drejtor i CNVP Shqipëri*

botim

Ky botim është një përpjekje modeste, ka si qëllim të përcillen ato vlera dhe mesazhe që kanë shkrimet e ing. Haki Kolës. Ai, si njeri, si specialist, me vlerat që mbarti dhe kontributin që dha e meriton, të jetë sa më gjatë midis nesh në kujtesën tonë.

Haki Kola: *"Pas drurëve të çdo pylli, të shohim njerëzit me interesat e tyre"*

Nga **ing. GJON FIERZA ***

Botimi që keni në duar, ka në përmbajtje disa nga shkrimet e inxhinierit të ndjerë Haki Kola. Këtu janë përmbledhur disa nga shkrimet e periudhës së fundit afërsisht 10-vjeçare. Ishte e pamundur që në një kohë të shpejtë, të gjenden dhe të botohen në një apo disa vëllime ato që ai ka shkruar, publikuar dhe të mbetura në dorëshkrime.

Në rreth 40 vite, si specialist, në detyra dhe funksione të ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë, Haki Kola ka një veprimtari të spikatur profesionale, drejtuese e botuese. Titujt e shkrimeve në publicistikë, manualet të ndryshme profesionale, studime, shqipërime, skenar filmash dokumentarë etj., janë rreth 400 tituj. Një numër i madh i këtyre shkrimeve gjendet në faqe dhe adresa të ndryshme në internet.

Ishte një cilësi e vyer e tij, që ato çfarë arrinte të hulumtonte, kështillat dhe përfundimet t'i ndante me kolegët dhe ndjekësit e tij të shumtë tashmë në internet. Deri në ditët e sotme, ai është specialisti i pyjeve nga Shqipëria dhe Kosova që ka shkruar e publikuar më shumë në shtypin e shkruar dhe në internet në 20 vitet e fundit

Ai në një komunikim me një nga kolegët (S. Mëziun) i thotë: *"Unë e pata fatin të futem më në detaje të situatës së pyjeve e lidhjes së saj me gjendjen sociale të Shqipërisë si dhe me kushtet ekologjike. Kam qenë të shumtën e kohës në pozicione të ndryshme të mendimit me kolegët e profesorët tanë të nderuar, ashtu siç kam diferencë në shumë mendime me juve personalisht, lidhur me shkaqet e gjendjes aktuale dhe zgjidhjet"*. Ai vijon ... *"do vazhdoj, jam në punë intensive për pyjet e ulëta të Shqipërisë dhe në tërësi të Ballkanit për një prezantim në Kongresin e radhës të IUFRO-s që mbahet në USA. Unë kam bërë shumë përpjekje që veçoritë e pyllit dhe të situatës aktuale t'i ndaj me kolegë të nderuar që me ta të ndajmë edhe zgjidhjet, s'do pushoj së kontribuari, por ama në mënyrën time, që të ndajmë me publikun dhe ekspertët e fushës mendime, e t'ju tregojmë për më shumë, "pse-të" që ngrihen rreth kësaj pasurie kombëtare dhe shumë shtigje nga mund të fillojë ndalimi i katastrofës e zhvillimin e pyjeve"*.

Pse mora përsipër që të paraqes këtë botim?! Njohja dhe bashkëpunimi me Haki Kolën, që fill që në mesin e viteve '90, kur ai ishte specialist në Projektin Shqiptar të Pyjeve (B.B) për komponentin e pyjeve komunalë, ndërkohë unë punoja në DSHP Lezhë dhe si specialist isha i caktuar në mbështetje të Projektit e Pylltarisë Private (USAID) për pyjet komunalë në atë rreth. Në një seminar që organizonte Projekti i pyjeve u ftova, aty së pari i dhamë dorën njëri-tjetrit. Ky ishte dhe pikëtakimi ku përveç njohjes filloi dhe komunikimi dhe bashkëpunimi profesional. Kaluan vitet, ne të dy, në punë dhe institucione të ndryshme e vazhdonim komunikim dhe aq sa mund të bashkëpunonim. Në vitet 2002-2004 e solli rasti që ai si drejtor Projekti shqiptar të pyjeve dhe unë të punoja si specialist në projekt (në vartësi të tij), për informimin dhe ndërgjegjësimin publik. Kjo që fushë që Hakiu e pëlqente dhe i jepte mjaft rëndësi në projekt. Komponenti i pyjeve komunal nuk mund të ecë nëse nuk ka një informim dhe ndërgjegjësim publik theksonte ai. Për mua kjo punë ishte diçka e re, kisha pak njohuri të fituar në Projektin e Pylltarisë Private (APFDP) për informimin e ndërgjegjësimin publik.

Me aq njohuri sa kisha, me mbështetje dhe ndihmë të drejtpërdrejtë të Hakiut në këtë n/komponent, në atë periudhë së bashku me DPPK, realizuam disa veprimtari e botime me shumë vlera.

Hakiu thoshte dhe bëri si moto të punës në drejtimin e projektit *"Pas drurëve të çdo pylli, të shohim njerëzit me interesat e tyre"*. Ai vazhdonte të shkruante në revista e gazeta,



na nxiste dhe ne të tjerëve të shkruanim sa më shumë. Ai organizoi dhe mbështeti për rreth katër vite në 30 numra botimin e "Buletinit informativ" në 1000 kopje si organ i DPPK dhe NJMP. Ai e shtriu këtë mbështetje më vonë në botimin e gazetës "Kurora e gjelbër" për shumë vite deri sa iku në Kosovë. Nga Kosova ai shkroi dhe mbështeti gazetën "Jeto gjelbër". Pra, Hakiu qé i lidhur me gazetat, jo vetëm në mbështetje të financimit të botimit të tyre, por dhe me shkrime të vazhdueshme.

Ndoshta diku nga vitet 2011-2012, unë dhe redaktori i njohur Veli Hoxha, i propozuam inxhinier Hakiut; që disa nga shkrimet e publikuara në gazetat: "Kurora e gjelbër", "Shqip", "Shekulli" etj, do të qe mirë të përmblidheshin në një botim libri. Ato shkrime i thamë kanë shumë vlera njohjeje dhe edukimi për nivele të ndryshme që nga fermeri deri tek studentët e pedagogët në fakultet. Ai ndonëse e pëlqeu këtë propozim, nuk na tha që unë dhe Veliu të merreshim më tej që të përgatisim botimin. Ai më pas filloi punë në Kosovë dhe kontaktet fizike qenë më të rralla. Ndërkohë, unë u dakordësova me Veliun që shkrimet e Hakiut t'i skedonte veçmas, bile ai i redaktone ato me shumë kujdes. Kështu, Veli Hoxha kishte radhitur rreth 45 tituj të viteve të fundit. Veliu ndjehej i keqardhur që i mungonin shumë nga shkrimet që Hakiu kishte botuar vite më parë tek revista "Bujqësia shqiptare" apo ato të para viteve 90 kur ai nga Dibra, dërgonte vazhdimisht shkrime shumë interesante në Shtëpinë e Propagandës Bujqësore.

Hakiu vazhdonte të shkruante disa manuale; si për arrën, gështenjën, lajthinë, pyllin e fermerit, në formë elektronike, i publikonte në internet. Ne nuk harronim të kujtonim botimin e librit kur e takonim. Ai për të "na hequr qafe" na thoshte: "*Mua me vjen keq, ju e shihni se gjithnjë e më pak, njerëzit po lexojnë. Unë nuk dua që librat me shkrimet e mia, të rrinë diku stok apo të zënë ndonjë vend në biblioteka si stoli. Do vijë koha kur do ju them, të tre s'bashku ti botojmë ato*".

Ai gjithnjë vazhdonte të shkruante dhe të publikonte në rrjetet sociale, në blogje të ndryshme dhe në vitet e fundit në blogun "Bota Bujqësore" ku shkrimet e Haki Kolës, tashmë zënë vend të rëndësishëm, që lexohen dhe komentohen shumë.

Tashmë si thënie proverbiale duhen konsideruar jo vetëm kaq do citoj më poshtë, por në shumë shkrime që ju do lexoni në këtë botim gjenden me dhjetëra thënie të tilla, përfundime të sakta, por dhe mundësi zgjidhjeje.

"Pylltaria është një art në të cilin për shkak të përmasave kohore, dështimet tentohet të harrohen, nuk mësohet prej tyre dhe kështu më vonë përsëriten. Edukimi i publikut mbi pyjet dhe historinë e progresin e tyre është mjaft i rëndësishëm dhe esencial, pasi jetojmë në një kohë kur në zona rurale pylli mbetet mjet i rëndësishëm i jetesës së përditshme...

Nëse gjenerata jonë do arrijë të vendosë piketat e pajtimit të njeriut me natyrën, së paku kemi bërë diçka shumë të vogël për një fillim të ri...,,

Nëse shkurret e Shqipërisë së Mesme, do të trajtoheshin me prerje të pastra, fillimisht me rotacione të shkurtra 5-15 vjeçare, pas 30 vitesh e gjithë Shqipëria do të ishte siç u bë Dumreja në 700 hektar, brenda 7 vitesh 1998-2005. Tek i lexon në natyrë, tek sheh të vërtetat e pathëna, rrekesh t'i shohësh e të bësh prova, sigurisht edhe të tregosh.

Është koha që për të larguar emocionet apo opinionet personale, të përdoret kalkulimi i kostos, si për: arrën, gështenjën apo lajthinë, kur janë në të njëjtat kushte ekologjike me misrin, sojën apo grurin. Koha po punon, eksperimentimi e tradita po demonstrojnë që këto tre mrekulli të natyrës, të vlerësohen e të pasurojnë dijet e mirëqenien njerëzore. Vdekja e tokës së djegur e eroduar, ka triumfuar mbi shpate male e lugina. Sipërfaqe të gjera të tokës janë kthyer në gurishtore të shkreta. Ujërat janë ndotur. Biodiversiteti është zhdukur masivisht. Njerëzit largohen drejt qyteteve, ku i pret asgjëja. Prishja e ekuilibrit midis njeriut e natyrës, largimi i fermerit nga pylli e kullota e tij, ka shkatërruar ekuilibrin natyror. Të gjithë ankohen. Të gjithë fajësohen. Këmbanat bien për një reflektim sa më të shpejtë.

Analiza e devijimeve të marrëdhënieve pronësore, krahasuar me fqinjët europiane që kanë ardhur si pasojë e ndikimit ottoman e komunist, mund të përbënin hapin e parë të reflektimit. Askush nuk do besonte që këto pejzazhe të rrjepura e "problematike, mund të kthehen në zgjidhje, për një vend që ka nevojë të punësojë banorët, të luftojë mjerimin, e të shtojë prodhimin e energjisë. Fjala e shenjtë "pronë", e kthen rrjepësin e tokës në kujdestar, djegësin në roje, druprerësin në drurritës.

Shumica e të shkolluarve pavarësisht nga specialiteti i ngushtë, janë të mbyllur në sloganin: - "Mbroni pyllin", duke luajtur patriotin e krijuar një çorientim të madh në gjithë shtresat shoqërore e veçanërisht tek vendimmarrësit.

Janë rreth 500 mijë banorë që popullojnë fushën e Myzeqesë. Nëse në këtë sezon të fushatës së pyllëzimeve do t'u ofronim 100 mijë familjeve myzeqare falas 10 fidanë për çdo familje, Shqipëria do të kishte në fund të kësaj fushate rreth 1 milion fidanë më tepër, fusha e Myzeqesë do të ishte më e bukur. myzeqarët e presin këtë ofertë nga shteti i tyre.

Shkatërrimi i vazhdueshëm i ekosistemeve malore, shoqëruar me krizat e errësirës apo përmbytjeve, na ka çuar në një moment të domosdoshëm reflektimi, për të marrë në konsideratë shumëllojshmërinë e funksioneve të pyjeve malore e për t'i kthyer ato në një pikë fokale të shqetësimeve të gjithë shoqërisë e reflektimi për zgjidhje.

Procesi i degradimit të pyjeve malore të vendit tonë është shumë divers, dhe ekstremisht kompleks, shkaktuar, jo vetëm nga natyra, por me tepricë nga politika të gabuara për një kohë të gjatë, që lidhen me njohjen e mosnjohjen e të drejtave të pronësisë, të drejtat e përdorimit, edukimin, varfërinë, etj.

Shkruesi i këtyre rreshtave është pjesë e një gjenerate të shkolluar në fund të viteve '70, që e ka shoqëruar për mëse 45 vite ankesa e ekspertëve për prerje të pyjeve mbi mundësinë që natyra i ka dhënë pyllit shqiptar. U desh të afrohej fundi i mijëvjeçarit të kaluar që ekspertët dhe publiku të kuptonin që pyllin tonë po e hante me shpejtësi të madhe nevoja e familjeve për ngrohje. - ***H.Kola***

Libri ka si titull, një prej shkrimeve të tij, është grupuar në katër kapituj dhe në fund ka një jetëshkrim të përmbledhur.

Kapitulli I-rë, zë dhe pjesën më të madhe të librit janë artikuj publicistikë ku në fokus janë pyjet me problemet e tyre në këtë tranzicion të zgjatur. Shkrimet janë radhitur sipas viteve kur janë shkruar apo publikuar.

Në kapitullin II-të, janë dy intervista reale botuar në gazeta dhe një imagjinare. Janë dhe disa mesazhe dhe letërkëmbime me kolegët të kohëve të fundit.

Në kapitullin e III-të, janë paraqitur disa studime të përmbledhura dhe një listë e disa botimeve në revista ndërkombëtare. Këtu është paraqitur pak nga studimi i pa përfunduar "Dija e dushkut"

Në kapitullin IV-të, janë përmbledhur disa shqipërime që nuk janë publikuar më parë.

Ilustrimi me disa foto pa e rënduar tekstin janë përzgjedhur në funksion të temës që ka pasur shkrimi dhe kohës kur Hakiu i ka shkruar, ato nuk janë të vendosur prej tij.

Ndarja e parakohshme nga jeta e kolegut dhe mikut tonë Haki Kola qé një humbje e madhe për familjen, të afërmit, ne kolegët dhe bashkëpunëtorët. Ai iku në kohën që kishte shumë ëndrra dhe projekte për pyjet dhe mjedisin. Sapo mbylli vitet e punës për pension, në ato ditë, gjithnjë dhe gjatë kohës që kurohej në Gjermani e deri sa e kishte të pamundur komunikimin nga sëmundja më thoshte: "*Përgatitu se do kemi shumë punë përpara*". Por fati i keq e solli që unë dhe Veli Hoxha, të merremi me atë punën që ai nuk dha miratim sa qé gjallë. As unë nuk e mendoja se një ditë do t'i paraqesim disa nga shkrimet e Haki Kolës në këtë libër kur ai të mos ishte.

Ky botim është një përpjekje modeste, ka si qëllim të përcillen ato vlera dhe mesazhe që kanë shkrimet e ing. Haki Kolës. Ai, si njeri, si specialist, me vlerat që mbarti dhe kontributin që dha e meriton, të jetë sa më gjatë midis nesh në kujtesën tonë.

Është rasti të falënderoj të gjithë ata që më nxitën, më ndihmuan në përgatitjen e këtij botimi; sëpari redaktorin Veli Hoxha, ata që më dërguan shkrime e materiale të ndryshme, kolegë dhe miq të Hakiut duke veçuar; Selman Mëziu, Zef Naçaj, Janaq Male, Bujar Karoshi, Hajrush Kurtaj, etj.

Një falënderim i veçantë për fondacionin CNVP-Kosovë dhe drejtorin e këtij fondacioni z. Xhevat Lushi që mbështeti financiarisht këtë botim.

Marrë nga parathënia e librit "Kriza mjedisore ndërmjet sfidave dhe zgjidhjeve", Haki Kola.
Botimet ENJA, Tiranw, 2021.
ISBN: 978-9928-358-38-7

recensë

Fatmir Neli, poeti i jetës

Nga **MEVLUD BUCI**
studiues, poet, publicist

Puna e krijuesit ngjan me pusin e thellë, me dritën e diellit, me forcën dhe bukurinë e mineraleve të çmuara, të cilat kurrë nuk i tret dheu, nuk i vyshk koha.

Ka vite që kam lexuar poezitë e Fatmir Nelit, ka vite që e mbaj një peng për të gdhendur sadopak fjalët e zemrës, e të vërtetës për këtë krijues zemërdritë, mendjendritur e mbi të gjitha një pendë e shenjtëruar për jetë, filozofinë dhe dritën e shpirtit njerëzor.

Ç'është e vërteta, të shkruash për një krijues matjan, cilido studiues do ta kishte të vështirë, krenari legjitime, por edhe të lehtë, sepse bąçja e sotme e Klubit Letrar *"Pjetër Budi"* ka një brez të artë krijimtarie, pendëpalodhur e me plot sharm për kombin, kohën, flamurin, filozofinë, traditat, dashurinë e mbi të gjitha janë një zë lirie që i rrezatojnë kombit e brezave.

Në gjerdanin krijues të matjanëve e të kombit pa mëdyshje ze vend të merituar dhe krijuesi, gazetari, drejtuesi i palodhur në frontin e mësuesisë, Fatmir Nezir Neli. Krijimtaria e tij që rrezaton prej vitesh ka dy shina: filozofinë dhe shpirtin njerëzor, ka trinomin: jetë dashuri dhe shpirt.

Në vargjet dhe poezitë e librave të tij gëlon zëri i jetës, i dashurisë dhe i shpirtit. Sigurisht që as krijuesi i talentuar Neli, as lexuesi e cilido prej nesh, nuk ka nevojë për hiperbola, elozhe a dyzina fjalësh. E vërteta nuk do dëshmitar, e vërteta ndrit herët apo vonë. Fatmir Neli i Matit të barotit është poet i së vërtetës. Puna prej intelektuali të përkushtuar, shembëllimi prej publicisti serioz e human, takti e mjeshtëria si drejtues arsimi në bazë e kanë bërë Fatmir Nelin poet të jetës, të filozofisë e të dritës së shpirtit. Vërtetë poet i filozofisë dhe i kontrasteve jetësore, ku me sinqeritet bën diagnozën e atyre që ngjiten e harrojnë nga vijnë, humbasin më kryesoren, qenien *njeri*:

Në atë sallë të mbushur plot e përplot,
kujt nuk ia dhash dorën sot,
titullarëve, deputetëve
mjekëve, poetëve,
por nuk e di,
dorën a ua dhash njerëzve?! "Pakt me kryedjallin", faqe 131.

KU RRJEDH, PIKON

Kulla apo shtëpia e çdo përmase qoftë, ka një themel, ka muret dhe çatinë. Fatmir Neli është gen artisti, është i biri i artistit, rapsodit e luftëtarit të çetës së trimave të Matit, Nezir Neli. Në librin *"Gjerdan fjale"*, i poetit e shkrimtarit Hamdi Hysuka, midis të tjerash lexojmë: *"Nezir Neli nuk iu nda punës, as këngës. Për një të ardhme më të mirë të jetës familjare la Dukagjinin dhe u vendos në fshatin Fshat të Klosit. Një festival folklorik i Matit, organizuar në vitin 1959, zbuloi talentin e tij si instrumentist e rapsod. Orkestrina popullore matjane i bëri vend në radhët e saj, pranë të të talentuarëve Hysni Hysnelaj, Ymer Neli, Ibrahim Minxhozi, Shaqir Hazizi, Sali Haliti, Sabri Bala etj. Kënga dhe çiftelia e tij u bënë të njohura. Në vitin 1966, në Festivalin Folklorik të Elbasanit, rrethi i Matit zuri vend të dytë. Nezir Neli, këngëtar dhe instrumentist i orkestrinës popullore, u nderua me diplomën e festivali". "Gjerda fjale", faqe 216.*

* * *

Geni trashëgon genin. Pra, një artist i lindur, i rritur me punë e atdhetarí, i rritur në Dukagjinin historik matjan, i përkushtuar në luftë si luftëtar i çetës trime të Matit, i përkushtuar në minierat e kromit në Batërr e Cërujë. *"Vala e punës në minierë, për artistin e ardhshëm u kthye në tinguj melodie e nota kënge. Jeta e tij mori udhë përmes këngës folklorike" ("Gjerda fjale", faqe 216).* Ky ishte i ati i poetit, publicistit, mjeshtrit të



mësimdhënies e të drejtimit arsimor, Fatmir Neli. Nga gjurmët e traditave e të artit, nga dritëkënga e trashëguar burojnë edhe poezitë e mirërealizuara të poetit Neli.

Që nga libri i parë, vëllimi poetik *"S'e kam zili diellin"* e në botimet në vijimësi të cikleve e librave, krijuesi i talentuar Fatmir Neli shpërfaq me qartësi thjeshtësinë e shpirtit, dritën e dashurisë, bën diagnozën e shoqërisë, pasqyron rrezatimin e vlerave njerëzore. Pra, cilido lexues a studiues, kur lexon a mediton rreth vargjeve të poetit Neli, do të ndjejë kënaqësi, fisnikëri e mbi të gjhitha do të zbulojë filozofinë e mendimit, ide të cilat burojnë veçse nga mendja dhe zemra e një intelektuali krijues, fisnik, pasionant, atdhetar e mbi të gjitha një misionar e vizionar për punën, për jetën, për kohën dhe mirësinë. Të analizosh krijimtarinë e të nderuarit Fatmir Neli s'do mjaftonin as dhjetëra shkrime analitike e studimore, por u nisëm të pasqyrojmë sado pak filozofinë dhe shpirtin njerëzor. Pse? Këto janë dy shinat që pa mëdyshje përshkojnë krijimtarinë e këtij poeti.

Në krijimtari shumë krijues, ndonëse të taletuar, nga mungesa e studimeve, ndonëse janë vërtetë të ndritshëm, të talentuar, mbeten nën hije. Pse? Ngaqë mungojnë vëzhgimet realiste, dashamirëse, argumentuese. *"Shtëpia,* thoshte një i urtë matjan, *nuk bëhet vetëm me gurë të mëdhenj, me qoshe, por dhe me gurë të vegjël. Por gurët e vegjël, po të hiqen, shembin të mëdhenjtë"*.

Sigurisht krijimtaria e Nelit është e ndritshme, e gdhendur dhe e latuar me mendjemprehtësi, duke ia kushtuar vargjet jetës, dukurive njerëzore, dialogut me yllin *("Më tha një yll")*. Poezitë e krijuesit matjan Neli kanë të realizuar me mjeshtëri kontrastin, retorikën, fabulën mjeshtërore, ku autori pasqyron, këndon, diagnostikon e demaskon atë çka i vyshk vlerat e shoqërisë. Krahas shumë krijimeve mjaft të arrira, përmendim *"Mburren poliglotët", "Do të bëhej rrap", "Përralla poezi", "Kuis një qen", "Pandamë mirësore", "Engjëlli i kushërinjve"* sipas motiveve nga *"Kushëriri i engjëjve"* të I. Kadaresë, *"Gjyshes sime", "Sa zili", "I ra mjegulla Bunës", "Poetit"* kushtuar B. Bushkashit, *"Pjetër Budi", "Hafiz Ibrahim Dalliu", "I dha zë Matit"* arkeologut D. Kurti, *"Mrekullitë e tim biri", "Vetëm për një njeri", "Qytetërim", "Ura e Vashës"* e plot të tjera të librit *"Deti u mbyt tek unë"* përmbajnë filozofi jete e mendime, rrezatojnë dritën e shpirtit njerëzor. Te çdo varg zbulohet *"minerali"* i vlerave të njeriut, koha, mirësia dhe provat e jetës, dritëshpirti i atyre që kanë lënë gjurmë vlerash. Nëse e rilexon me vemendje e dashamirësi krijimtarinë e poetit matjan Fatmir Neli, duket qartazi mendimi filozofik, përshkrimi poetik, lirizmi e veçanërisht pasqyrimi i kontrasteve në jetën njerëzore, drita e shpirtit, blerimi i dashurisë.

Këngët e vjetra flasin
për dashuri luftrash,
këngët e reja flasin
*për luftra dashurish*ë.

Të parat tundin djepe,
me ritme ninullash,
të dytat çajnë bokse
me makina shpejtësish... "Pakt me kryedjallin", faqe 132.

Poeti Fatmir Neli jeton me kohën, pasqyron kohën dhe dritëson kohën nëpërmjet vargjeve poetikë, të cilat përmbajnë filozofi, ide, stigmatizime e mesazhe jetësore. Me plot të drejtë mund dhe e meriton të quhet *poet psikolog i vargut poetik*, një krijues shpirtbardhë, realist dhe demaskues nëpërmjet fabulave në disa prej librave dhe krijimeve të tij. Poeti Neli shikon përtej pasqyrës, siç i *thon*ë *"përdor sitën e mëndafshit"*, shkruan thjeshtë, bukur, kuptueshëm, plot frymëzim dhe ide, stigmatizon dukuritë negative, realizon mjaft mirë kontrastet bashkëkohore.

Më duhet shumë gjak,
të ngjyros flamurin tim
të dalë boje,
më duhen shumë pëllumba të bardhë
t'i shpërndaj atje ku paqja
*ka dalë jasht*ë *loje*... "Pakt me kryedjallin", faqe 133.

Vargje që pasqyrojnë kohën, faktet ku jemi, sikur thërrasin për të qënë më jetësorë, më besnikë, më humanë, më paqësorë! Autori nëpërmjet antitezës, epitetit metaforik dhe kontrastit kohor, na pasqyron qartë atë që secili duhet të ketë mision, trinomin: *gjaku, flamuri, paqja*.

Poezi të thjeshta e plot ngarkesë emocionale, pasqyrë e realitetit të traditave, të figurave e mbi të gjitha të pasqyrimit të filozofisë e të shpirtit njerëzor.

PROVA DRITE E PËRKUSHTIMI

S'ka se si ta mbyllja këtë shkrim për poetin dhe intelektualin matjan pa gdhendur edhe pak radhë e fakte për udhët e jetës së këtij poeti e publicisti, mjeshtri të palodhur të mësimdhënies e të drejtimit arsimor në Klos të Matit. Provat e dritës e të përkushtimit janë dy shina jete, dy dëshmi të qenies njeri, janë *"avokati"* i zotësisë dhe i drejtësisë. Që nga vëllimi i parë poetik *"S'e kam zili diellin"* dhe librat e tjerë *"Deti u mbut tek unë"* poezi, *"Ditëlindja e një televizioni"* monografi, *"Pakt me diallin"* poezi, krijimtaria e tij ka ardhur në rritje, ka pasqyruar jetën, dashurinë, plot dukuri të kohës, vlerat njerëzore, ka shpërfaqur ide, mesazhe të paqës e të traditave. Krijimtaria e letrare e poetit Fatmir Neli, përveçse ka gjetur vend në gazetat dhe revistat letrare *"Drita", "Muzgu", "Fenik", "Emathia", "Mati"* etj, është bërë pjesë dhe e disa antologjive poetike me karakter lokal e mbarëkombëtar: *"Antologji matjane"* 1618-2003, antologji e poezisë matjane *"Udhëtare me pranverën"* 2015, *"Antologji poetike për mallin"* 9, botim i gazetës *"Muzgu"* 2015, "Antologji poetike për natyrën" 9, botim i gazetës *"Muzgu"* 2015, antologjia *"Malli poetik i Kosovës"* 4, korrik 2017, antologjia *"Shqipëri, nëna ime"* Kosovë, nëntor 2017.

Fatmir Neli me profesion mësues, prej tetë vitesh drejtor i shkollës 9-vjeçare "Tahir Hoxha" Klos, prej dy dekadash ushtron gazetarinë në median vizive "Mat Tv", përvojë të cilën e ka pasqyruar më së miri në librin e tij të tretë *"Ditëlindja e një televizioni"*. Në vitin 2018 botoi librin e katërt *"Pakt me kryedjallin"* poezi.

Së fundmi, që prej vitit 2016 Fatmir Neli mban detyrën e sekretarit të Klubit Letrar *"Pjetër Budi"* Mat. Në vitin 2019 është çertefikuar *"Ambasador për paqën"* nga Federata Universale e Paqës, ndërsa që nga viti 2013 është anëtar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë.

Shembëllimi si intelektual, pasioni për krijimtarinë, njohja e jetës dhe e traditave, zelli dhe korrektësia në punë e kanë bërë të na dhurojë poezi, ku shpërfaqet filozofia e brezave, vlerat e jetës dhe të shpirtit njerëzor.

DËSHMI

Një kujtim për dom Nikollë Mazrekun nga Sefedin Juniku (Peshkopi)

Me 22 dhjetor 1969, pas tetë vjetëve burg politik (1961 – 1969) u lirova nga burgu në Reps, tregon Sefedini. Aty punohej për ngritjen e fabrikës së pasurimit të bakrit. Të gjithë të burgosurit dolëm në punë. Dom Nikolla ishte i sëmurë dhe e kishte tensionin shumë të lartë, 280 – 300. Ishte në koma. Është shumë sëmurë më tha një shok. Shko e shihe njëherë o Sefedin. Shkova. Ja ngrita pak jastekun dhe thirra mjekun. Mjeku i vuni aparatin e tensionit dhe si e pa, më tha: tashti për dom Mazrekun qofsh vetë. Domi "e kthej samarin", tha doktori. - Jo doktor. Shumë herë e kam pa në këtë gjendje. Ka për t'u ngjallë, i thëm unë. – Jo ma, ky e përdrodhi kularin.

Pas një gjysëm ore dom Nikolla u përmend. Sapo erdhi në vete, më tha: - A ke kafe Sefedin? - Po, i them. - Si të kesh kafe, më ke shpëtue. - Por e ke tensionin në pikën nevralgjike, i them. - Shko Sefedin e ma ban atë kafe. I bana një kafe të fortë. Më ngre pak! E mbështeta mbi jastek dhe i vuna filxhanin e kafes përpara. Tani mos fol se e kam fjalën unë! Çfarë tha doktori? E kishte ndigjue dhe më tha fjalët e doktorit: "Qofsh vetë për dom Nikollën se ai e ktheu samarin". Do ta diskutojmë këtë punë; e kishte inat doktorin. A ka aparat në botë që e mat se a do të vdesësh apo do të jetosh? Unë nuk besoj tek aparati i doktorit. Unë kam punë të tjera.

Kafen ma bane. Do ta pi. Me jep paketën e cigareve. Tetë cigare piu njenën mbas tjetrës. Shko Sefedin e më ban nji kafe tjetër. – Dom, ti don me mbyt veten më duket, i them. - Edhe tetë cigare të tjera e mbasandej do të më nxjerrësh në pajtoz që të më shohë doktori.

Si piu kafen e dytë dhe tetë cigaret e tjera, tha: A më ngre pak të dal në pajtoz? Ecim sëbashku nja dhjetë hapa, ndërsa doktori hapte sytë. I thash doktorit, "mos fol kështu se të ka ndigjue!" Nuk qenka gja kjo punë, tha doktori. Kam qenë i bindun 100% se ai do të vdiste. Aparatin e tensionit dhe stetoskopin i futi në çantë se ato të turpërojnë përpara dom Nikollës, tha me vete doktori. Ai ka shpirt të veçantë. Nuk ka besim tek aparati. Ai e ka besimin tjetërkund, tek do "aparate" të tjera.

Dom Nikolla e njihte shumë mirë Kuranin. Dom Ernest Troshani, dom Simon Jubani, padre Konradi ishin edhe ata. Burrë i vendosun, por nuk fliste. Deri më sot të kam pasë djalë, mik dhe shok, më tha. Sot më dukesh armik. Ke ndonjë nostalgji për jetën e lirë? ë? – E kam harrue, i them. Je rritë e burrnue mes telash. Tash do të shkosh në nji burg pa tela. Ishte jezuit.

BAJRAM XHAFA,
Peshkopi, 19 gusht, 1999.

In memoriam

Bashkim Rama, ky korife i diplomacisë shqiptare

Nga **ARSIM SINANI**

Ditë më parë iku nga kjo botë një nga figurat më interesante të diplomacisë shqiptare. S'di se si por ishte diku viti 2007, kur u njoha për së afërmi me ambasadorin Bashkim Rama. Një pedagog sistematik dhe shumë i zhdërvjelltë në punën e tij. Them se nga ai kam përvetësuar kulturën që ai e kishte në protokoll të diplomacisë por edhe një ligjërim të qartë e domethënës.

Më pastaj miqësia jonë u bë më e fortë pasi që për vite pata mundësinë të punoj me te në Akademinë Diplomatike Shqiptare. Dhe janë të shumta bisedat, diskutimet pse jo edhe shakatë pasi Bashkim Rama ishte një intelektual që dinte ta rregullonte bisedën, tavolinën, diskutimin. Dinte vërtetë dhe ishte shumë dashamirës i madh i shqiptarëve që në Shqipëri kanë nofkën: shqiptarët e trojeve.

Pse doja të shkruaj diçka për te? Duke ikur tepër i ri dhe pa e thënë fjalën e tij të fundit ndija për obligim që të shkruaj pak për te, për ta kujtuar punën e tij të madhe që e ka bërë për shqiptarët.

Në kohën sa ai ishte në zyrën Kosovës Bashkim Rama ishte një urë e madhe për komunikimin mes shqiptarëve jo vetëm nga Kosova dhe Shqipëria por edhe e shqiptarëve nga Maqedonia e veriut, Mali i Zi, e Lugina e Preshevës. Më ka rastisur vetë si gazetar asokohe që të na e bëjë agjendën për një udhëtim që kishim, e që kishte të bëjë më promovimin e vlerave kulturore të Shqipërisë.

Them se ishte një njohës brilant i kulturës shqiptare dhe i traditave gjë që e dallonte nga diplomatët e tjerë, ky ishte ambasadori Bashkim Rama siç kishim dëshirë ne ta quanim ne . Një model që secili nga ne lakmonte për tu bërë, kur bëhet fjalë për teknikat dhe mënyrën se si i trajtonte problemet.. Ishte shumë modest dhe nuk e pëlqente të mburrej për punët që bënte kjo ishte një karakteristikë e jashtëzakonshme e tij.

Në një rast më kishte nisur një letër nëpërmjet një student me një shkrim të bukur dhe me elegancën që e karakterizonte. Kjo më bën që sot ta admiroje dhe më shumë për shkak se ishte brilante në atë që e bënte, në mënyrën si shprehej, mënyrën si vrojtonte dhe mënyrën se si u qasej problemeve. Gjithnjë na motivonte dhe na jepte drejtimin e duhur që na mungonte, neve shqiptarëve të trojeve.

Por lipset thënë jo për edukatë por për të mbetur e shënuar se puna e tij me brezin e diplomatëve të Kosovës ka qenë një punë e pamohueshme dhe d.m.th. për krijimin e embrionit të diplomacisë së Kosovës. Them se Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës e ka për obligim që të bëjë veprimet e duhura për këtë figurë të madhe të diplomacisë shqiptare. Jo se Bashkim Rama ka nevojë për këtë, por për hir të punës që ai e ka bërë me diplomatët që edhe sot shërbejnë në shërbimin diplomatik të Kosovës, gjithandej nëpër botë.

Një diplomat që do të ja kishte lakmi gjithsecili për karrierën dhe përkushtimin e tij gjithnjë për të përfaqësuar sa më denjësisht Shqipërinë por edhe shqiptarët me theks të veçantë në Kosovë.

Ambasadori Bashkim Rama mbetet një figurë shumë domethanëse dhe interesante për tu trajtuar nga brezat që vijnë, e ne që patëm mundësi ta njohim nga afër përveç kësaj ai la pas vetes fëmijët e tij të cilët do ta vazhdojnë punën e babait të përkushtuar i cili gjithnjë mungonte në shtëpi jo me dëshirën e tij por se çështja shqiptare e kërkonte që ai të bënte veprime që ne sot të jemi faktor në Evropën juglindorë. Dhe krejt në fund batutat e tij në tavolinë s'do mend se s'mund të harrohen pasi i tillë ishte ambasadori Bashkim Rama, i hareshëm dhe i buzëqeshur.



IN MEMORIAM

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë, me keqardhje i njofton studentët, stafin akademik dhe administrativ se sot në mëngjes ndërrojë jetë Rektori i deritanishëm Prof. dr. Bashkim Rama.

Asnjë fjalë dhe postulat nuk do të reduktonte dhimbjen familjarëve, miqve dhe studentëve, por jemi të bindur që edhe ata që sado pak e njihnin profesor Bashkimin, e dinin se ai ishte një njeri i jashtëzakonshëm, me vlera të mëdha si në aspektin akademik ashtu edhe në aspektin njerëzor.

Prof.dr. Bashkim Rama, përveç si Rektor, i cili bëri shumë për UNS, do kujtohet edhe si pedagog i dashur për të gjithë studentët e Universitetit Ndërkombëtar në Strugë dhe për të gjithë kolegët si një mik i pazëvendësueshëm.

Universiteti Ndërkombëtar i Strugës nuk është i vetmi institucion që ka humbur një personalitet siç ishte Profesor Bashkimi, i cili për dekada të tëra ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm si një intelektual, ambasador, diplomat dhe pedagog shembullor për të gjithë popullin shqiptar.





JETËSHKRIM

Prof. dr. Bashkim Rama ishte Rektor i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës (2012-2014, 2016-2021), Profesor i Shkencave Politike, i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, i Teorisë e Praktikës Diplomatike, i Studimeve të Sigurisë, pranë Universitetit të Tiranës dhe në disa Universitete të tjera të vendit dhe Rajonit.

Bashkim Rama kishte mbaruar studimet pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja,ku ka vijuar studimet pasuniversitare për Filozofi. Ka mbaruar Kursin e Diplomacisë. Ka përfunduar jashtë shtetit studimet "Master" për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci ku ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave (PhD) për "Diplomaci dhe Siguri".

Ai ishte diplomat karriere dhe ka punuar për më shumë se dy dekada në Shërbimin e jashtëm të Shqipërisë, ku ka kryer disa detyra dhe misione diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme; Sekretar i

Parë i Ambasadës së Shqipërisë në Berlin; i Ngarkuar me Punë a.i. i Shqipërisë në Sofje; Ambasador i Shqipërisë në Bullgari, dhe Ambasador i Shqipërisë në Kosovë, drejtor i Drejtorisë së rajonit dhe vendeve fqinje në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë etj.

Është autor i artikujve, librave dhe teksteve për marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacinë dhe sigurinë, të botuara. Bashkim Rama ishte një prej njohësve më të mirë të situatës politike në Maqedoni dhe në rajonin e Ballkanit. Dy nga botimet e tij më të rëndësishme në këtë fusha janë librat "Faktori shqiptar dhe siguria rajonale" (Geer, 2011) dhe "Ballkani pas rënies së Murit të Berlinit -Vetëvendosja "versus" tërësia territoriale"" (Botimet M&B, 2013).

Ike Bashkim Rama, krenaria e dibranëve

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Më njoftoi vajza,
me lot, me dhimbje,
IKU BASHKIM RAMA...
Iku një diplomat,
iku një dibran,
Nga më të mirët,
nga më të pjekurit,
në diplomaci,
nga më të dashurit,
në shoqëri,
diplomat karriere,
profesor universiteti,
lektor,
rektor,
Dibran
me germa kapitale...
E kam parë tek rritej
Bashkim Ramën,
Rrugëve të Brezhdanit,
me babanë e tij Hasanin...
E kam parë kur
ndër të parët,
u ul në shkollën e gjuhëve të huaja.
Kemi pas familjarisht lidhje,
Kur ishte në Gjermani,
në Bullgari,
në ministri.
Erblina ishte si bijë në shtëpinë e tij,
motër me Nevilën,
asgjë si ndante,
çdo gjë i bashkonte...
Ike Bashkim Rama, ike
na le dhimbjen,
të madhe sa se mban toka,
familjes, shokëve, miqve.
Një emër të përveçëm na le,
emër që do të udhëtojë në breza.
Një dorë dheu,
mbi varrin tënd,
sot desha ta hedh,
Nuk mundem...
Një fjalë po...
NGUSHËLLIME
Nastës,
Nevilës,
Milenës,
Albanit
Nga unë dhe Natasha,
miqve,
kolegëve...
Të rrojnë,
ta kujtojnë,
ta nderojnë,
në përjetësi...

Athinë, 14 tetor 2021

Mbillen në Lurë 2712 pisha të zeza





Për dhurime përdorni numrat e llogarisë si më poshtë

SHQIPËRI: Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
Emri i llogarisë: QENDRA TREES FOR LURE
IBAN në lekë: AL91205112650057360LOTCLALLA
Iban në Euro: AL57205112650057360LOTCFEURS

Për ata që jetojnë në një vend të Bashkimi Europian:
Llogaritë janë në Republikën Çeke, nën emrin FARANDFURTHER
CZK: IBAN: CZ3320100000002401764115
EUR: IBAN: CZ9220100000002801986411

"Trees for Lurë" (Pemë për Lurën) organizoi gjatë muajve shtator-tetor një aksion për mbjelljen e pemëve në Lurë. Rezultati i këtij aksioni ishte mbjellja e 2712 pishave "Pinus Nigra" 2-vjeçare në një zonë të kategorisë 2 dhe 3 të Parkut Kombëtar të Lurës, që ndodhet në dhe ndodhet në lartësinë 1300m mbi nivelin e detit.

Në aksionin për mbjelljen e pemëve mori pjesë edhe zëvendësministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Almira Zebi Xhembulla.

"Nuk mund të kishte rastësi më të bukur se sa ditën e parë të punës ta nisja me mbjellje fidanësh në Parkun Kombëtar të Lurës", shkroi ajo në faqen e saj zyrtare në Facebook.

"Ju bashkova me shumë dëshirë nismës "Trees for Lurë" për të mbjellë rreth 2800 fidanë në një parcelë të shpyllëzuar. Një nismë e nisur prej kohësh dhe që më në fund po realizohet me shumë sukses në bashkëpunim edhe me inxhinierët e pyjeve dhe komunitetin vendas" - shkroi ajo.

Parku Kombëtar i Lurës është i ndarë në tre zona të mbrojtura. Brenda zonës së mbrojtjes në kategorinë e parë (nga lartësia e liqeneve e sipër), mund të mbillen vetëm pemë nga një lartësi e njëjtë dhe me origjinë nga zona e Lurës.

Parku Kombëtar i Lurës është një nga parqet më të bukur dhe të egër në Shqipëri. Fatkeqësisht, parku pësoi një shpyllëzim masiv nga prerja e paligjshme e pemëve, si dhe për shkak të një serie zjarresh që shkatërruan pyjet e tij.

Misioni i organizatës "Pemë për Lurën" është të ndihmojmë Parkun Kombëtar të rimëkëmbet nga gjendja fatkeqe. Qëllimi është që deri në fund të vitit 2021 të mbillen mbi 7 500 pemë.

Organizata po punon së bashku me specialistët vendas dhe përgjegjësit e Parkut Kombëtar (AdZM Dibër), organizatat partnerë në Shqipëri dhe komunitetin e Lurës për të arritur qëllimin në mbjelljen e pemëve dhe ruajtjen e tyre.

"Pemë për Lurën" është një projekt i përbashkët i "FAR&FURTHER" me seli në Republikën Çeke dhe grupit "Scout Tirana 1" me seli në Tiranë.

Organizata ka qëllim që "Pemë për Lurën" të zgjasë për vite të tëra, duke ndihmuar jo vetëm në sjelljen e pemëve në Lurë, por gjithashtu edhe në krijimin e mundësive punësimi për vendasit dhe sigurisht edhe në sjelljen e turistëve të rinj, që do të vijnë për të shijuar Parkun Kombëtar të Lurës.

Ky projekt nuk do të ndihmojë vetëm në rimëkëmbjen e pishave të Ballkanit në rrezik, por gjithashtu do të nxisë rritjen e zhvillimit rural dhe ekonomik në zonë, sidomos për njerëzit që jetojnë në fshatrat afër Parkut Kombëtar të Lurës.

"Rimëkëmbja e pyjeve të Lurës është një detyrë shumë e rëndësishme për t'u ekzekutuar. Ne po punojmë bashkë me autoritetet vendase, dhe veçanërisht me menaxherët e Parkut Kombëtar të Lurës për të koordinuar përpjekjet tona", - thuhet në qëllimet e shpallura të organizatës.

Pemët e mbjella këto muaj në Lurë u blenë në tri ferma në Shqipëri: Fushë Krujë, Burrel dhe Korçë, duke kontrolluar certifikatat fitosanitare të tyre, origjinën, gjendjen shëndetësore dhe paketimin për një transport të sigurë.

Vullnetarët kanë pasur ndihmën e inxhinierit të pyjeve, Nazmi Ajazi, i cili ka kryer paraprakisht trajnimin e tyre për teknikën e mbjelljes, në mënyrë që asnjë pemë e mbjellë të mos shkojë kot.

Gjatë këtij aksioni është vlerësuar mbështetja e komunitetit vendës si dhe është punuar për ngritjen e një skuadre të përhershme pune në Lurë.

Organizatorët kanë hapur edhe një numër llogarie në Shqipëri për të mbledhur donacione. Organizatorët synojnë të mbledhin 2 Euro për çdo pemë të mbjellë. Në qoftë se dëshironi të bëheni pjesë e këtij projekti, mund të dhuroni para në numrat e llogarisë më poshtë ose mund të ndihmoni me punë vullnetare.

Për më shumë info:
hello@treesforlure.org
Web: **https://treesforlure.org**